



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
“Legjislacion dhe institucionet evropiane”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc. Dr. Hemion Braho

2. Dr. Bledar Mustafaraj

Dhjetor/2022



**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master i Shkencave në Legjislacion dhe institucionet**  
**evropiane**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Legjislacion dhe Politika të BE
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Legjislacion dhe institucionet evropiane”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1183, datë 03.12.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE
18	Numri i studentëve:	2019-2020      10 studentë
		2020-2021      8 studentë
		2021-2022      12 studentë
19	Komente / të tjera:	-



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (i përmendur në vijim me inicialet UT), është institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave, i cili ka ofruar studime të nivelit universitar në gjashtë Institutet e tij: *Instituti Pedagogjik, Instituti Politeknik, Instituti Ekonomik, Instituti Mjekësor, Instituti Juridik dhe Instituti Shkencor.*

Përgjatë viteve ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh kryesisht në strukturën e tij. Në vitin 1991, nga UT (në atë kohë me 11 fakultete) u shkëputën fakultetet inxhinierike dhe u krijua Universiteti Politeknik i Tiranës. Në Janar të vitit 2013, u shkëputën dhe dy fakultete të shkencave mjekësore, për të krijuar Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

UT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, dhe në Filialin e tij në qytetin e Sarandës ku ofron programet e studimit në "*Administrim Biznes*" dhe "*Gjuhë Angleze*".

Sipas strukturës aktuale, ky universitet përbëhet nga një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute si më poshtë:

- Filiali i Sarandës;
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Drejtësisë;
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë;
- Fakulteti i Shkencave Sociale;
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
- Instituti i Fizikës Bërthamore;
- Instituti i Studimeve Evropiane.

Instituti i Studimeve Evropiane (përmendur në vijim me inicialet ISE) është krijuar në vijim të VKM Nr. 588, datë 2.11.2000 nën emërtimin "Qendra për Studime Evropiane"; me VKM Nr. 1182, datë 3.12.2009 është emërtuar "Instituti i Studimeve Evropiane".

Ky institut vepron si njësi kryesore dhe në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, është konceptuar si një njësi ndër-fakultetore e UT (*Evidenca 2, neni 20*), i cili ofron programe studimi të ciklit të dytë (Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë të studimeve.

ISE përbëhet nga dy departamante, që veprojnë si njësi bazë: departamenti "Legjislacion dhe politika të BE-së" dhe departamenti "Diplomaci dhe marrëdhënie ndërkombëtare të BE-së". Të dy njësitë ofrojnë programe të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe të ciklit të tretë të studimeve.

UT është akredituar institucionalisht ku, me vendimin Nr. 84, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, është vendosur për akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti i Tiranës, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 26.10.2022.



Sa i përket programit të studimit Master i Shkencave në Legjislacion dhe Institucionet Evropiane, objekt vlerësimi, është hapur fillimisht me VKM Nr.1183, datë 3.12.2009.

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

Programi, objekt vlerësimi, synon t'u ofrojë studentëve mundësi për të thelluar njohuritë dhe për t'u specializuar në fushën e legjislacionit dhe institucioneve evropiane, duke u njohur me nocione të thelluara në të drejtën e Bashkimit Evropian dhe institucionet e BE-së si dhe të ndërthurë formimin e tyre akademik teorik dhe metodologjik me praktikën dhe ekspertizën e fushës. Programi jep mundësi gjithashtu për studentët që dëshirojnë të vijnë në ciklin e tretë të studimeve në fushën e studimeve evropiane, për t'u përgjigjur nevojave për specialistë të integritit evropian dhe rritjes së nivelit mësimor e kërkimor në përputhje me standardet e universiteteve perëndimore (*Evidenca 7, neni 4*).



UT ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Legjislacion dhe Institucionet Evropiane”, ku me shkresën Nr. 52 Prot., datë 20.1.2022 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.



4



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht (ascal.al, standardet).

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Hemion Braho, ekspert dhe drejtues i GVJ, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert (të caktuar me urdhrin Nr. 77, datë 1.7.2022, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga Muhamed Prezja, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion.

Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në departamentin e Legjislacionit dhe Politikave të BE-së në ISE, të zhvilluar në datat 13-14 Korrik 2022, sipas një agjende gjithëpërfshirëse.



Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga ISE në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në "Legjislacion dhe institucionet evropiane"; gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

Më datë 01.11.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.52/137, datë 01.11.2022 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 22.11.2022 institucioni dërgon me shkresë zyrtare Nr. 3172/2 Prot., datë 22.11.2022, me lëndë "Përcillen komentet për draft – raportin e një programi të ISE", komentet në lidhje me Draft-Raportin.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportin, shprehet si vijon:

### **1. Për komentin që i përket standardit I.6, kriteri 4,**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport duke pranuar evidencat e dorëzuara, pavarësisht se evidentimi më i qartë duhej realizuar gjatë vizitës së GVJ.





**2. Për komentin që i përket standardit I.6, kriteri 3,**

GVJ shprehet se nuk merr në konsideratë komentin e IAL, pasi pavarësisht evidencave të propozuara, vihet re një mangësi në organizimin në nivel qendror të kërkimit shkencor, pavarësisht iniciativave personale.

**3. Për komentin që i përket standardit II.6,**

GVJ i qëndron afirmimeve në raport, duke qenë se gjatë vizitës nuk u evidentuan lidhje të qëndrueshme e autonome me studentët alumni.

**4. Për komentin që i përket standardit II. 7,**

GVJ e merr në konsideratë duke reflektuar ndryshimin në raport, pavarësisht se gjykimi tërësor i fushës së dytë mbetet i pandryshuar.

**5. Për komentin që i përket standardit III.2, kriteri 7,**

GVJ e merr pjerërisht në konsideratë përgjigjen e institucionit në koherencë me standardin I.6. Vleresimi tërësor i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.

**6. Për komentin që i përket standardit III. 2, kriteret 3-6,**

GVJ i qëndron afirmimeve në raport duke kërkuar intensifikimin e këtyre shkëmbimeve, lidhur edhe nga natyra e veçantë e ISE-së.

**7. Për komentin që i përket standardit III.3, kriteret 7-9,**

GVJ e merr në konsideratë duke reflektuar ndryshimin në raport, pavarësisht se gjykimi tërësor i fushës së dytë mbetet i pandryshuar.

**8. Për komentin që i përket fushës IV, standardit IV.I, kriteri 2,**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport lidhur me Rregulloren e Përgjithshme të UT-së (lënë në formën e rekomandimit për institucionin). Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ, mbi bazën e akteve të administruar, ka pasur në dispozicion Rregulloren e Përgjithshme të UT-së, e cila bazohej në ligjin e shfuqizuar për arsimin e lartë. Lidhur me këtë rekomandim, IAL ka vënë në dukje se pas vizitës së GVJ-së në ISE, me vendimin Nr. 20, datë 27.7.2022 të Senatit Akademik të UT-së, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja e Përgjithshme e re, e këtij institucioni, e cila është publikuar në faqen zyrtare të IAL: <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. Mbi këtë bazë, ISE po bën përditësimin e akteve të saj të brendshëm. Në këto kushte, GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ.

**9. Për komentin që i përket fushës V, standardit V.I, kriteri 3,**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. GVJ ka përmendur në raport faktin e publikimit të kriterëve të pranimit të studentëve në programin, objekt vlerësimi. Gjithashtu, është konstatuar se neni 40 i Rregullores së ISE-së përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur, dispozitë e cila nuk është në harmoni me kërkesat e nenit 94 të statutit të UT-së (*Evidenca shitesë A.6*). Në këto kushte, GVJ i qëndron sugjerimit për parashikimin e procedurave të detajuara lidhur me regjistrimin e studentëve në rregulloren e programit të ciklit të dytë Msc “Legjislacion dhe institucionet evropiane” dhe në draft-rregulloren e Departamentit të Legjislacionit dhe Politikave të BE-së.

**10. Për komentin që i përket fushës V, standardit V.3, kriteri 6,**



GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit si dhe i qëndron gjetjes lidhur me punën e sekretarisë, fakt i cili nuk është kundërshtuar nga ISE në komentin e saj.

**11. Për komentin që i përket fushës VI, standardit VI.4, kriteri 2,**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport lidhur me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë UT-së (lënë në formën e rekomandimit për institucionin). Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ, mbi bazën e dokumentacionit të administruar, nuk e ka pasur në dispozicion këtë akt. Lidhur me këtë rekomandim, IAL ka vënë në dukje se pas vizitës së GVJ-së në ISE, me vendimin Nr. 23, datë 27.7.2022 të Senatit Akademik të UT-së, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë e këtij institucioni, e cila është publikuar në faqen zyrtare të IAL: <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/vendim-23.pdf>. Në këto kushte, GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ.

**12. Për komentin që i përket fushës VI, standardit VI.4, kriteri 3,**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke e reflektuar në përmbajtjen e raportit. Sa i përket pretendimit se standardi VI.4 përmbushet plotësisht, GVJ vëren se ka ende hapësirë për detajimin e përgjegjësive dhe detyrave në aktet e brendshme të ISE dhe sidomos rregulloret e sigurimit të cilësisë. Një detajim i tillë do të sqarojë më mirë detyrat e secilit aktor të përfshirë në sigurimin e cilësisë. Në këto kushte, vlerësimi për këtë standard nuk ndryshon.





## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Legjislacion dhe institucionet evropiane”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ofrohet nga Departamenti Legjislacion dhe politika të BE-së i Institutit të Studimeve Evropiane të UT. Ky program u licencua me VKM 1183, datë 3.12.2009 dhe kërkohet për herë të parë akreditim nëpërmjet këtij procesi. Ky program ka si fokus kryesor të kontribuojë në rritjen e cilësisë profesionale të studentëve, të thellimit të njohurive të tyre në fushën e legjislacionit evropian dhe institucioneve evropiane, dhe që duan të vijojnë më tej karrierrën e tyre profesionale në fushën e studimeve evropiane. ( <i>Evidencat 3, 7, 14</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ekzistenca e Planit të zhvillimit të ISE-së ( <i>Evidenca 5</i> ), ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm, të planifikuar e të mirë menduar të zhvillimit të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen. Programi i studimit që nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Programi nën vlerësim ofrohet brenda Shqipërisë duke u fokusuar në fushën e integritit evropian të vendit, dhe inkurajon bashkëveprimin me aktorë të tjerë të interesuar në këtë fushë (studime evropiane) ( <i>evidenca 5, statuti UT</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Si rrjedhojë, ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar. ISE në studimin dhe analizën e tregut ka arritur në përfundimin se Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” është një program i kërkuar kryesisht nga juristë të cilët duan të përfitojnë studime të thelluara në fushën e të drejtës evropiane dhe integritit evropian, duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe reintegritit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor në këtë fushë ( <i>evidencat 7; 15</i> ). Qëllimi është punësimi pranë institucioneve kryesisht publike, por edhe në strukturat jo-publike si organizmat jo qeveritarë aktivë në fushën e integritit evropian ( <i>evidenca 5</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose	Si rezultat të diplomuarit punësohen kryesisht në institucionet aktive në fushën e integritit evropian si në nivel kombëtar si edhe ndërkombëtar. Si dokumenta kryesor për arritjen e këtij qëllimi, ISE ka paraqitur Strategjinë e Zhvillimit të UT-së (2018-2023) si edhe Planin e Zhvillimit



kombëtar.	të ISE për periudhën 2021-2024. Nëpërmjet këtyre dokumentave ISE synon të identifikohet si një alternativë e besueshme, profesionale dhe konkurruese në fushën e arsimit të lartë në vend dhe posaçërisht në atë të studimeve evropiane ( <i>Evidencat 3, 5</i> ). Në këtë drejtim, ISE programi “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ndërthur si teorinë ashtu edhe praktikën e së drejtës si vendase dhe veçanërisht asaj evropiane. Këto elementë u mundësojnë studentëve të analizojnë praktikën e mira doktrinare si teorike, si praktike, duke reflektuar mbi zhvillimet e më të fundit juridike në tërësinë e aspekteve teknike që lidhen me fushën e së drejtës dhe integritimit evropian ( <i>Evidencat 11, 14, syllabuset</i> ).								
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Programi i studimit paraqet elementët e konkurrueshmërisë në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara ( <i>evidenca 7</i> ). Akademikët e ISE kanë përvojë ndërkombëtare dhe ndihmojnë studentët e programit për të kryer analiza cilësore të ligjit me qëllim që të kuptojnë më mirë lidhjen midis ligjit dhe politikave dhe fushave/disiplinave specifike të programit si dhe ndikimin e dimensionit të legjislacionit dhe politikave evropiane në to. ISE ka në qendër studentin, dhe ky program jep mundësi për studentët që duan të vijojnë ciklin e tretë të studimeve në fushën e studimeve evropiane, për t’iu përgjigjur nevojave për specialistë të integritimit evropian ( <i>evidenca 7</i> ).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Not</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Not	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Not	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi L2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentet strategjike të ISE si statuti i UT, Plani strategjik 2018-2023 dhe rregulloret mund të afirmohet se organizimi i programit të studimit Master Shkencor në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë por edhe formimin e shprehive profesionale, si edhe me metodologjitë shkencore të përgjithshme ( <i>evidenca 3</i> ). Me qëllimin për të tërhequr më shumë studentë të huaj u afirmua gjatë vizitës se do të synohet rritja e ofertës në gjuhën angleze. Programi nën vlerësim nuk ofron lëndë në gjuhë të huaj, por vetëm leksione të caktuara me <i>guest lecturer</i> . Gjatë vizitës u afirmua se nga viti tjetër ISE do të ofrojë një program studimi Master Ekzekutiv “Negociata dhe anetaresim ne BE” në gjuhë të huaj i cili në ofertën e tij do të ndahet midis dy departamenteve aktualisht ekzistues ( <i>takimi me drejtuesit</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e	Në linjë me objektivat e strategjisë për zhvillimin e institucionit është



<p>institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>edhe ndryshimi i planit mësimor në 2020 në drejtim të pajisjes së studentëve jo vetëm me njohuritë bazë shkencore dhe profesionale, si edhe me aftësitë e posaçme të komunikimit në funksion të zgjerimit të mundësive për punësim sektorët e politikave, së drejtës dhe institucioneve së Bashkimit Evropian (<i>Evidenca 3</i>). Rregullorja e përgjithshme e ISE, përcakton konsolidimin e veprimtarisë së strukturave të institucionit, duke respektuar lirinë akademike në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor (<i>Evidenca 6</i>). Realizimi i këtij parimi mundësohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit institucional me institucionet brenda dhe jashtë vendit (<i>Evidenca Marreveshjet e Bashkëpunimit; Evidenca 29</i>). Programi i studimit është hartuar në përputhje me prioritetet akademike të përcaktuara në Statutin e UT si edhe Rregulloren e posaçme të studimit. (<i>Evidenca 2; Evidenca 7</i>). Programi organizohet në module dhe vlerësohet në ECTS; sasia e përgjithshme e krediteve e fituar në një vit nga një student është 60 kredite.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti Legjislacion dhe politika të BE-së i cili është pjesë e Institutit të Studimeve Evropiane të UT (<i>Evidenca 2</i>). Në tërësinë e tij programi MSH në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” synon të kualifikojë studentët bazuar në progresin e tyre gjatë studimeve si edhe mundësisë së zgjedhjes sipas fushave të interesave të tyre. Siç u afirmua edhe përgjatë takimeve, një pjesë e mirë e studentëve janë tashmë në marrëdhënie pune dhe kërkojnë, nëpërmjet këtij programi MSH, të specializohen në fushën e legjislacionit dhe institucioneve të BE-së (<i>Takimi me studentët</i>). Staf i angazhuar gjatë vitit akademik për të dhënë leksione, ose për të kryer aktivitete jashtëkurrikulare vjen nga fusha të ndryshme të ekspertizës duke synuar krijimin e një organi të konsoliduar profesional që zbaton programin (<i>Evidenca 13; Evidenca “CV e stafit të angazhuar në vite”; evidenca shitesë A. 13</i>). Organizimi i lëndëve në semestra bëhet sipas kurrikulës së programit (<i>evidenca 11</i>). Aspektet praktike dhe profesionale të arsimit janë të integruara në aspekte të ndryshme të programeve të studimit, përfshirë praktikën dhe projektet e kërkimit shkencor.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Partnerë të jashtëm të universitetit bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me institucionin, që përfiton avantazhe si në objektivin e zhvillimit e punësimit të studentëve, por edhe sa i përket kurrikulave të programit përfshirë edhe strukturën e përgjithme të tij (<i>Evidenca “Marreveshjet e Bashkëpunimit”; Evidenca 28</i>). Synimi kryesor mbetet përmbushja e nevojave të tregut dhe ndërkombëtarizimi i kurrikulës (<i>Evidenca 3; Evidenca 5</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në rregulloren e Programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në “Legjislacion dhe institucionet evropiane”, institucioni ka përcaktuar qartë organizimin e punës mësimore, shkencore, financiare dhe administrative që janë dhe infrastruktura bazë e realizimit të procesit formues për studentët (<i>evidenca 7, neni 4</i>). Programi strukturohet në lëndë dhe module, ku janë të përcaktuara qartë qëllimet, objektivat, dijet dhe kompetencat profesionale që studentët përfitojnë në përfundim të kursit. Bashkësia e këtyre kompetencave është thelbi i programit i cili sipas studimeve të tregut të punës gjithashtu i përshtatet kërkesave të tij. Këto objektiva të përcaktuar në rregulloren e programit Master Shkencor në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” janë sintetizuar në planet mësimore dhe syllabuse e lëndëve. Në syllabusin e secilës lëndë parashikohen, përmbajtja, objektivat, temat duke evidentuar literaturën përkatëse, ndarë në atë bazë, ndihmëse dhe plotësuese, detyrimet e studentit dhe sistemi i vlerësimit të tij (<i>Evidenca Syllabuse 2019-2020, Syllabuse 2020- 2021, Syllabuse 2021-2022</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në proceset akademike pranë diplomimit, studentët inkurajohen të marrin pjesë në praktikën profesionale dhe programet e punësimit. ISE ka vendosur kontakte të vazhdueshme me profesionistë dhe institucione të fushës dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për t’u ofruar mundësi të praktikës (<i>evidencat Marreveshjet e Bashkëpunimit, evidencë shtesë B4</i>). ISE ka bërë një studim të tregut dhe ofron mundësinë e diskutimit midis aktorëve të ndryshëm pjesë e tregut të punës dhe studentëve nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme (<i>evidenca 15</i>). Institucioni bën rishikime të kurrikulës edhe në rastin e përshtatjes së saj me nevojat e tregut. Përshtatja e kurrikulës me nevojat e tregut realizohet edhe përmes përfshirjes së lëndëve me zgjedhje, të cilat synojnë të ofrojnë për studentët njohuri dhe aftësi të nevojshme për tregun e punës (<i>evidenca Ndryshim plani mesimor 20</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathhtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat e Masterit të Shkencave në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” janë të përcaktuara në rregulloren e programit përmes parashikimit të elementeve dhe strukturës së planit mësimor. Struktura e planit mësimor pasqyron qartë strukturën e programit dhe është i strukturuar në dy pjesë plotësuese: pjesa e bazuar në njohuri dhe pjesa e bazuar në aplikimin e avancuar të teorisë në praktikë. Ai siguron informacion të bollshëm në lidhje me kërkesat e diplomës (<i>Evidenca 7 neni 5</i>). Suplementi i Diplomës shpjegon informacionin në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet dhe aftësitë e të nxënit që merren nga përfundimi i programit (<i>Evidenca 7.2</i>). Për rrjedhojë, oferta akademike e programit të studimit integron, përmes të gjithë elementëve, informacionin e nevojshëm në lidhje me diplomën e përfutur në përfundim të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të</p>	<p>Programi i studimit është i konceptuar në mënyrë të tillë që studentët që mbarojnë në këtë specialitet të kenë mundësi të përshtatet edhe me</p>



<p>ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>tregun e jashtëm të punës. Kjo i bën studentët e këtij programi studimi të kenë mundësi transferimi të studimeve në këto institucione në tregun e huaj (evidenca 7, nenet 6 dhe 9).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, si edhe modele dhe eksperiencat të universiteteve evropiane. Ky program studi edhe programet e tjera që ofron ISE mbështeten në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë, si dhe eksperiencën shumëvjeçare të vetë institucionit. modelet dhe eksperiencat të universiteteve evropiane. Fokusi qëndron tek përshtatja dhe adoptimi me ndryshimet e legjislacionit të arsimit të lartë dhe qenia në koherencë me nevojat e tregut të punës për specialistë të fushave që mbulon ISE (evidenca 5, evidenca 14).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në koherencë me Strategjinë e Universitetit dhe ndryshimet e programit si ajo në 2020 ISE përshtatet me zhvillimet e kohës duke e drejtuar vëmendjen jo vetëm drejt arsimit tradicional por edhe duke rritur mundësinë e trajnimeve profesionale (Evidenca Ndryshim plani mesimor 20, evidenca 31). Ky program studimi parashikon kryerjen e praktikës profesionale që përbën 10% të krediteve të këtij program studimi (12 ECTS) dhe zhvillohet në bashkëpunim me subjekte të ndryshme, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Praktikën kryhen në institucionet me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi (Evidenca 7 neni 6, pika 6/D dhe neni 24; Evidenca Marrëveshjet e Bashkëpunimit; Evidenca shtesë B4).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit e institucionit.</p>	<p>Ky program studimi aktualisht zhvillohet në gjuhën shqipe, por në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar, është ndër prioritetet strategjike të ISE-së që lëndë/module të programit mund të zhvillohen në gjuhë të huaj (anglisht). Gjithashtu, në objektivat/synimet e ndërkombëtarizimit përfshihet edhe krijimi i mundësive për të ofruar diploma të përbashkëta me institucione homologe ndërkombëtare, të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, të hartohet dhe aplikohet një ofertë akademike për studentët ndërkombëtarë, të bashkëpunohet me personel akademik të huaj për shkëmbim përvojash/mobilitete dhe ekspertizë në fusha specifike dhe me interes për institucionin. (Evidenca 5). Siç u afirmua edhe më lartë (Standardi I.2/kriteri 1) nga viti tjetër <b>ISE do të ofrojë një program studimi Master Ekzekutiv "Negociata dhe anetaresim ne BE" i cili në ofertën e tij do të ndahet midis dy departamenteve aktualisht ekzistues Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së dhe Departamenti i Diplomacisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (takimi me drejtuesit).</b></p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>ISE ruan dokumentacionin që lidhet me këtë program studimi në gjuhën shqipe si giuha që zhvillohet ky program. Megjithatë, pjesë të caktuara të dokumentacionit të tij janë edhe në anglisht, si: p.sh. suplementi i diplomës, analiza e tregut të punës, syllabuse (<i>Evidenca 7/1 Evidenca 15</i>). Drejtuesi i Departamentit ruan dokumentacionin kryesor të programit të studimit. Anëtarët e Departamentit mund të kenë akses në këtë bazë dokumentare. Planprogramet e miratuara dhe të nënshkruara depozitohen në Rektorat. Lidhur me aktivitetet e institucionit, faqja e internetit të ISE ofron informacion të përgjithshëm të vlefshëm (<a href="https://unitir.edu.al/instituti-i-studimeve-europiane/">https://unitir.edu.al/instituti-i-studimeve-europiane/</a>). <i>Sidoqoftë faqja web duhet përditësuar në mënyrë më konstante si edhe duhet mirëmenaxhuar më mirë edhe në versionin anglisht apo gjuhët e tjera.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i ulët</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b> Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Struktura akademike e MSH nën vlerësim është zhvilluar përmes një bashkëpunimi mes pedagogëve me përgatitje juridike nga degë të ndryshme të ligjit, si dhe bashkëpunim intensiv mes lektorëve me orar të plotë dhe pedagogëve me kohë të pjesshme. Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së në ISE, disponon kapacitetet e duhura akademike dhe burimet e nevojshme në fushën akademike si për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të realizuar këtë program studimi. Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së aktualisht ka në përbërjen e tij 11 anëtarë në total dhe të gjithë janë PAE. Nga këta, 6 janë PAE të ISE-së dhe 5 janë PAE nga njësi të tjera të UT. Në vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 10 PAE dhe 1 PAK. Nga 10 PAE, 3 janë stafi ISE-së dhe 7 janë PAE nga njësi të tjera të UT. (<i>Evidenca - Raporti Vjetor i ISE-së 2020-2021; evidenca shtesë A. 5</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSH “Legjislacion dhe institucionet evropiane” në tërësinë e tij, është në kohezion të plotë me fushën akademike të ISE. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti të Legjislacionit dhe Politikave të BE-së, i cili është një prej dy departamenteve bazë të ISE-së (njësia kryesore). (<i>Evidenca 7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të</p>	<p>Master i Shkencave në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ofrohet bazuar në Ligjin Shqiptar dhe në përputhje me Strategjinë dhe Planin e Zhvillimit të UT dhe ISE (<i>Evidenca 3; Evidenca 5</i>). Programi ofrohet nga Departamentin e Legjislacionit dhe Politikave të BE-së. <i>Në këtë program angazhohen dhjetë personel akademik me kohë të plotë,</i></p>





<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p><b>dhe të gjithë janë me titull akademik ose gradë shkencore (4 janë Dr; 2 Prof.Asoc dhe 4 Prof.Dr).</b> Nevojat e Departamentit për shërbime akademike të specializuar mbulohe nga asistentë administrativ të cilët lehtësojnë realizimin e detyrimeve administrative. Bazuar në udhëzimet kombëtare dhe evropiane, programi i ofruar nga Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së zhvillohet me kohë të plotë, në një kohortë 24 mujore. Është i shtrirë në tre semestere dhe semestri i katërt (përfshirë periudhën e verës) i dedikohet studentit që shkruan një tezë nën supervizionin e profesorit të përzgjedhur. Programi zhvillon një kuptim sistematik të thelluar të së drejtës dhe institucioneve të BE-së dhe siguron aftësitë e nevojshme për të analizuar dhe vlerësuar problemet komplekse ligjore dhe çështjet e ndërlidhura (<i>RVB fq. 11, Evidenca shtesë A.5</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Realizimi i programit sigurohet nga një staf burimesh njerëzore të kualifikuar si në drejtimin akademik edhe në atë administrativ apo institucional. Në Statutin dhe Rregulloren e UT-së, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit “Legjislacion dhe Institucione evropiane” (<i>evidenca 6, evidenca 7</i>). Kështu departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte optimale me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Po ashtu edhe IT-ja siguron mbulimin e shërbimeve online dhe ka patur rol të rëndësishëm për realizimin e procesit mësimor në kohë dhe sipas kërkesave të stafit dhe studentëve, dhe në mënyrë institucionale ndihmon procesin e provimit dhe hedhjes së notave (<i>evidenca E.26</i>). Përgjatë takimeve GVB u informua se UT ka statut të ri por jo rregullore të përgjithshme. Për këtë arsye edhe rregullorja është e vjetra e 2009 (me ligjin e vjetër). Me daljen e rregullores se UT do përshtatet edhe rregullorja e re e ISE. ISE po punon për rregulloren e departamentit duke qenë se ka ardhur formati për departamentin (<i>evidenca shtesë A.3 Evidenca shtesë A.6</i>). Biblioteka është në funksion të realizimit të këtij programi studimi (<i>evidenca E.30, Evidenca shtesë A.9</i>). Sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit nëzyrat e ndryshme, faqja online, janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë operative, funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Cdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të</p>



	studimit dhe informon drejtuesit respektivë.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	ISE në funksion të realizimit të programit të studimit, që ka një profil të theksuar ndërkombëtar, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit. Këto marrëveshje janë lidhur për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për zhvillimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar apo personalitete të njohura në fushën e BE-së, tryeza të rrumbullakëta, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta. <i>Në këtë drejtim GVJ është informuar se ISE është fituese e tre programeve Jean Monnet dhe se nga bashkëpunimi me Kolegjin e Europës në Bruge ka si pikë të parë rishikimin e strategjisë dhe planit të zhvillimit (Evidenca 3, evidenca 5, evidenca shtesë B.2). Pra nga kjo marrëveshje do të përmiresohet edhe plani i zhvillimit.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Institucioni ka marrëveshje për praktikën e studentëve me institucione të ndryshme dhe në planin mësimor parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale përpara punimit të diplomës. Lista e institucioneve që ISE bashkëpunon është e kënaqshme (p.sh. me Avokatin e Popullit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Agjensinë e Prokurimit Publik, etj.) duke u përcaktuar qartë fokusi i afrimit të studentit me tregun e punës. Në çdo program studimi ka pedagogë mbikëqyrës dhe koordinues të këtyre praktikave. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, pedagogu përgjegjës koordinon dhe mbikëqyr punën e studentit në lidhje me institucionin. Pas përfundimit të praktikës, kjo e fundit reflektohet në formularët dhe raportin përkatës, të cilët bëhen pjesë e dosjes së vlerësimit të studentit (evidenca 28, evidencat 7; 7/2; evidenca 14).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Siç u evidentua edhe më sipër, ISE bashkëpunon me institucione vendase dhe të huaja, si pjesë e politikës së institucionit për të lidhur mësimdhënien me kërkimin dhe praktikën. Kjo është shprehur në formën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme, aktorë vendas dhe të huaj, për të organizuar aktivitete të përbashkëta akademike, për mundësi financimi në projekte dhe partneritete të ndryshme, praktika profesionale, për rritjen e mobilitetit si dhe motivimin e stafit për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore dhe shkëmbimi (p.sh. Programet e shkëmbimit Erasmus+, projekte kërkimore, etj.). (evidenca 28; evidenca shtesë A.2, evidenca shtesë B.4).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstytucional ISE ka një sërë marrëveshjesh të cilat janë me fokus në kërkimin shkencor, duke patur si bazë organizimin e konferencave të përbashkëta. Ky bashkëpunim shtrihet brenda dhe jashtë vendit. ISE mban marrëdhënie të vazhdueshme me Zyrën Kombëtare Erasmus+ në Tiranë dhe Agjencinë për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion (Shqipëri) lidhur me mundësitë e granteve dhe bashkëpunimet e mundshme. (evidenca 15, evidenca shtesë A.2, evidenca shtesë B.4).
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të	Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së përgjegjës për këtë program, në funksion të realizimit të tij, harton raporte analitike mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe të huaja dhe vendase atje ku ka pasur përfitime (evidenca marrëveshjet e



realizimit të programit të studimit	<i>bashkëpunimit</i> ). Gjithashtu, çdo vit Drejtuesi i Departamentit i paraqet Dekanit të Fakultetit, në Raportin vjetor të ISE-së, reflektohen marrëveshjet e reja të bashkëpunimit dhe bëhet një vlerësim mbi marrëveshjet ekzistuese. Në varësi të interesit për programet e studimit që ofron ISE, reciprocitetit dhe korrektesës në bashkëpunim, janë vlerësuar bashkëpunimet ekzistuese (duke i rinovuar ato) si dhe janë lidhur marrëveshja të reja me aktorë të tjerë, me qëllim përfitimin e stafit dhe studentëve ( <i>evidenca 14</i> ).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Kërkimi shkencor është një nga dimensionet kryesore të veprimtarisë së Universitetit të Tiranës. Për vetë rëndësinë që ka, kërkimi shkencor dhe produktet e tij marrin rëndësi jo vetëm për universitetin si institucion por edhe për ndikimin që kërkimi shkencor duhet të ketë për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit dhe një nga objektivat kryesorë të kërkimit është rritja e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor. Institucioni ka mbështetur financiarisht stafin në realizimin e rezultateve të tyre shkencore. Gjatë vizitës u afirmua se pedagogu G. E. ka përfutur fonde për monografinë e vetë ( <i>Evidenca 4, Evidenca 33</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	UT ka ngritur një qendër të re që është <b>Qendra e Trajnimeve dhe Inovacionit</b> dhe do u shërbejë pedagogëve në fushën e rrijës profesionale dhe kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor është nxitës i rritjes së vazhdueshme së ISE. Kërkimi shkencor mbetet një nga shtyllat kryesore ku mbështetet veprimtaria e institucionit si një nga kërkesat kryesore për implementimin e sistemit të Bolonjës në ISE Në aspektin funksional dhe organizativ, mbi bazën e përcaktimeve staturore, kërkimi shkencor është një nga shtyllat/komponentët kryesorë që bie nën përgjegjësinë e departamenteve. Ekzistojnë lloje të ndryshëm të stimuljeve gjatë procesit të vlerësimit të performancës në hulumtimet shkencore të cilat përbëjnë sistemin për matjen e cilësisë së rezultateve të kërkimit. Dy forma kryesore janë stimujt financiarë dhe stimujt akademikë ( <i>evidenca Statuti neni 135; neni 20</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Në dokumentat programatikë institucioni e ka në fokus kërkimin shkencor Në zbatim të dokumentave bazë të universitetit, edhe ISE ka projektuar kërkimin shkencor si një nga elementët kryesorë të Planit të tij të Zhvillimit. Kështu, ky dokument parashikon se në ISE prej fillimit të vitit akademik 2020-2021, krahas procesit mësimor e veprimtarisë akademike, i është dhënë rëndësi identifikimit të hapësirave të bashkëpunimit, brenda dhe jashtë vendit. <i>Gjithsesi vihet re mungesa e planeve të detajuara kërkimore dhe orientimi i stafit për kërkimin që</i>



	<i>mundet të kryejnë qoftë në grup qoftë në mënyrë individuale. Sidoqoftë, institucioni ndër objektivat që synohet për t'u realizuar në pikën që lidhet me Kërkimin shkencor dhe projektet, është kontributi në publikime dhe promovimi i tyre (evidenca 5).</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Në adresimin e objektivave dhe rezultateve të pritshme në lidhje me kërkimin shkencor parashikohet mbrojtja e të drejtës së autorit, evitimi i plagjaturës dhe respektimi i etikës në kërkimin shkencor si kërkesa këto ë lidhen me cilësinë në ve rimitarinë kërkimore-botuese, parashikuar nga Karta Evropiane për Kërkuesit dhe Kodi i Sjelljes për rekrutimin e kërkuesve hartuar nga Komisioni Evropian (Evidenca 4). <i>Sidoqoftë mungon evidenca e një dokumenti që të adresojë në mënyrë specifike problematikat lidhur me shkeljet etike në këtë fushë si edhe një organ i posaçëm që mund t'i adresojë ato.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor duke krijuar mekanizma incentivues në fushën financiare dhe karrierën akademike. Departamenti i ka nxitur studentët për pjesëmarrjen në Konferenca Shkencore jashtë institucionit apo ato organizuar nga vetë ISE. Gjithashtu, për të mbështetur personelin akademik të UT-së në realizimin e objektivave të tyre kërkimore dhe krijimin e mundësive për avancim në karrierë, UT ka miratuar dhe zbaton prej vitit 2021 programin "UT kërkim, ekselencë dhe inovacion". Ky dokument jep informacionin e nevojshëm për paraqitjen e propozimeve si dhe detajon procedurat për dorëzimin e aplikimeve nga radhët e stafit akademik të UT-së. Financimi ndryshon në varësi të projektit të paraqitur, por gjithsesi shuma maksimale e financimit për një projekt-propozim është 1 milion lekë. (evidenca 32).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi MSh në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ka në total 120 ECTS. Programi zhvillohet në dy vite akademike të ndarë në 2 semestra secili bazuar në plotësimin e nevojave të studentëve që ndjekin këtë program dhe natyrës së lëndëve. Programi është hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore që burojnë nga legjislacioni në fushën e arsimit të lartë. 1 ECTS permban 25 orë gjithsej në auditor dhe punë individuale sipas VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar) dhe Rregullores së Departamentit (<i>evidenca 7; evidenca 11</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MSH “Legjislacion dhe institucionet evropiane” synon, nëpërmjet secilës lëndë apo modul, t’u japë studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre profesional që kombinon teorinë dhe praktikën e institucioneve dhe legjislacionit të BE-së. Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënit dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të kursit. Aftësitë shprehimore teknike do i lejojnë studentët për t’u përballur me specializimeve profesionale në këtë fushë. Studentët pasi të kenë mbaruar këtë cikël studimi të jenë të aftë, të marrin kompetencat dhe ta ushtojnë profesionin e tyre me përgjegjësi si dhe vazhdojnë studime më të thelluara si ato në ciklin e tretë (<i>evidenca 7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në aktet rregullatore të institucionit është shprehur qartësisht profili i programeve dhe njohuritë që ato japin (<i>evidenca 2, evidenca 6; evidenca 7; evidenca shtesë A.6</i>). Ky program studimi synon të:</p> <p>a. Pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara në të drejtën e Bashkimit Evropian dhe Institucionet e BE, si dhe të gërshetojë formimin e tyre akademik teorik dhe metodologjik me praktikën dhe ekspertizën e fushës dhe të zhvillojë aftësinë për punën në grup;</p> <p>b. Inkurajojë dhe aftësojë studentët të formojnë pikëpamjet e tyre dhe të gjenerojnë analiza për çështjet e rëndësishme të procesit të integritimit evropian;</p> <p>c. Japë njohuri mbi krijimin e Bashkimit Evropian, evolucionin e institucioneve evropiane dhe kompleksitetin dhe dinamikat që ndikojnë në procesin e integritimit në BE.</p> <p>ç. Pajisë të diplomuarit me njohuri specifike shkencore dhe metodologjike në të Drejtën e Bashkimit Evropian dhe disiplinat përkatëse, të domosdoshme për aftësimin e të diplomuarve për kryerjen e punës së pavarur kërkimore, si dhe në prezantimin dhe botimin e arritjeve të tyre (<i>Evidenca 7; RVB fq 16</i>).</p> <p>Tematikat pasurohen me elementë bashkëkohorë duke patur në vëmendje aspektet studimorë të orientuar drejt praktikës sipas</p>



	standarteve që kërkon një program studimi në nivelin e një “Master të Shkencave”.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Njohuritë teorike me aplikimin praktik lidhen direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Synohet nëpërmjet këtij programi MSH, kualifikimi i studentëve bazuar në profilizimin e tyre në fusha të veçanta të studimeve të BE-së, avancimin në fushën e shkencës juridike/politike përmes përgatitjes për të zhvilluar kërkime novatore dhe gjithmonë në progres në funksion të të nxënit. Programi është ndërthur me njohuritë teorike me aplikimin praktik të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës ( <i>evidenca 15</i> ). Secila tematikë trajtohet me metoda studimore inovative duke e përditësuar me informacion bashkëkohore. Metoda simulative gjatë seminareve, të shembujve të ndryshëm aplikohen tek studentët të cilëve më pas u kërkohen zgjidhje dhe vendimmarrje rast pas rasti ( <i>evidenca 11</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi paraekzistues është i strukturuar në ECTS, sipas Rregullores së UT-së dhe Rregullores së këtij programi. Në këtë program studimi, veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme, me kreditet cilhe përqindjen përkatëse që zënë, sipas përcaktimeve të bëra mbi bazën e VKM-së nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi nën vlerësim është i strukturuar në:			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	A. Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme — 2 lëndë: në total 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve të këtij programi); B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një fortim specifik, sipas karakteristikave të tij — 10 lëndë: në total 60 kredite ECTS (50 % e totalit të krediteve të këtij programi); C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngiashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje — 3 lëndë me zgjedhje: në total 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve të këtij programi); D. Lëndë plotësuese - praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve të ndryshme, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim — 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve të këtij programi); E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës — 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve të këtij programi). ( <i>Evidenca 7; evidenca 11</i> ).			
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Struktura akademike e Fakultetit ndahet në departamente, me Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontrata (PAK) dhe Personel Administrativ. Tri njësitë themelore nën Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale janë: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Departamenti i Psikologjisë (Neni 9 i Statutit të ISE; evidenca 1.1). Programi Master i Shkencave në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Drejtësisë. Sipas të dhënave, ky departament plotëson detyrimin ligjor duke patur numrin prej 6 pedagogësh me tituj dhe grada, 1 në process të përfitimit të grades shkencore “Doktor” dhe 3 janë pa grade shkencore. Të drejtat dhe përgjegjësitë e cdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullatorë të institucionit (evidencat 1.8; 1.9). <i>Aktualisht ISE në strukturë ka 2 departamente dhe u afirmua gjatë vizitës se, në përputhje me parashikimet stature, parashikohet rihapja e departamentit të tretë, mbyllur në 2018, brenda fillimit të vitit të ri akademik 2022-2023. GVJ vlerëson me rëndësi përmbushjen e këtij detyrimi sipas parashikimeve ligjore dhe statute (takimi me drejtuesit e ISE).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Detyrat e njësisë bazë dhe të drejtuesit të departamentit janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UT si edhe aktet rregullativë të ISE dhe programit. Drejtuesi i departamentit të Drejtësisë, si autoriteti drejtues akademik i kësaj njësie, mban titullin akademik Prof. Dr. Veprimtaria e departamentit dhe ISE realizohet duke u mbështetur në misionin e ISE si edhe në specifikat strukturore të ISE si njësi kryesore, ndërfaqultetore e UT-së (evidenca 2, evidenca 6; evidenca 7; evidenca shtesë A.3; evidenca shtesë A.6). <i>Prezenca e 6 pedagogëve, dhe jo minimumit shtatë, siç kërkohet nga ligji, u afirmua nga strukturat drejtuese, justifikohet nga strukturimi ndërfaqultetëror i ISE. Megjithatë vlerësohet nga GVJ përmbushja e këtij standardi ligjor.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Departamenti “Legjislacion dhe politika të BE-së” përmbush kushtet ligjore përsa i përket stafit akademik që duhen për të realizuar këtë program duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet që burojnë nga Udhëzimi Nr. 29, dt. 10/09/2018 të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>a) Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 10 PAE dhe 1 PAK. Nga 10 PAE, 3 janë stafi ISE-së dhe 7 janë PAE nga njësi të tjera të UT. Nga PAE: 4 janë me gradën shkencore Doktor, 3 Prof. Asoc dhe 3 Prof. Dr; Nga PAK: 1 Dr.</p> <p>b) Për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar 11 pedagogë dhe të gjithë janë PAE. Nga këta, 6 janë PAE të ISE-së dhe 5 janë PAE nga njësi të tjera të UT.</p>



	<p>Nga keta: 5 janë Dr; 3 Prof.Asoc dhe 3 Prof.Dr Për sa më sipër i gjithë stafi akademik i angazhaur është staf efektiv i UT. (evidenca shtesë A. 5, Tabelat 12.2 ; 12.3).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Rol të rëndësishëm në realizimin e këtij programi luan edhe stafi administrativ si psh. me anë të mekanizmit të formularëve të vlerësimit të studentëve që plotësohen në mënyrë anonime (evidenca shtesë A.15). Edhe stafi akademik angazhohet në aktivetete administrative, proporcionalisht me ngarkesën akademike. Ky staf angazhohet në lehtësimin e realizimit të praktikave mësimore nga ana e studentëve apo aktivetete shkencore dhe rekreative. Gjithashtu, duhet theksuar se anëtarët e personelit akademik të Departamentit të Legjislacionit dhe Politika të BE-së janë të angazhuar në projekte të BE-së si Jean Monnet (Evidencat shtesë B.1 dhe B.2).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Roli i koordinorit është i parashikuar në aktet rregullative të ISE. Këtë funksion e mbulon aktualisht Përgjegjësjë e Departamentit, siç u evidentua përgjatë takimeve me drejtuesit (evidenca Minutat e vizitës). koordinori i këtij programi studimi miratohet me urdhër të drejtorit të ISE-së, nga radhët e personelit akademik të Departamentit përgjegjës për këtë program, me tituj e grada. Koordinatori i këtij programi studimi përgjigjet për koordinimin e veprimtarive mësimore, me ato akademike-kërkimore zhvillohen nga departamenti dhe/ose ISE (evidenca 7; evidenca 21).</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorit i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

### Standardi II.3

**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Instituti i Studimeve Evropiane, si njësia kryesore, ofron informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. Informacioni lidhet me programet mësimore dhe elementëve të tyre. Çdo program studimor i ofruar nga njësia bazë që ofron programin e studimit MSH. në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” përmban emërtimin e lëndëve, krediteve përkatëse, numrin e orëve mësimore në auditor dhe ato të punës individuale të studentëve, titullarët e lëndëve dhe elementët e tjerë të programit të çdo lënde (evidenca 7).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivetete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” është i organizuar në 2-vite akademike (4 semestra) me 120 ECTS me një ndarje të këtyre sipas dispozitave ligjore për llojin (A, B, etj) të lëndëve. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione; seminare; studim individual, si studim e punim esesh,</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit</p>	



<p>organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>detyrash apo projektesh; prezantime, projekte/ese, provime dhe praktikë mësimore; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; praktika profesionale.</p> <p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione e seminare për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë e këtij programi. Gjuha zyrtare e prorgamit ëshë shqipja (<i>evidenca 7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Çdo lëndë në këtë program studimi përban qëllimin, objektivat, elementet e kontrollit të dijeve, temat e leksioneve dhe seminareve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, si dhe informacionet që lidhen me numrin e krediteve, numrin e orëve në auditor dhe individuale të studimit, emrin e titullarit, vitin dhe semestrin ku lënda përkatëse zhvillohet.</p> <p>Organizimi i programit të studimit (vit, semestra, javë etj.):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor;</li> <li>1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor;</li> <li>1 ECTS baraz me 25 orë mësimore pune të studentit;</li> <li>Ora mësimore ëshhtë 50 minuta.</li> </ul> <p>Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ECTS ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. (<i>Evidenca 11</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>ISE disponon një infrastrukturë të mirë sistemi informacioni në lidhje me informimin e studentëve përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kanalizimi i këtij informacion kryhet në rrugë të ndryshme. Brenda ambjenteve të institucionit gjenden fisha informuese për programin e studimit nën vlerësim. Në rregulloren e programit shprehen qartë gjithashtu këto informacione (<i>Evidenca 7; Evidenca 20</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Dimensionet e vogla të programit sa i përket numrit të studentëve bën të mundur që stafi akademik t'i sigurojë studentëve gjithë informacionin e nevojshëm sipas lëndëve zgjedhore ose të detyrueshme për semester. Një nga pedagogët e programit është edhe këshilltari i studentit për të regjistruar lëndët çdo semestër. Gjatë këtij takimi studentëve u vihen në dukje elemetet kryesorë procedural që duhen respektuar për të avancuar në proceset akademike si ngarkesa e punës orët në auditor, frekuentimi / ndjekja e programit dhe specifikat e secilës lëndë, duke i kushtuar vëmendje përbërësve të planprogramit të tilla si praktikat, ushtrimet ose orët laboratorike (<i>evidenca 7; evidenca 11; evidenca 7/2</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Programi i studimit ka qënë gjithmonë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm nga ana e Departamentit me kadencë vjetore. Në departament diskutohet përmbajtja e programeve të studimit, problemet që kanë dalë gjatë vitit akademik, si edhe risitë e fundit në fushat përkatëse. Brenda programit të studimit, mund të bëhen ndryshime deri në masën 20 % të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit Akademik të UT-së (<i>Evidenca 7, neni 10, pikat 2-4</i>).</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b></p>



standardit	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit MSH në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese është në pajtim me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale ( <i>Takimi me autoritetet drejtuese; evidenca 7 nenet 5-10</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Në programin e studimit nën vlerësim, lëndët themelore dhe metodat kërkimore janë të kombinuara me kurse të specializuara të avancuara të njohjes të institucioneve dhe së drejtës evropiane. Hartimi i këtij programi studimi është bërë duke marrë parasysh faktin që përmbajtja e objektivave të tij të jetë në përputhje me qëllimin/objektivat e programit, me kriteret dhe detyrimet për këtë program, si program i ofruar në nivelin master i shkencave, sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve të brendshme rregullatore të UT-së, për arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit. Fakulteti dhe Departamenti kanë kryer edhe studim tregu që ekzaminon edhe programin duke u interesuar për studentët që mbarojnë edhe për orientimin në tregun e punës ( <i>evidenca 15</i> ). Kështu, analiza e tregut shoqërohet edhe me vëzhgimet periodike të evolucionit të kërkesë/ofertës janë bazuar në nevojat që kanë sektori publik dhe privat për burime njerëzore në fushën e BE-së. Referuar lëndëve mësimore, programi i studimit arrin të përmbush objektivat formues të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit ( <i>evidenca 7; evidenca 14</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Departamenti përgjegjës i këtij programi, kryen analizë vjetore për të parë nëse janë arritur objektivat e programit si dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisht profesional për studentët ( <i>evidenca 14</i> ). Programi i studimit është hartuar duke mbajtura parasysh përcaktimet në lidhje me strukturën e programit të studimit MSH sipas kriterëve të vendosura nga VKM 41 (e sipërpërmendur) në përputhje me Planin e Zhvillimit të ISE-së 2021-2024, vizionin dhe misionin e tij, nevojat e tregut të punës, misionin e arsimit të lartë në vend ( <i>evidenca 7</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet	Syllabuset e lëndëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Legjislacion dhe institucione evropiane” parashikon se kontrolli i dijeve



midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	është i ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e pjesshëm dhe provimin përfundimtar. Konceptimi dhe ndarja mes veprimtarive formuese synon që studentët të kenë mundësi mobiliteti dhe transferimi studimesh, të konkurrojnë dhe të përshtaten denjësisht jo vetëm në kushtet e tregut vendas, por edhe më gjerë, siç përcaktohet edhe në dokumentat e hartuar nga ISE, UT. (evidenca 7; evidenca 11; evidenca 12)			
<b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Stafi akademik përgjegjës për zhvillimin e lëndëve në këtë program studimi përditëson çdo vit akademik programet e lëndëve, duke mundësuar për studentët literaturën më relevante për përfitim e dijeve. Në secilin syllabus pasqyrohet qartë kjo literaturë (evidenca 12).			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Në syllabuset e lëndëve tek pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e të nxënit, përshkruhet objektivi, synimet dhe kompetencat që studentët përfitojnë në fund të kursit. Në këtë program studimi, është mbajtur parasysh që të ketë një raport të përshtatshëm mes aspektit teorik dhe atij të trajtimit të rasteve praktike, apo dhe zhvillimit të praktikave profesionale/internshipeve. Po ashtu, në rregulloren e këtij programi të integruar është e përcaktuar qartë që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitim e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për studentët (evidenca 7). Në kuadrin e përmbajtjes së përgjithshme të programit të studimit në fjalë, GVJ konstaton se vijueshmëria është e mundshme në profesionet juridike/politike të sidomos në fushën e së drejtës evropiane. Studimi i tregut të punës tregon vëmendje nga ana e Institucionit kundrejt nevojave të tregut të punës. Po ashtu, nisur nga kërkesat e tregut të punës dhe prioritetet e vendit në lidhje me integrimin evropian, synohet një bashkëpunim më i ngushtë mes ISE si pjesë e UT-së me aktorë të tjerë vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 (evidenca 11; evidenca 15; evidenca 34).			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.				
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.				
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Përmbajtja e lëndëve dhe moduleve në këtë program MSH në “Legjislacion dhe Institucionet Evropiane”, krijon një bazë të vlefshme për vijueshmërinë e mëtejshme të studimeve qoftë për specializim për ciklin e dytë qoftë edhe për një formacion të ciklit të tretë (evidenca 7, neni 4, pika 4).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të	Departamenti i Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së, si



<p>pjeshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>njësia bazë në të cilin zhvillohet programi i studimit MSH në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ka në përbërje të tij personelin akademik efektiv (PAE) dhe personelin akademik me kontratë (PAK) duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet që burojnë nga Udhëzimi Nr. 29, dt. 10/09/2018 të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>- Për vitin akademik 2020-2021, në programin e studimit “Legjislacion dhe Institucionet Evropiane” janë angazhuar gjithësej 11 pedagoge ku 10 janë PAE dhe 1 PAK. (Evidenca shitesë A.5, Tabela 12.2) Nga PAE: 3 janë Prof Dr; 3 janë Prof. Asoc, 4 janë Dr. Nga PAK: 1 Dr. - Për vitin akademik 2021-2022, në programin e studimit “Legjislacion dhe Institucionet Evropiane” janë angazhuar gjithësej 11 pedagogë ku të gjithë janë PAE (Evidenca shitesë A.5, Tabela 12.3). Nga PAE: 3 janë Prof Dr; 3 janë Prof. Asoc; 5 janë Dr. Nga 11 PAE - 6 janë PAE të ISE dhe 5 janë PAE nga njësi të tjera të UT. Referuar të dhënave rezultojnë se ngarkesa mësimore mbulohet nga stafi akademik PAE mbi masën 70% në të tre vitet që në disponojmë të dhënat. Bazuar në të dhënave për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa mësimore e stafi të angazhuar në këtë program studimi varion nga 45 - 90 orë, në të gjitha programet mësimore ku stafi është i angazhuar. Numri i lëndëve që ata mbulojnë është 2 ose 3, me përjashtim të pedagoges E. B që mbulon 5 lëndë, me ngarkesë akademike 225 orë, por gjithmonë në përputhje me udhëzimin e MAS. Lëndët e zhvilluara janë përputhje me fushën e tyre të studimit, gjithashtu lëndët janë vazhdim ose thellim i njëra – tjetrës. Në CV-të e tyre gjenden eksperiencat dhe kualifikimet e nevojshme që përputhen me fushën e përfshirë në mësimdhënie. (Evidenca Aneksat tabela 4) Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, ku disa janë edhe me eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies, me tituj dhe grada shkencore, apo edhe eksperiencë në praktikë në pozicione të ndryshme në administratë dhe në sistemin e drejtësisë (Evidenca 11; evidenca 13).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pedagogët e angazhuar në këtë program, kanë kualifikimin e nevojshëm i cili përkon me fushën specifike të lëndës apo modulit ku ata japin leksione apo seminare. Përgjithësisht në Departament respektohet ekspertiza në lidhje me lëndët e ofruara dhe të trajtuara nga pedagogët. Studentët e pakët në program ka bërë që në vitet e kaluara të angazhoheshin pedagogë pjesërisht jashtë profilit, por ISE ka sjellë përmirësime në këtë aspekt sidomos me rritjen e numrit të pedagogëve të brendshëm (PAE) (evidenca 11; evidenca 13).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>ISE ka marrëveshje bashkëpunimi (aktive) me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, për realizimin e praktikës profesionale nga ana e studentëve. Për të finalizuar sa më mirë punimin e diplomës, studentëve u vjen në ndihmë edhe një Udhëzues për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së mikrotezës për diplomimin e studentëve në programet e ciklit të dytë të studimit MSH në ISE (evidenca 9; evidenca</p>



udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	28).								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Në saj të natyrës teorike të programit, nuk ka angazhim të posaçëm mbi këtë pikë. Nën kuptimin praktik, në këtë program studimi angazhon edhe personel ndihmës akademik dhe administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe të zhvillimit të institucionit. ISE ka në dispozicion edhe personel ndihmës IT i cili angazhohet në detyrat administrative të përgjithshme për realizimin e orëve mësimore parashikuar në silabus dhe për të mundësuar/fasilituar aksesin e studentëve në platforma online (evidenca 14; evidenca 24; evidenca 25; evidenca 26; evidenca 27).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyhet</th> <th>Përmbyhet pjesërisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht				X
Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbyajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	ISE, me qëllim përmirësimin e planit mësimor dhe programit të studimit në tërësi, në mbledhje departamenti diskuton mbi ndryshimet e mundshme në programet e studimit që ofron departamenti. <i>Do të ishte e udhës të krijoheshin struktura specifike që të reflektojnë nevojat e tregut kombëtar dhe atë ndërkombëtar të punës si edhe mendimet e profesionistëve të fushës dhe institucioneve për ta përshtatur sa më mirë këtë program me kërkesat e sotme dhe vazhdimisht në ndryshim të tregut të punës.</i> Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se në fund të programit të studimit realizohen konsultime dhe pyetësorë me studentët për çështjet e përgjithshme institucionale, përfshirë edhe programin e studimit (Takimi me stafin administrativ/studentët). Këshillat dhe sugjerimet e tyre konsultohen dhe reflektohen në funksion të përmirësimit të programit të studimit MSH “Legjislacion dhe institucionet evropiane” (Evidenca 14; Evidenca 15; Evidenca 31; Evidenca 34).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	ISE përpiqet të ruajë kontaktet me studentët e diplomuar në vite, dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin, si përfaqësues më të mirë të vlerave të tij. <i>Sugjerohet strukturimi i kësaj strukture nëpërmjet një komunikimi konstant qoftë përmes postës elektronike, mediave sociale apo vizitave të ndërsjella.</i> Bashkëpunimi dhe Partneriteti me universitete të tjera, si dhe organizata qeveritare e joqeveritare kanë qenë në qendër të vëmendjes së ISE këto vitet e fundit, në veçanëti nga momenti i miratimit të Planit të Zhvillimit të ISE-së 2021-2024, me fokus Ndërkombëtarizimin. Qëllimi i ISE gjatë dy viteve
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të	



posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	të fundit ka qenë mbajtja dhe përmirësimi i një rrjeti të partneriteteve dhe marrëdhënieve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe programet “Jean Monnet” e tregojnë këtë ( <i>evidenca 5; evidenca 14; evidenca 15; evidenca shitesë B.1; evidenca shitesë B.2</i> ).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në Planin e Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022) si dhe Strategjinë e Zhvillimit të UT-së (2018-2023), përcaktohen prioritetet e zhvillimit dhe objektivat kryesorë të studimit ( <i>Evidenca 4; evidenca 5</i> ). Në përputhje me këtë plan strategjik të UT-së, edhe ISE ka përcaktuar prioritetet e saj. ISE me anë të marrëveshjeve të saj të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në projekte dhe aktivitete kërkimore-shkencore, ka gërshtuar veprimtarinë mësimdhënëse me aktivitete dhe veprimtari të tjera akademike e kërkimore, të tilla si. p.sh. konferenca, seminare, projekte etj., duke i dhënë mundësi dhe motivuar stafin për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore dhe shkëmbimi (p.sh. Programet e shkëmbimit Erasmus+, projekte kërkimore, Jean Monnet etj). Realizimi i këtij synimi kërkon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjelltë ( <i>evidenca 14; evidenca shitesë A.2</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi dhe disa janë drejt finalizimit, veç atyre ku ISE përfshihet si njësi kryesore e UT-së. Ndër to do të përmendnim marrëveshjen me Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Brno-s, Republika Çeke; Avokatin e Popullit, Agjencinë e Prokurimit Publik; Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, si edhe janë dakordësuar paraprakisht e janë në hapat e fundit marrëveshjet me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kolegji i Europës, Belgjikë; Universiteti i Molise-s, Itali (në proces). Po ashtu, janë zhvilluar dy kurse trajnimesh të vazhduara si “EU Integration - Background & Perspective” kurs trajnimi të vazhduar (3 ECTS), me Profesor Hubert Petit, ish-zv.ambasador i BE-së në Tiranë, “Doctor Horis Causa” i Universitetit të Tiranës, mars-prill 2020, organizuar nga Instituti i Studimeve Evropiane; dhe Shkolla dimërore “EU meets China, Understanding the EU-China Relationship”, 11-25 tetor 2021, organizuar nga ISE në bashkëpunim me Institutin “Konfuci”, UT ( <i>evidenca shitesë A.1.2; . evidenca shitesë A.12; evidenca shitesë B.6</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në lidhje me realizimin e këtyre aktiviteteve, ISE mbështetet nga UT mbi bazën e planifikimit të bërë për këtë qëllim një vit më parë (parashikimet në projekt-buxhetin e ISE-së). Këto të ardhura administrohen nga ISE përmes Zyrës së financës të institutit. Personeli akademik, njësia bazë apo studentët kanë të drejtë të aplikojnë pranë
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	



	Institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare për realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe krijuese. Të ardhurat nga kjo veprimtari përbëjnë një zë të veçantë në buxhetin e ISE-së, që shërbejnë posaçërisht për këtë qëllim. Në buxhetin që përcaktohet për ISE (ashtu si dhe për çdo njësi kryesore), përcaktohet dhe një fond që duhet të mbështesë veprimtarinë mësimore/shkencore dhe botimet përkatëse (evidenca 2).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Sipas RVB dhe konstatimeve gjatë vizitës, Institucioni përpiqet të jetësojë lidhjet me universitete të tjera dhe ente të tjera kërkimore shkencore. Grupet kërkimore të krijuara në të gjithë universitetin, duke përfshirë ISE, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e strategjive kërkimore dhe shtyllave kërkimore të universitetit, si dhe në aplikimet për grante evropiane dhe të tjera të financuara ngajashhtë. ISE tashmë ka fituar dhe po implementon: 1 projekt Jean Monnet Chair, me synim ngritjen e kapaciteteve dhe thelimin e njohurive në fushën e integritit evropian; 1 Jean Monnet Module, "Harmonization and normalization of the terminology ëithin the EU Integration context (HNTEUI)", duke synuar krijimin e një baze të dhënash dhe aftësimin e kapaciteve njerëzore në harmonizimin dhe standardizimin e terminologjisë në kontekstin e integritit në BE; është partnere në Jean Monnet Centre of Excellence (FHF) "Europianizimi i Politikave Publike në Shqipëri", etj. (Evidenca 5; evidenca 15; evidenca 28; evidenca shtesë B.2).			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.				
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	ISE mbështet një mjedis përfshirjeje dhe bashkëpunimi për stafin e tij. Anëtarët e stafit të sapoemëruar lehtësohen nga materialet hyrëse të dorëzuara nga Përgjegjësi i Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit siguron procesin e trajnimit të kurrikulave duke ofruar njohuri mbi mënyrën e përgatitjes së programit mësimor dhe një shpjegim të Rregulloreve të ISE ( <i>Evidenca 7</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në UT ka për qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe në bazë të përcaktimeve statutoare janë krijuar strukturat përgjegjëse me në krye KPSSC që vepron në nivel institucional. Po ashtu, ISE ka ngritur së fundmi edhe njësinë e saj të sigurimit të cilësisë si strukturë të përbërë nga 1 pedagog dhe një student, gjë që synon të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin me strukturat institucionale për garantimin e cilësisë, duke përfshirë këtu edhe monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive mësimdhënëse të tij. <b>Struktura e sapokrijuar, u afirmua gjatë vizitës është në ndërtim e sipër të praktikës së punës.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Studentët realizojnë vlerësimin formave të mësimdhënjes dhe mësimnxënjes, e performancës së stafit akademik, nëpërmjet kontrolleve periodike dhe analizave. Në këtë aspekt, studentët vlerësojnë pedagogët në mënyrë anonime si edhe nëpërmjet fokus-grupeve me studentë për marrjen e mendimit të tyre dhe këto vlerësime mbeten një nga elementët kryesorë për arritjen e cilësisë akademike ( <i>takimi me stafin drejtues dhe me stafin administrative; evidenca 17</i> ). Këto mënyra vlerësimi u evidentuan edhe gjatë vizitës e pasqyrohen edhe në Raportin Vjetor të ISE ( <i>evidenca 14</i> ). Ankimimi është i parashikuar në aktet rregullatore të brendshme të institucionit. Studenti pasi njihet me vlerësimin në tezën e provimit ka të drejtën e ankimit me shkrim brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultateve. Procedurat e ankimit rregullohen në Rregulloren e UT-së. ( <i>Evidenca 6, nenet 50-51</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në përfundim të çdo viti akademik, UT harton raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore mbi analizën e programeve të studimit, ku përfshihet edhe programi studimit nën vlerësim. UT-ja dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit në përputhje me format e miratuara nga Senati Akademik i UT-së. Komunikimi dhe publikimi kryhen në këto mënyra:
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoritete përkatëse;</li> <li>• Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm bëhen publike.</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike.</li> <li>• Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmblodhur;</li> <li>• Raportet e vlerësimeve individuale të personelit akademik, ndihmëskademiq dhe administrativ u komunikohen individëve;</li> <li>• Rezultatet e vlerësimit u komunikohen individualisht studentëve.</li> </ul> <p>UT publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë akademike, transparencën dhe etikën akademike, LAL dhe akteve të tjera rregullatore në fuqi. (Evidenca 16, neni 32).</p> <p>Të dhënat e përftuara nga këta pyetësorë, pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij, për të nxitur dhe inkurajuar përmirësime të mëtejshme.</p> <p>(Evidenca 14 ; Evidenca 18; evidenca shtesë A.15; evidenca shtesë B.7)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët kanë qenë përgjithësisht adekuate/bashkëkohore dhe kjo flet për përpjekje serioze nga ana e stafit të ISE në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjatë procesit mësimor, stafi akademik përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies, siç janë mjetet audio-vizive. (evidenca 7; evidenca 23). Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në “Legjislacion dhe institucionet evropiane”, përmes metodave të mësimdhënies, të cilat janë të lidhura dhe me qëllimin dhe objektivat e lëndëve përkatëse, përdor metoda të ndryshme si ato analitike dhe sokratike të transmetimit dhe kontrollit të dijeve. Institucioni është përgjegjës dhe i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij nga çdo sugjerim që vjen qoftë nga studentët qoftë edhe nga subjektet e tjera publike dhe private. ISE siguron mundësi të barabarta pranimit tek studentët pavarësisht racës, fesë, seksit, origjinës etnike, orientimit seksual, statusit personal dhe paafësive fizike (evidenca 6; evidenca 7; evidenca shtesë A.6).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me</p>	<p>ISE ka një politikë mbështetëse dhe promovuese ndaj personelit të tij akademik në mënyrë që rrisin aftësitë e tyre profesionale dhe pedagogjike. <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit janë të shumta, por shkëmbimet e personelit mbeten të kufizuara, gjë që do ndihmonte në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</i> Personeli akademik është</p>



rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	kompetent në lidhje me programet e studimit dhe përgjithësisht në përputhje me fushën kërkimore të lektorit me lëndën specifike që ai mbulon megjithëse syllabusi është i qartë dhe korrekt. Përdoren metoda alternativa të mësimdhënies si edhe aktivitete stimuluese të studentëve. Studentët nxiten që të japin mendimin/qëndrimin e tyre kritik për çështje të caktuara që dikutohen, raste praktike/kazuse të ndryshme, me qëllim nxitjen e arsytimit dhe të menduarit kritik. Përdoren gjatë mësimdhënies metoda kontemporane dhe sallat janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e seminareve, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve. Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nepermjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Studentët nxiten që të japin mendimin/qëndrimin e tyre kritik për çështje të caktuara që dikutohen, raste praktike/kazuse të ndryshme, me qëllim nxitjen e arsytimit dhe të menduarit kritik. Përdoren gjatë mësimdhënies metoda kontemporane dhe sallat janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e seminareve, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve. Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nepermjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	<i>Mungon një sistem automatik dhe elektronik të kontrollit të sistemit antiplagjaturë, por gjatë vizitës na u konfirmua që janë duke e instaluar dhe do të vihej në punë shumë shpëjtë. (evidenca 26; evidenca 27).</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Stafi akademik në programin e studimit nën vlerësim përdor forma mësimdhënie që inkurajojnë autonominë tek studenti. Sipas përgjigjeve të studentëve gjatë vizitës së GVJ-së rezulton se ata kanë ndërtuar një marrëdhënie respektit të ndërsjellë me pedagogët. Studentë dhe pedagogë shkëmbejnë mendime dhe argumente lidhur me çështjet që shtrohen për zgjidhje. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale. <b>Megjithatë gjatë vizitës u konstatua mungesa e një rregulloreje etike (Evidenca 11; evidenca 12; evidenca shtesë A.3)</b>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Stafi akademik në programin e studimit nën vlerësim përdor forma mësimdhënie që inkurajojnë autonominë tek studenti. Sipas përgjigjeve të studentëve gjatë vizitës së GVJ-së rezulton se ata kanë ndërtuar një marrëdhënie respektit të ndërsjellë me pedagogët. Studentë dhe pedagogë shkëmbejnë mendime dhe argumente lidhur me çështjet që shtrohen për zgjidhje. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale. <b>Megjithatë gjatë vizitës u konstatua mungesa e një rregulloreje etike (Evidenca 11; evidenca 12; evidenca shtesë A.3)</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Programi i studimit MSH "Legjislacion dhe institucionet evropiane" realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. Sallat në të cilat zhvillohet procesi mësimor dhe shkencor janë objekte të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare. Ambientet ku zhvillohet procesi mësimor janë rikonstruktuar duke mundësuar zhvillimin normal të aktivitetit dhe veprimtarisë akademike.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Disa prej tyre janë të pajisura edhe me logjistikën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe akademik, duke plotësuar kërkesat për zhvillimin normal të veprimtarive të këtij program studimi. (evidenca



<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>23). Ambientet si salla leksionesh, salla seminaresh, biblioteka apo facilitate të tjera janë të pajisura me logjistikën e duhur mësimore si pc, projektor dhe janë me komfortet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor. Biblioteka është e hapur gjatë ditës dhe studentët mund të aksesojnë kopjet e nevojshme për studimet e tyre. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së IT së ISE (evidenca 14). Labororët ndihmës për personelin akademik dhe studentët janë të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat akademike. Në dispozicion të programit janë edhe platforma si: Microsoft Teams për mësimin online apo aktivitete të tjera akademike. Ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audiovizive etj. (evidenca 23; evidenca shtesë A.11).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura e paraqitur në syllabuse (ajo e detyrueshme dhe fakultative) gjendet me lehtësi në bibliotekën e ISE. Kjo literaturë në disa kopje dhe është në dispozicion të studentëve. Po ashtu, ofrohet mundësia edhe për akses të studentëve në biblioteka online, pa pagesë. Po ashtu, në dispozicion të studentëve por edhe të stafit janë edhe bibliotekat online, si: JSTOR (pjesë e marrëveshjes së UT-së me AADF), COBISS+, etj. Nga vizita në institucion dhe biseda me stafin dhe studentët kjo strukturë garanton aksesin e teksteve kryesore të propozuara nga lektorët. ISE ka bërë një marrëveshje bashkëpunimi me FHF, për të aksesuar fondin e bibliotekës së këtij fakulteti. Kështu që kjo bibliotekë dhe kapacitetet e saj shfrytëzohen edhe nga stafi dhe studentët e ISE-së. Biblioteka garanton një numër të kënaqshëm botimesh. Mënyra e pasurimit të bibliotekës është e institucionalizuar me kërkesa drejtuar njësisë bazë në funksion të titujve të librave për të cilat kanë shprehur interes kryesisht lektorët. Gjatë vizitës në bibliotekë u konstatua blerja e teksteve me vlerë për programin nën vlerësim, si edhe në fushën e BE-së në përgjithësi (evidenca 23; evidenca 29; evidenca shtesë A. 9).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura laboratorike dhe postet e punës me PC janë në nivel të duhur dhe plotësojnë nevojat e studentëve. Ambientet mund të aksesohen në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. Në kushtet e zhvillimit të mësimin online, stafi i IT-së së universitetit ka garantuar aksesin për personelin akademik dhe studentët për të zhvilluar mësimin online, përmes aksesit në platformën Microsoft Teams dhe për të facilituar përdorimin e saj nga pedagogët dhe studentët, veçanërisht në dy vitet e kaluara kur mësimi dhe provimet zhvilloheshin online. Personeli akademik dhe studentët përdorin tashmë komunikimin elektronik dhe platformën Microsoft Teams jo vetëm për zhvillimin e mësimin gjatë pandemisë, por edhe për lehtësimin e kontakteve përmes adresave me domainin @unitir.edu.al, si një mundësi e mirë për komunikim të brendshëm efektiv, që mundëson edhe komunikim më të shpejtë mes tyre, i.e. për efekt të njoftimeve të ndryshme, notave, vlerësimeve, detyrave, të kontakteve, materialeve mësimore etj. (Evidenca 23; evidenca 24; evidenca 27).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	




<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Duke u nisur nga numri i studentëve personeli akademik është i mjaftueshëm për ti ndjekur ato efektivisht dhe për ti udhëhequr në punimet e diplomës. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, duke respektuar kërkesat dhe detyrimet për një temë diplome të nivelit MSH, sipas kriterëve e standardeve të miratuara për këtë qëllim në Udhëzuesit për përgatitjen e temës së diplomës dhe diplomimin e studentit ( <i>evidenca 7; evidenca 9</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni organizon trajnime për stafin akademik në funksion të metodave inovative të mësimdhënies, përmes trajnimeve dhe ëorkshop. UT ka ngritur në nivel institucional strukturën kryesore që merret me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë, që është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) në nivel UT, i cili bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Ky komision bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë, sipas përcaktimve në Statut. ( <i>evidenca 2, neni 41 dhe Kreu IX</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Gjithashtu, për të mbështetur personelin akademik të UT-së në realizimin e objektivave të tyre kërkimore dhe krijimin e mundësive për avancim në karrierë, UT zbaton programin “UT- kërkim, ekselencë dhe inovacion”, ku novacioni është një nga boshtet kryesore të tij. Udhëzuesi në lidhje me këtë program jep informacionin e nevojshëm për paraqitjen e propozimeve si dhe detajon procedurat për dorëzimin e aplikimeve nga radhët e stafit akademik të UT-së. Në rritjen e cilësisë së mësimdhënies kontribuon edhe Qenda Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT, ngritur me Vendim të Senatit Akademik të UT-së, nr. 48, dt. 25/11/2021. Nga krijimi i saj, kjo Qendër ka zhvilluar një sërë trajnimesh online për stafin e UT-së me tematika të ndryshme. <a href="https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnitimit-dhe-zhvillimit-profesional">https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnitimit-dhe-zhvillimit-profesional</a>
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	( <i>Evidenca 32; evidenca shtesë A.12</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirja e tyre në projekte të ndryshme të sipërmarrjeve private, institucioneve shtetërore, dhe organizmave ndërkombëtare trasmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e	



<p>programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>aktualizon dijen në çdo fushë studimi. <i>Mbetet në përgjegjësinë e personelit akademik që të gjejë mundësitë më të mira që të për rritjen e aftësive dhe metodat e reja për përmirësimin e aftësive akademike.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>UT në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë të ndryshëm vendas apo të huaj, angazhon në këtë program studimi edhe lektorë të ftuar, vendas apo të huaj, me qëllim rritjen e shkëmbimit, forcimin e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Kështu p.sh. janë zhvilluar dy kurse trajnimesh të vazhduara:  1. “EU Integration - Background &amp; Perspective” kurs trajnimi të vazhduar (3 ECTS), me Profesor Hubert Petit, ish-zv.ambasador i BE-së në Tiranë, “Doctor Horis Causa” i Universitetit të Tiranës, mars-prill 2020, organizuar nga Instituti i Studimeve Evropiane;  2. Shkolla dimërore “EU meets China, Understanding the EU-China Relationship”, 11-25 tetor 2021, organizuar nga ISE në bashkëpunim me Institutin “Konfuci”, UT.  3. Leksion i hapur me z. Michele Ribotta, Përfaqësuesi UNWOMEN në Shqipëri, me temë “Rëndësia e promovimit të të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Roli i UNWOMEN në Shqipëri në promovimin e barazisë gjinore”, leksion ky i mbajtur në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, mars 2022, ISE. (<i>Evidenca 28; evidenca shtesë B.5</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit MSH “Legjislacion dhe institucionet evropiane” i ka të përcaktuara në rregullore të programit mënyrën e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit (<i>Evidenca 7, nenet 21-25</i>). Edhe pse disa kurse kanë një lloj vlerësimi të ndryshëm të miratuar nga ISE, në përgjithësi, vlerësimi i studentëve është si më poshtë:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>20% provim afatmesëm  60% provim përfundimtar  10% project/detyrë kursi  10% pjesëmarrje aktive.  Këto forma ndryshojnë nga lënda në lëndë ndaj dhe jepen brenda kufijve psh: Testimet gjatë vitit është nga 10-20% (pra disa lëndë e kanë 10 % dhe disa të tjera 20 %) (<i>evidenca 12</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Në këtë program studimi, pedagogu titullar i lëndës para fillimit të çdo semestri informon studentët për tematikat që do të zhvillohen, qëllimin si dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve. Rregullat e përgjithshme u dërgohen studentëve në fillim të semestrit. Rregullorja e programit që ata</p>



	ndjekin parashikon informacionin e duhur për vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës në këtë cikël studimi, institucioni ka përgatitur edhe një Udhëzues (evidenca 7; evidenca 9).			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.6

**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentëve lidhur me dijet, njohuritë e marra dhe aftësitë profesionale për modulën përkates përbëhet nga disa komponentë, e realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke dhënë në fund rezultatin/notën përfundimtare. Shkalla e përvetësimit të dijeve/vlerësimi bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 pikë (në përqindje nga 0-100%) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me shkronja nga F në A. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga E në A janë kaluese (Evidenca 7, neni 21; evidenca 12).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësimi i provimeve bëhet i sekretuar/mbyllur për të garantuar objektivitetin në vlerësim dhe për të rritur transparencën. Në kushtet e mësimit online, UT ka implementuar testimin përmes platformës elektronike MS. Teams, duke garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm/të shpejtë të vlerësimit për studentët. <i>Sa i përket sistemit antiplagjaturë, mungon një i tillë, por gjatë vizitës u referua se janë duke punuar për të instaluar një të tillë</i> (Evidencat 26; evidenca 27).
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në përfundim të semestrit studentët testohen nëpërmjet një teze provimi. Teza hartohet nga titullari i lëndës sipas formatit të miratuar për këtë qëllim. Pedagogu harton tezat e provimit, të cilat çdo vit duhet të jenë të riformuluara e të azhornuara dhe gjithëpërfshirëse, dhe t'i nënshkruajë ato tek përgjegjësi i departamentit. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga të cilët njëri duhet të jetë i brendshëm. Në fund të çdo kursi, studentët duhet të kenë kaluar provimin afatmesëm dhe provimin përfundimtar. Përsa i përket kontrollit të njohurive, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore Zhvillimi i provimeve në auditor monitorohet/mbikqyret nga pedagogu/pedagogët e lëndës. Gjatë provimeve, studentët monitorohen rreptësisht që të mos kopjojnë. Pedagogu mund të bëjë konsultime pas provimit, për t'i njohur studentët konkretisht me vlerësimin dhe gjatë vizitës u konstatua se kjo ishte një praktikë përgjithësisht e ndjekur (Evidenca 6; evidenca 7; evidenca 26)
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe	Stafi akademik i këtij programi studimi informon studentët për rezultatet e provimit, proces i cili realizohet dhe me mbështetjen e stafit ndihmës akademik. Tezat e korrigjuara të provimit përmbajnë pikët e fituara nga



lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	studentët dhe komentet përkatëse të nevojshme për një informim sa më korrekt dhe akademik të studentëve. Studentët kanë të drejtë të njihen me tezën e provimin dhe në rast se duhen informacioni apo shpjegime më të detajuara në lidhje me vlerësimin, zyra apo personi përkatës kontakton pedagogun ( <i>Evidenca 6, neni 51</i> ).			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësia përgjegjëse si edhe njësia kryesore nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra duke u bazuar në rregulloret institucionale dhe rregulloren e programit të studimit ku parashikohen rregullat për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës. Gjithashtu edhe Udhëzuesi, tek pjesa mbi Standartet etike të sjeiljes së studentëve parashikon ndër të tjera detyrimin e tyre për të respektuar etikën gjatë procesit mësimor, të mos bëjnë tentativë për mashtrim apo çënim të rregullave të procesit akademik, të mos paraqesin punime apo projekte si të tyre kur kanë dijeni se janë të dikujt tjetër etj. <i>Institucioni nuk ka adoptuar një Kod Etike specifik mbi sjelljet e studentëve dhe nuk ka në sistem elektronik të kontrollit antiplagjaturë (evidenca 7; evidenca 9).</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e përgjithshme e UT-së dhe rregullorja e programit të studimit MSH në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” ka të përcaktuar mënyrën e organizimit të provimeve; afatin e korrigjimit të provimeve dhe; dhënien e razulatëve përkatëse për studentët, përmes sekretarisë mësimore. Pas korrigjimit të provimeve, procesverbalet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve nga data e afishimit të rezultateve përfundimtare ( <i>Evidenca 6; evidenca 7</i> ). Mbas shpalljes se rezultateve të provimit dhe hedhjes së tyre në sistem studentët kanë mundësi të leximit të notës së tyre në sistem ose marrjes së rezultatit në sekretarinë mësimore. Në vijim studentët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e pedagogut, i cili është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me komentet. Në rast student nuk bindet në lidhje me provimin, departamenti do të formojë një komision ad hoc për të kontrolluar provimin. Në rastin e krijimit të një komisioni ad-hoc, procesi fillon me një kërkesë me shkrim të studentit dhe procesi menaxhohet nga përgjegjësi i departamentit. Në rast se përgjegjësi i departamentit e gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit/drejtorit i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rihvillimin e provimit. Sidoqoftë, si nga RVB, si nga takimet është verifikuar se kjo mbetet një procedurë e jashtëzakonshme dhe shumë pak e përdorur ( <i>Evidenca 6, neni 50-51</i> ).			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.				
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>	



**Standardi III.7****Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Planet mësimore dhe programet e lëndëve kanë synim kryesor aftësimin teorik dhe praktik të studenteve duke synuar veçanërisht njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e legjislacionit dhe institucioneve evropiane. Lëndët ndahet në dy pjesë, në pjesën e parë jepen njohuri të përgjithshme, në pjesën e dytë jepen aftësi të veçanta duke përfshirë në disa raste edhe elementë kërkimorë. ISE përfshin në analizën vjetore edhe atë të syllabuseve, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara fillimit të procesit mësimor. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Përgjatë programit, lëndët ndërlihen me njëra tjetrën në kuptim logjik drejt thellimit dhe specifikimit të dijeve, duke ofruar kryesisht lëndë të përgjithshme në tre semestrat e parë e në vijimësi, me lëndët më të specializuara. Në fund të lëndës, testohen aftësitë e fituara nga studenti nëpërmjet testimit me shkrim ose me gojë, një temë projekti, rezultatet nga udhëheqesi i praktikës profesionale dhe të gjitha këto grumbullohen në kompetencat e aftësitë personale të studentit. Vlerësimi final i referohet disa elementëve: provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar, aktivizimit gjatë seminareve, si dhe detyrave të kursit, me pikëzimin përkatës që parashikohet në syllabusin e çdo lëndë, varësisht nga specifikat e lëndës. Personeli akademik bën një përmbledhje të provimit, zbatimin e tyre në praktikë si dhe u demonstron atyre raste praktike studimi. Analizimi i programit, temave të leksioneve e seminareve dhe javëve mësimore të përcaktuara sipas planit kalendar, bëhet me qëllim evidentimin e problematikave që lidhen me realizimin e tyre si edhe orientimin e studentëve. Kjo i shërben fokusimit si në përvetësimin e përmbajtjes së programit, ashtu dhe për tu orientuar më mirë në lidhje me përmbylljen e programit me provimin përfundimtar, sipas përcaktimeve aktet rregullative të brendshme përkatëse (Evidenca 7; evidenca 11; evidenca 14).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lëndë/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

37



krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	organizohen çdo vit me qëllim motivimin e tyre dhe zhvillimin e ideve dhe qasjeve origjinale të tyre në fushë. Për më tepër, studentët lidhen më tej me akademinë duke shkruar punime shkencore. Si shembuj përmenden organizimi i aktivitetit “AGORA STUDENTORE: Procesi i Integritetit evropian dhe Integriteti”, i organizuar në kuadër të Javës së Integritetit (13 dhjetor 2021), ku u botuan edhe referimet e studentëve mbulohet financiarisht nga ISE.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Po ashtu përmendet Laboratori i Debatit mbi Integrimin Evropian në auditorët universitarë, aktivitet ky kishte si qëllim zhvillimin e njohurive dhe analizën kritike të studentëve dhe kërkuesve të rinj lidhur me integrimin evropian të vendit, si dhe të promovojë kulturën e debatit në universitetet shqiptare, etj. (Publikime dhe Konferenca ise.edu.al; <a href="https://www.facebook.com/InstitutiStudimeveEvropiane">https://www.facebook.com/InstitutiStudimeveEvropiane</a> ) Githashtu falë marrëveshjeve të bashkëpunimit studentëve u mundësohen programe shkëmbimi. Kështu p.sh. në vitin akademik 2020-2021, 2 studentë të ISE-së janë bërë pjesë e programit të mobilitetit studentor Erasmus + dhe 10 kanë përfituar nga projekte të ndryshme bashkëpunimi (Evidenca 12; evidenca 14; evidenca 28).			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studentët diplomohen duke mbrojtur një temë diplome. Në përbërje të tij janë 2 pedagogë. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës në këtë cikël studimi, ISE ka përgatitur edhe një Udhëzues lidhur me procedurën për përgatitjen dhe mbrojtjen e mikrotezës si dhe diplomimin e studentëve që i vihet në dispozicion studentëve. Studentët e ciklit të dytë të studimeve mentorohen që nga momenti i përzgjedhjes së temës deri në prezantimin dhe mbrojtjen e saj përpara jurisë. (evidenca 7; evidenca 9).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse si Instituti, Departamenti, Sekretaria Mësimore si dhe të gjithë pedagogët udhëheqës, asistojnë studentët gjatë procesit të diplomimit. Kriteret, standardet si dhe procedurat e testimit final si dhe diplomimit, janë të pasqyruara në rregulloret përkatëse dhe u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet broshurave dhe mjeteve elektronike. Mbrojtja e diplomës është publike (evidenca 7; evidenca 9).
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët	Studentët pasi janë njohur me stafin akademik dhe specializimet e tyre, që



në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	të krijojnë një ide më të mirë të temave që stafi akademik mbulon. Në përcaktimin e temave të diplomës, Departamenti i Legjislacionit dhe Politikave të BE-së merr parasysh bankën e temave të shpallura nga pedagogët përkatës që angazhohen në këtë program studimi, si dhe propozime të caktuara që mund të vijnë nga studentët. Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i UT-së, të profilizuar në fusha të caktuara. (Evidenca 7, evidenca 9).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	ISE dhe Departamenti përkatës asiston studentët në hartimin e diplomës, kontrollit të literaturës brenda fushës së studimit. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët për aftësimin e tyre në metodat e kërkimit shkencor. Studentëve iu vihen në dispozicion mjediset e Universitetit si dhe te institucioneve të tjera publike apo private me të cilat ISE ka marrëveshje me qëllim mbështetjen e punës së tyre kërkimore. Shpenzimet lidhur me realizimin e temës së diplomës i merr përsipër studenti, ndërsa institucioni ka për detyrë t'i ofrojë bazën e materialeve studimore si libra, kërkime shkencore, laboratore etj. (Evidenca 28)
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i Diplomës kontrollon në mënyrë të imtësishme punën e secilit student duke dhënë vërejtje me shkrim për çdo fragment pune si dhe sugjeron literaturën e nevojshme për t'u konsultuar më qëllim arritjen e një produkti të thelluar studimesh. Pedagogët që udhëheqin studentët për të përgatitur tezën përfundimtare janë njohës të mirë të fushës, me eksperiencë në akademi dhe me aktivitet kërkimor e botues. Punimi i diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit dhe rregullat e etikës akademike që zbatohen në UT, duke evituar plagjaturën. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet, deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit. Në përfundim të saj dhe para mbrojtjes, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij dhe e firmos temën e diplomës që studentin do mbrojë para komisionit në ISE (Evidenca 7; evidenca 9).
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Studentët mund të mbrojnë tezën e tyre vetëm nëse i kanë kaluar të gjitha kurset. Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur për këtë qëllim dhe vlerësohet me notë. Një formular i paracaktuar plotësohet nga secili anëtar i komisionit, në të cilin jepet nota e temës. Ndërkohë, diplomimi përfundon me mbrojtjen e temës me gojë para komisionit. (Evidenca 7, neni 25).
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë si edhe është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimeve të Studentëve (QSHA). Shtojca e Diplomës jep gjithë informacionin e kërkuar për programin MSH në "Legjislacion dhe institucionet evropiane", si dhe rezultatet e të nxënies dhe aftësitë që merren me përfundimin e secilit program (evidencat 1.22; 1.23). Në përfundim të programit të studimit, nëse mbrohet me sukses teza, studentin merr një kopje zyrtare të programit të studimit. Për më tepër, brenda pak muajsh, studentët marrin gjithashtu diplomën e shoqëruar me suplementin e diplomës (Evidenca 7; evidenca 7/1).
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të	Institucioni ruan dokumentacionin e studentit dhe paraqet informacion për çdo student nëse kërkohet. Në përfundim të këtij programi studimi,



dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me kërkesën e tij. Pas diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse të nivelit të dytë Master i Shkencave në "Legjislacion dhe institucionet evropiane" shoqëruar me suplementin e saj. (Evidenca 7; evidenca 7/1).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Referuar akteve të vënë në dispozicion, vërehet se institucioni zotëron të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e anëtarëve të personelit akademik, të gradave e titujve që këta të fundit zotërojnë, përmbledhje të jetëshkrimeve, etj. (Evidenca shitesë A.5, tabelat 1, 2, 6-8; Evidenca "CV e stafit të angazhuar në vite"; Evidenca 13). Të dhënat janë të administruara për personelin akademik si dhe për atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ (Evidenca shitesë A.5, tabelat 1, 2, 8). Të dhënat janë mbajtur në mënyrë të detajuar lidhur me angazhimin e tyre çdo semestër dhe vit akademik (Evidenca shitesë A.5, tabela 4; Evidenca 14, pika 5). Institucioni, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm, ka përcaktuar dokumentet që duhet të përmbajë dosja e secilit pjesëtar të personelit akademik dhe administrativ dhe që duhet të administrohen nga zyra e burimeve njerëzore (Evidenca 2, nenet 67, 68, 80, 81). Dokumentacioni që ka të bëjë me punësimin e personelit akademik dhe atë ndihmës-akademik e administrativ, administrohet nga sektori i burimeve njerëzore, që është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të Rektoratit të UT-së (Evidenca 2, neni 44). Kopje e këtij dokumentacioni që lidhet me personelin, stafin akademik dhe angazhimin e tij në procesin akademik si dhe për personelin ndihmës akademik e administrativ, mbahen dhe pranë strukturës së burimeve njerëzore në ISE.



	<p>Gjatë vizitës në ISE u panë në zyrën e burimeve njerëzore, sipas përzgjedhjes rastësore, dosje personale të personelit akademik si me kohë të plotë ashtu dhe të pjesshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tyre rezultoi që të dhënat e administruara ishin të plota dhe përfshinin kopje origjinale si dhe të njësuara me origjinalin të: jetëshkrimit, dokumentit të identifikimit, diplomën universitare dhe të listës së notave, diploma dhe dokumente të tjerë që vërtetojnë gradat dhe titujt e fituar, kualifikimet e ndryshme, librezën e punës dhe atë shëndetësore e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, etj. (Evidenca shtesë "Minuta Msc").</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në aktet e brendshëm të UT janë parashikuar kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik në përputhje me parashikimet e nenit 64 të ligjit Nr. 80/2015.</p> <p>Konkretisht, njësia bazë përcakton kriteret e veçanta shtesë për vendet e punës, mbështetur mbi kategorinë e personit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga rektori. Kriteret e punësimit i përcillen rektorit nga drejtuesi i njësisë kryesore. Njësia kryesore bën shpalljen përkatëse në faqet zyrtare të internetit. Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin <i>ad hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Ky komision, brenda afateve të caktuara në statut, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpanjeshme që janë, vlerësimi i dosjes dhe intervista. Intervistës i nënshtrohen vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve. Në vijim të procedurës, komisioni shpall kandidatin apo kandidatët fitues. Mandej, komisioni <i>ad hoc</i> i paraqet kandidatin apo kandidatët fitues rektorit të UT-së nëpërmjet drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori, brenda 10 ditëve nga shpallja e kandidatit fitues, nënshkruan kontratën e punës me të, që është dhe momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës (Evidenca 2, neni 67; Evidenca "Model kontratash").</p> <p>Në mënyrë të detajuar, procedurat për rekrutimin e personelit akademik shtjellohen dhe zbatohen në manualin për punësimin e stafit të UT-së, e cila vjen në zbatim të ligjit të aplikueshëm në fushën e arsimit të lartë si dhe të statutit të universitetit (Evidenca 19).</p> <p>Gjatë punës për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm, GVJ ka pasur në dispozicion Rregulloren e Përgjithshme të UT-së, të miratuar me vendimin Nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, të ndryshuar, mbështetur në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, të ndryshuar, i cili është shfuqizuar. Gjatë procesit, ka rezultuar se me vendimin Nr. 20, datë 27.7.2022 të Senatit Akademik të UT-së, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja e Përgjithshme e re, e këtij institucioni, publikuar në faqen <i>online</i> të IAL (<a href="https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/">https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/</a>) ku parashikohen ndër të tjera kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik, në</p>



	përputhje me parashikimet e nenit 33 të ligjit Nr. 80/2015 dhe të dispozitave statutore që delegojnë në këtë akt ( <i>Evidenca 2, neni 67/4</i> ).			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>UT ka hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të funksionimit të tij, procedura dhe kritere të posaçme për rekrutimin e personelit. Përparësi i jepet personelit që zotëron tituj akademikë (<i>Evidenca 2, neni 67; RVB, f. 50; Evidenca 19</i>).</p> <p>Përgjegjës për koordinimin dhe sigurimin e procedurës së rekrutimit të personelit akademik është sektori i Burimeve Njerëzore, i cili pas përfundimit të procedurës së brendshme, shpall njoftimin për vendin e lirë të punës për të interesuarit nëpërmjet shpalljes (në buletin e APP) (<i>Evidenca 2, neni 67; Evidenca 6, neni 25; Evidenca 19</i>) si dhe nëpërmjet njoftimit në faqen elektronike të institucionit: (<a href="https://unitir.edu.al/category/njoftim-per-vend-te-lire-pune/">https://unitir.edu.al/category/njoftim-per-vend-te-lire-pune/</a>), faqe e cila u konsultua dhe nga GVJ.</p> <p>Rregulla të posaçme gjenden në manualin e punësimit dhe për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ (<i>Evidenca 19, seksionet 2, 3 dhe 5</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar në mënyrë të qartë hapat që ndiqen në procesin e rekrutimit të stafit akademik, përmes procedurave transparente. Procesi i rekrutimit fillon nga përcaktimi i nevojave që ka njësia bazë, të cilat më pas i përcillen për miratim rektorit. Kriteret e punësimit i përcillen rektorit nga drejtuesi i njësisë kryesore. Nëpërmjet drejtuesit, njësia kryesore, bën shpalljen në faqet zyrtare të internetit si dhe në buletin e APP. Të interesuarit dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në sektorin e burimeve njerëzore; vlerësimi paraprak i kandidatëve që përmbushin kriteret, kryhet nga komisioni <i>ad hoc</i>, i ngritur për këtë qëllim. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, që nuk duhet të kenë konflikt interesi dhe që i përkasin kategorisë “Profesor”. Komisioni bën shpalljen e fituesit apo fituesve dhe ia paraqet rektorit, i cili përfundon procedurën e nisur (<i>Evidenca 2, neni 67; Evidenca 19, seksioni 1; Evidenca 34; Evidenca shtesë A.17</i>).</p> <p>Në manual është përcaktuar dhe e drejta e ankimit ndaj vendimeve të komisionit <i>ad hoc</i>, ankim që shqyrtohet po prej tij. Kjo e drejtë parashikohet vetëm në manualin për punësimin, por nuk gjen rregullim në statutin e IAL (<i>Evidenca 19</i>). Gjatë vizitës në institucion u konfirmua se nuk ka pasur asnjë rast ankimi gjatë proceseve të rekrutimit të personelit në ISE (<i>Evidenca shtesë “Minuta Msc”</i>).</p> <p>Marrëdhënia formalizohet përmes kontratës së punës (<i>Evidenca 2, neni 67/8</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni është angazhuar në aktet e brendshme të tij për mbështetjen dhe aftësimin e personelit akademik (<i>Evidenca 2, neni 64; Evidenca 3, pika 5</i>).</p> <p>Në mënyrë të detajuar, parimet që lidhen me personelin parashikohen dhe në Kodin e Etikës, të miratuar nga institucioni (<a href="https://unitir.edu.al/kodi-i-etikes-i-universitetit-te-tiranes/">https://unitir.edu.al/kodi-i-etikes-i-universitetit-te-tiranes/</a>).</p> <p>Konstatohet se ky Kod është bazuar në ligjin e shfuqizuar Nr. 9741, datë 21.5.2007, arsye për të cilën institucioni qendror duhet të marrë masat për të miratuar Kodin e ri të Etikës, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi në fushën e arsimit të lartë.</p> <p>GVJ ka konstatuar gjatë vizitës në institucion se godina ku realizohet mësimdhënia teorike për këtë program studimi, ka klasa të pajisura me mjetet e dhura audio-vizive, salla të përshtatshme konferencash, të cilat lehtësojnë punën e personelit akademik.</p> <p>Mjediset në dispozicion të stafit drejtues, për veprimtarinë kërkimore e shkencore, janë të përshtatshëm, ndërsa mjediset për personelin akademik, për personelin administrativ si dhe për sekretarinë mësimore, duhet të rishikohen me qëllim për të krijuar dhe siguruar sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së secilit. Mjediset për stafin përfshijnë 1 zyrë për dekanin/zyrë mbledhjesh, 1 zyrë për sekretarinë mësimore dhe 1 për personelin akademik të departamenteve me sipërfaqe 123 m<sup>2</sup> (<i>Evidenca shtesë A.5, tabela 16</i>). Nga vizita në institucion u konstatua se ambienti për stafin ishte i përbashkët, gjë që vështirëson në praktikë punën e secilit (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>), ndaj <b>GVJ sugjeron krijimin e mundësive që stafi akademik të ketë ambient të ndarë për të punuar nga personeli administrativ.</b></p> <p>Ambientet kanë shërbim interneti <i>wireless</i>, të hapur për përdorim nga studentët dhe personeli akademik e administrativ i institucionit. Në mbështetje të stafit dhe studentëve funksionojnë shërbimi i fotokopjeve, printimit, etj., elemente të cilët u verifikuan gjatë vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni, në vijimësi ka siguruar mundësitë për nxitjen profesionale të personelit, gjë e cila shprehet në akte të tjera formale ku vihet theksi në krijimin e mundësive për të zhvilluar aftësitë e personelit akademik dhe administrativ dhe fuqizimin e kërkimit shkencor (<i>Evidenca 2, nenet 8 dhe 64/3</i>).</p> <p>Konkretisht, institucioni mundëson kërkimin shkencor të personelit nëpërmjet financimit, krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, mobilitetin, etj. (<i>Evidenca 3, pikat 3 dhe 5</i>). Për nxitjen e stafit akademik në këtë drejtim është parashikuar një buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime (<i>Evidenca 2, neni 120; Evidenca 33</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konfirmua ky fakt, ku u pohua nga stafi</p>



	<p>akademik se në respektim të udhëzimeve të MAS si dhe në vijim të vendimarrjes së Bordit të Administrimit, institucioni ka mundësuar në praktikë mbështetjen financiare për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore dhe shkencore, brenda dhe jashtë vendit (<i>Evidenca shtesë "Minuta Msc"; Evidenca 5 "Kërkimi shkencor dhe projektet"</i>).</p> <p>Nga aktet vërehet se UT zbaton programin e miratuar prej tij "UT-kërkim, ekselencë dhe inovacion", i cili ka nisur në vitin 2021, dhe që synon dhënien e informacioneve të nevojshëm për paraqitjen e propozimeve dhe dorëzimin e aplikimeve nga stafi akademik, në funksion të kualifikimit akademik (marrja e gradave dhe titujve), rritjes profesionale si dhe shtimit të veprimtarisë kërkimore (<i>Evidenca 32</i>).</p> <p>Në funksion të kualifikimit në vijimësi të personelit, vlejné dhe marrëveshjet e lidhura nga UT si dhe programet e mobilitetit, si Erasmus+ (<a href="https://unitir.edu.al/kerkimi-shkencor/">https://unitir.edu.al/kerkimi-shkencor/</a>; <a href="https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka-1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/">https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka-1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/</a>). Nga këto marrëveshje dhe programe ka përfituar dhe ISE, si pjesë përbërëse e UT (<i>Evidenca 28; Evidenca shtesë A.2; Evidenca shtesë A.5, tabelat 19 dhe 20; Evidenca 14, pika 3</i>).</p> <p>Vlen gjithashtu të përmendet se UT ka marrë logon "HR Excellence in Research", nga Komisioni Evropian, gjë e cila krijon mundësi të mëtejshme për aplikimin në përfitimin e granteve si dhe mundëson zhvillimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor (<a href="https://unitir.edu.al/universiteti-i-tiranes-mbajtes-i-logos-hr-excellence-in-research/">https://unitir.edu.al/universiteti-i-tiranes-mbajtes-i-logos-hr-excellence-in-research/</a>).</p> <p>Nga aktet vërehet se ISE nxit po ashtu pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të tilla si konferenca, projekte, seminare, etj. (<i>Evidenca 2, neni 114/4; Evidenca 4; Evidenca shtesë A.3, nenet 3, 11</i>).</p> <p>Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19, veprimtaritë e këtij lloji janë zhvilluar edhe nëpërmjet platformave online (<i>Evidenca 14, pika 3.4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet që UT ka marrë masa në vijimësi për të siguruar trajnimin dhe kualifikimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor. Trajnimet dhe programet janë në harmoni me objektivat që ka marrë përsipër institucioni (<i>Evidenca 3, pika 1; Evidenca 4; Evidenca 5 "Stafi akademik dhe rritja e kapaciteteve"</i>) dhe janë realizuar me trajnues vendas dhe të huaj (<i>Evidenca 14, pika 1; Evidenca 28; Evidenca shtesë B.4</i>).</p> <p>UT po zbaton dhe programin "UT-kërkim, ekselencë dhe inovacion", që siguron përkrahje të mëtejshme për arritjen e synimeve përkrahëse në fushën e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies dhe të teknologjive të reja. Objektivat e këtij programi janë: a) Të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë në fushat specifike të kërkimit për gjenerimin e të dhënave shkencore të besueshme dhe konkurruese në treg, të cilat do të shërbejnë si bazë për aplikime të mëtejshme edhe në aplikimet ndërkombëtare; b) Të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë për zhvillimin e projekteve të tyre kërkimore dhe krijimin e kushteve për përparimin në karrierë; c) Të mbështesë Njësinë</p>



	<p>Kryesore dhe Njësinë Bazë për zgjerimin e fushës së tyre të kërkimit dhe inovacionit si dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me strategjinë e kërkimit shkencor të UT-së, dhe nevojave të tregut, si dhe për të përcaktuar realizueshmërinë e projektit me qëllim sigurimin e të dhënave paraprake për të mbështetur aplikimet për financime jashtë universitetit; ç) Të mbështesë me fonde kërkimet strategjike, të cilat përbushin nevojat dhe prioritetet e UT-së (<i>Evidenca 32, pika 2</i>). Në këtë program mund të aplikohet nga stafi akademik, gjë e cila konstatohet nga thirrjet e bëra në faqen online të universitetit (<a href="https://unitir.edu.al/thirrje-per-projekte-ne-programin-ut-kerkim-ekselence-dhe-inovacion-2/">https://unitir.edu.al/thirrje-per-projekte-ne-programin-ut-kerkim-ekselence-dhe-inovacion-2/</a>).</p> <p>Gjithashtu, në funksion të këtij kriteri, paraqitet dhe aktiviteti i Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT, e cila ka kryer disa trajnime online për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ të UT-së (<i>Evidenca shtesë A.12</i>).</p> <p>Marrëveshjet me IAL të huaja në këtë drejtim përfundohen nga ana e UT-së, por duhet theksuar se në këtë drejtim, nga ISE është lidhur një marrëveshje (memorandum mirëkuptimi) me universitetin e Masaryk, Republika Çeke, ku parashikohet fuqizimi dhe shkëmbimi i përvojave edhe në fushën e procesit të mësimdhënies dhe risive në të (<i>Evidenca "Marrëveshjet e bashkëpunimit", f. 15-17</i>).</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Institucioni tregon si në pikëpamje formale, ashtu dhe në atë të zbatueshmërisë, se angazhohet në të gjithë drejtimet për të siguruar përbushjen e plotë të detyrave nga burimet njerëzore që disponon, me qëllim arritjen e objektivave në kuadër të programit të integruar të studimeve. Detyrat e secilit anëtar, sipas stafëve përkatës, janë të mirëpërcaktuar në aktet e brendshme të ISE, në përputhje me misionin dhe objektivat që ky i fundit synon të realizojë (<i>Evidenca shtesë A.6; Evidenca shtesë A.3</i>).</p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="579 1267 730 1323">Niveli i përbushjes</th> <th data-bbox="730 1267 954 1323">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="954 1267 1169 1323">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1169 1267 1378 1323">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="579 1323 730 1375"></td> <td data-bbox="730 1323 954 1375"></td> <td data-bbox="954 1323 1169 1375" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1169 1323 1378 1375"></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>ISE disponon infrastrukturën e përshtatshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse të tij (<i>Evidenca 23; Evidenca shtesë A.5, tabela 16</i>).</p> <p>Mësimdhënia për programet e studimit të ofruar nga Departamenti "Legjislacion dhe Institucione Evropiane" realizohet në të njëjtën godinë ku ndodhet dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i UT-së, me ambientet e saj, në katin e parë të godinës. Vlerësimi është kryer në ambientet në fjalë, ku u zhvillua vizita nga GVJ si dhe ku</p>



	<p>zhvillohet programi i studimeve, objekt vlerësimi. Gjithashtu, nga aktet dhe vizita në institucion, rezultojnë që ISE shfrytëzon në funksion të përmbushjes së veprimtarisë akademike e mësimore dhe ambiente të godinës "Liria", konkretisht 4 salla të saj, me kapacitet 120 vende.</p> <p>GVJ konstatoi një sipërfaqe të mjaftueshme në funksion të sallave për leksione, etj., në raport me numrin e studentëve, dhe relativisht të mjaftueshëm për zyra, sa i përket stafit të ISE (<i>Evidenca shtesë A.5, tabela 16</i>).</p> <p>Sipas këtyre të dhënave, universiteti vë në dispozicion 120 m<sup>2</sup> si salla leksioni për studentët. Biblioteka/salla e internetit ka sipërfaqe 82.5 m<sup>2</sup>.</p> <p>Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesoret e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. Ambientet janë të pajisura me dritare dhe me një sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Institucioni ka në përdorim të njëjtën sipërfaqe parkimi, që ka dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.</p> <p>Institucioni siguron sipërfaqe çlodhëse për studentët dhe mjedise hidrosanitare që gjenden në godinën e përbashkët.</p> <p>Nga vizita në institucion u konstatua se institucioni siguron aksesueshmëri, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara, edhe pse aktualisht nuk kishte të regjistruar të tillë rishtas apo në vazhdim të studimeve (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion u vërejt se ISE zotëron ambientet e duhura për realizimin e programit mësimor të studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave, ku klasat dhe sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Pajisjet në fjalë, video projektorë, TV, projektorë, kompjutera, pajisje të tjera teknologjike, lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies (<i>Evidenca 23; Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Në godinë funksionon normalisht shërbimi i internetit wireless, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit, gjë që u konstatua dhe nga GVJ.</p> <p>Rezultojnë që institucioni ka siguruar e vënë në shfrytëzim pajisjet e duhura e të nevojshme, në funksion të programit të studimeve Master Shkencor në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 8/7 të Statutit të tij si dhe në nenin 8 të Rregullores së ISE (<i>Evidenca 2; Evidenca shtesë A.6</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në godinë përfshihen laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj. Ambientet e zhvillimit të leksioneve e seminareve janë me hapësira të mjaftueshme dhe mundësojnë qëndrimin lirshëm të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektorë, etj., dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të</p>



	mësimdhënies. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme ( <i>Evidenca 23</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në përputhje me programin e studimit, IAL nuk ka parashikuar laboratorë informatike, por ka siguruar ambientin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve kompjuterike në sallën e bibliotekës ( <i>Evidenca 23; Evidenca shtesë A.5, tabela 16</i> ). Në këtë sallë, studentët kanë mundësinë që të kryejnë detyra e punime të ndryshme, duke shfrytëzuar programe profesionale, që lehtësojnë punën e tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Praktikat profesionale dhe disa veprimtari të tjera praktike realizohen në ambientet e vetë institucionit, të cilët u përshkruan më lart, por dhe pranë subjekteve, me të cilët IAL ka lidhur marrëveshje ( <i>Evidenca "Marrëveshjet e bashkëpunimit"; Evidenca 23; Evidenca 14, pikat 1 dhe 2</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën, e cila organizohet dhe funksionon në secilën njësi kryesore. Qëllimi i saj është që të mbështesë me literaturë mësimore dhe shkencore, aktivitetin e personelit akademik, studentëve, profesionistëve si dhe kërkuesve shkencorë në përgjithësi ( <i>Evidenca 2, neni 122</i> ). Për të përmbushur këtë qëllim, ISE ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, me qëllim shfrytëzimin e bibliotekës së këtij të fundit ( <i>Evidenca 29</i> ). Si në pikëpamje të akteve të brendshme të institucionit, ashtu dhe në atë objektive, rezulton që biblioteka të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte vendosur në katin përdhe' të godinës, me ambient të mjaftueshëm, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi ( <i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë zotëron një bibliotekë me larmi botimesh, ndër të cilët përfshihen dhe ato në fushën e së drejtës, në gjuhën shqipe, angleze, etj. ( <i>Evidenca "Lista e librave (biblioteka)"; Evidenca shtesë A.9</i> ). Sipas RVB, f. 56,



<p>e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>biblioteka e institucionit siguron një gamë të gjerë titujsh, të për zgjedhur në përputhje me programet e studimit të ofruar nga ky universitet.</p> <p>UT boton disa revista shkencore, ku ndër të tjera botohen dhe artikuj e punime në fushën e së drejtës. Këto punime mund të aksesohen online: <a href="https://unitir.edu.al/botime-dhe-revista-shkencore/">https://unitir.edu.al/botime-dhe-revista-shkencore/</a>.</p> <p>Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe angleze, garanton përmbushjen e objektivave të programit për studentët (<i>Evidenca "Lista e librave (biblioteka)"; Evidenca 23</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e kryer në institucion dhe sipas të dhënave të vëna në dispozicion, institucioni ka siguruar akses pa pagesë për studentët në bibliotekat online "Jstore", U-Library dhe COBISS+, në të cilën studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh, në përputhje me programin e studimit (<i>Evidenca shitesë A.5, tabela 17</i>). Sipas të dhënave, biblioteka "Jstore" ofron mbi 12 milion artikuj të revistave akademike, 85 000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina. Në lidhje me këtë program studimi dhe për fushën e studimeve të ISE, kjo bibliotekë siguron rreth 701 600 revista akademike, 7 745 e-books, 8 169 libra, 25 000 raporte dhe studime kërkimore, etj., të botuara 21 vitet e fundit (<i>Evidenca 23, f. 2</i>).</p> <p>Akcesi në bibliotekën online sigurohet në bazë të abonimit, është pa pagesë për përfituesit e saj si dhe mund të arrihet nëpërmjet shërbimit <i>wifi</i> të internetit, në të gjithë ambientet e ISE, nëpërmjet faqes zyrtare online të UT: <a href="https://unitir.edu.al/sherbimet-online/">https://unitir.edu.al/sherbimet-online/</a>.</p> <p>Biblioteka digjitale COBISS+ ka të bëjë me një sistem kombëtar të informacionit të bibliotekave me katalogim të përbashkët, ku mund të gjenden materiale që janë kataloguar në bibliotekat shqiptare. Gjatë vizitës në institucion u verifikua që puna për vënien në funksionim të kësaj biblioteke është në vijim të procesit (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekën online dhe bazat e tjera të të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, në përputhje me sa deklaruar nga institucioni në RVB (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi që biblioteka e institucionit është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Njëra prej hapësirave të saj përmban zonën e kompjuterave dhe aksesorët e tjerë të nevojshëm.</p> <p>Për të përfituar nga fondi i bibliotekës, studentëve iu hapet kartela përkatëse, ku paraqesin vërtetimin e studentit,</p>



	<p>letërnjoftim dhe fotografi (<i>Evidenca 30, neni 7</i>).</p> <p>Sipas RVB, f. 57, dhe nga vizita e kryer, konstatohet që databaza e bibliotekës gjendet dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit (<a href="https://unitir.edu.al/biblioteka-online/">https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</a>).</p> <p>Sistemi i përdorur në funksion të shfrytëzimit shërben për regjistrimin e materialeve, sistemin e klasifikimit të bibliotekës si dhe për procedurat e katalogimit të koleksionit kryesor (<i>Evidenca 29, neni 3</i>).</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas nenit 122/3-5 të statutit të UT-së, pasurimi i bibliotekës së njësisë kryesore bëhet çdo vit, bazuar në kërkesat e personelit akademik, propozimit të përgjegjësit të bibliotekës së njësisë dhe të miratuara nga dekanati i njësisë kryesore. Çdo vit financiar, Bordi i Administrimit duhet të miratojë një fond të veçantë dedikuar blerjes së literaturës shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj (<i>Evidenca 2</i>). Si mënyra pasurimi të fondit të bibliotekës njihen blerja, shkëmbimi dhe dhurimet (<i>Evidenca 30, neni 12, germa b</i>).</p> <p>Nga aktet rezulton se institucioni ka miratuar “Rregulloren e bibliotekës së FHF”. Pas shqyrtimit të tij, <i>GVJ sugjeron që në përmbajtje të Rregullores së bibliotekës së FHF të përfshihet dhe procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj</i>.</p> <p>Përcaktimi i saktë i procedurës do të vinte në harmoni me parashikimet e nenit 122 të statutit të UT-së (<i>Evidenca 2</i>).</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e punës së bibliotekës në ISE janë të disponueshme për studentët nga dita e Hënë deri ditën e Premte në orarin 08.00 – 16.00. Oraret e ofrimit të këtij shërbimi vijnë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>Orari është i shpallur në hyrje të bibliotekës. <i>GVJ sugjeron që të jetë i publikuar dhe në faqen online të ISE</i>.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sipas përcaktimeve të bërë në aktet e brendshme të UT, në institucion funksionojnë njësitë ndihmëse si zyra e sekretarisë mësimore, e cila disponon dhe administron informacionin që lidhet me studentët. Nëpërmjet strukturave të tij, si të natyrës akademike, ashtu dhe administrative, universiteti siguron mbështetje të vazhdueshme ndaj studentëve në të gjithë aspektet. Për këtë qëllim janë ngritur strukturat përkatëse, të përshkruara në statut, që bëjnë të mundur shkëmbimin e</p>



	<p>të dhënave mes njërive drejtuese, akademike dhe njërive të tjera ndihmëse apo të shërbimit (<i>Evidenca 2, neni 11/1; Evidenca shtesë A.6, neni 20</i>). GVJ ka rekomanduar më lart hartimin dhe miratimin e rregullores së përgjithshme të institucionit që të parashikojë strukturat, rolin dhe rregullimet sa u përket studentëve, procesit të mësimdhënies, etj., në përputhje me parashikimet e nenit 33 të ligjit Nr. 80/2015.</p> <p>Informacioni për studentët administrohet në sistemin e të dhënave të sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave (<i>Evidenca 8</i>). Në sekretari janë arkivuar dosjet e secilit student të regjistruar, të çregjistruar apo që ka përfunduar studimet, gjë që u verifikua gjatë vizitës në këtë zyrë nga GVJ (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Institucioni disponon gjithashtu të dhëna për studentët nga momenti i regjistrimit deri në dalje nga ky program studimi (<i>Evidenca shtesë A.5, tabela 21; Evidenca 14, pika 6</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të, janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme të UT.</p> <p>Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ (<i>Evidenca "CV e stafit të angazhuar në vite"; Evidenca 13 "CV të stafit ISE"</i>).</p> <p>Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore në nivel institucional, e cila ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese (<i>Evidenca 10; Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Departamenti "Legjislacion dhe Institucione Evropiane" administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra (<i>Evidenca 14; Evidencat shtesë A.2; A.1.5; A.1.4; A.1.3; A.1.2; A1</i>).</p> <p>Po ashtu, departamenti në fjalë dhe institucioni, zotërojnë të dhëna mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit (<i>Evidenca 14; Evidenca shtesë B.5</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezulton që strukturat përgjegjëse për programin e studimit objekt vlerësimi, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët.</p> <p>Në funksion të këtij kriteri, shkëmbimi i të dhënave kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit që siguron llogari personale (postë elektronike) për anëtarët e personelit dhe secilin student, në faqen zyrtare elektronike të UT-së (<i>Evidenca 2, neni 86</i>). Secili prej këtyre</p>



	<p>personave ka në dispozicion llogarinë e tij elektronike, me akses të personalizuar, ku mund të regjistrohet në kurset që do të frekuentojë si dhe të njihet me vlerësimet në fushën akademike. Nëpërmjet këtij sistemi mund të aksesojë dhe dokumente të ndryshme që lidhen me aktivitetin studentor e mësimit (<i>Evidenca 8</i>).</p> <p>Të dhëna të hollësishme mbi programin e studimit jepen në rregulloren përkatëse (<i>Evidenca 7</i>). Gjatë vizitës në institucion rezultoi se të dhënat mbi programin e studimit iu jepen studentëve në ditën e prezantimit dhe orientimit të tyre (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>). Të dhënat mbi kalendarin akademik dhe aktet përkatëse, aksesohen dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL: <a href="https://ise.edu.al/">https://ise.edu.al/</a>. Sa i përket syllabus-it të secilës lëndë, ky iu jepet studentëve në orën e parë të kursit, gjithashtu iu dërgohet studentëve në adresën elektronike (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>);</p> <p>Sa i përket kritereve të pranimit të studentëve, universiteti i përcakton në bazë vjetore sipas vendimarrjes së strukturave përkatëse (<i>Evidenca shitesë A.6, neni 39; Evidenca 7, neni 17</i>). Kriteret publikohen në faqen zyrtare të universitetit: <a href="https://ise.edu.al/wp-content/uploads/kritere-te-pranimit-2023-2024.pdf">https://ise.edu.al/wp-content/uploads/kritere-te-pranimit-2023-2024.pdf</a>.</p> <p>Shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve ka funksionuar më së miri edhe gjatë periudhës së pandemisë, të shkaktuar nga Covid-19, nëpërmjet platformës së përdorur për këtë qëllim, <i>Microsoft Teams</i> (<i>Evidenca 24; Evidenca 26; Evidenca 27</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas RVB (f. 59), institucioni ka krijuar mundësinë e komunikimit midis stafit akademik dhe studentëve përgjatë gjithë vitit akademik. Në radhë të parë, e gjithë godina ka akses në internet në tërësinë e ambienteve të tij. Studentët mund të njihen me vlerësimet e marra (notat) në sistemin e postës elektronike, sipas mënyrës së aksesit të mundësuar nga vetë institucioni. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet komunikimi dhe me struktura administrative të institucionit (<i>Evidenca 2, neni 86</i>). Komunikimi është verbal, por dhe me anë të postës elektronike, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion në takimet me personelin dhe studentët (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Gjithashtu, mundësohet komunikimi nëpërmjet platformës <i>Microsoft Teams</i>: <a href="https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams/">https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams/</a>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Rregullimi i brendshëm i veprimtarisë së UT-së, përfshi ISE, nëpërmjet statutit dhe rregulloreve, është bërë në mënyrë të tillë që strukturat drejtuese dhe titullarët të marrin dijeni për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ (<i>Evidenca 2; Evidenca 6; Evidenca shitesë A.6</i>).</p> <p>Vlen të theksohet në këtë drejtim edhe përpilimi i raportit vjetor të institucionit, nëpërmjet të cilit përshkruhen veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme studentore, akademike dhe administrative të tij. Raporti në fjalë përgatitet nga të gjitha strukturat akademike, administrative dhe të menaxhimit, nën drejtimin e rektoratit. Ky i fundit, është përgjegjës për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve dhe për përgatitjen e raportit vjetor, i cili i paraqitet në vijim për miratim Senatit dhe Bordit të Administrimit (<i>Evidenca 2,</i></p>



	<i>neni 31/1, germa k, në lidhje me nenin 55/1, germa l).</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	ISE mundëson dhënien e informacionit në faqen zyrtare <i>online</i> të veprimtarisë së tij, <a href="https://ise.edu.al/">https://ise.edu.al/</a> , si në lidhje me objektivat, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Informacioni mundësohet në gjuhën shqipe dhe pjesërisht në gjuhën angleze. Gjatë aksesimit të kësaj faqeje, GVJ ka konstatuar se disa prej rubrikave janë të paaksesueshme ose nuk ofrojnë informacion të plotë, gjë e cila u referua dhe gjatë takimit në institucion prej përfaqësuesve të tij në takimet përkatës. <i>Nga përfaqësuesit e institucionit u referua se në fakt është duke u punuar për përmirësimin dhe përditësimin e informacioneve, duke vënë në dispozicion dhe një urdhër të brendshëm për këtë qëllim (Evidenca shtesë A.16; Evidenca shtesë "Minutat Msc").</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, ISE është njësi përbërëse e UT, i cili është i organizuar në formën e një personi juridik publik, i njohur si i tillë me ligj ( <i>Evidenca 2, nenet 3 dhe 11</i> ). Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare. UT gëzon autonomi financiare dhe në bazë të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, harton planin buxhetor afatmesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili përditësohet çdo vit ( <i>Evidenca 2, neni 143</i> ). Nga të dhënat, ( <i>RVB, f. 62</i> ), procesi i hartimit të programit financiar nis në periudhën Mars-Maj dhe miratohet në vijim nga organet kompetente. Nga buxheti institucional, ISE-së i akordohet buxheti përkatës, pasur parasysh nevojat përkatëse, bazuar në buxhetin afatmesëm të tij 3-veçar. Për këtë qëllim, ISE harton çdo vit akademik plan-buxhetin e vet në përputhje me objektivat e programeve të studimit që ofron. Sipas <i>RVB-së, f. 61</i> , financimi dhe të ardhurat për ISE-në, janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të UT-së. Në përputhje me nenin 147 të statutit, UT i paraqet çdo vit akademik ministrisë përgjegjëse për arsimin raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifën e shkollimit për vitin në vijim, etj. ( <i>Evidenca 2</i> ). Burim i të ardhurave sipas statutit janë të ardhurat nga: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsimim, të ardhurat për shërbimet e kryera, të



	<p>ardhurat nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi, veprimtari kërkimore-shkencore, projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare (<i>Evidenca 2, neni 144</i>). Konkretisht për ISE-në, burime financime janë parashikuar: të ardhurat e veta dhe nga fondet buxhetore. Te të ardhurat e veta parashikohen tarifa e shkollimit e paguar nga studentët, tarifa e regjistrimit për konkurrim dhe të ardhura të tjera të ligjshme (<i>Evidenca shitesë A.6, neni 47</i>).</p> <p>Referuar të dhënave të sjella nga institucioni, të ardhurat faktike janë siguruar vetëm nga tarifat e shkollimit (<i>Evidenca shitesë A.5, tabela 18</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, RVB dhe aktet shoqëruese, rezulton se në buxhetin afat-mesëm dhe atë të vitit fiskal të UT-së, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve të përfituar nga buxheti i shtetit, të cilët ndahen në tre kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Shpenzime për politikën e zhvillimit;</li> <li>2) Shpenzime për mësimdhënie dhe,</li> <li>3) Shpenzime për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtari krijuese (<i>Evidenca 2, neni 145</i>).</li> </ol> <p>Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. Buxheti përmban miratimin e detajimit të kuotave të buxhetit të konsoliduar (grant mësimdhënie, të ardhura), miratimin e detajimit të shpenzimeve operative, miratimin e detajimit të investimeve, miratimin e numrit të planifikuar të punonjësve. Këto zëra përfshijnë mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e saj, aksesin në bibliotekat online, përmirësimin e infrastrukturës së mjediseve, auditoret e leksioneve, sallat e seminareve dhe laboratorëve, rimbursim publikimesh, etj., që vlejné dhe për këtë program studimi (<i>F. 61 e RVB</i>).</p> <p>Tarifat e shkollimit në ISE përdoren për të mbuluar shpenzimet për shërbime operative, për investime, për shpërblime të personelit akademik, të personelit administrativ të institutit dhe për të mbuluar veprimtaritë e institutit (veprimtaria kërkimore, mësimore, veprimtari të natyrës shkencore dhe botimet) (<i>Evidenca shitesë A.6, neni 49/5</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, veprimtaria e UT-së i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar.</p> <p>Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm e UT, e cila ka varësi organizative dhe funksionale nga Bordi i Administrimit, të cilit i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë, sipas legjislacionit në fuqi në këtë fushë (<i>Evidenca 2, neni 57</i>).</p> <p>Në RVB (<i>f. 62</i>) është pasqyruar se raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Raportet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm analizojné eficientë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe nga burime të tjera, përdorimin e tyre për të bërë të mundur rritjen e cilësisë së studimeve për të gjitha ciklet. Raportet financiare përmbajnë tabelat për të ardhurat dhe ndarjen</p>



	e burimeve financiare të detajuara, ku institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit. Financimi dhe të ardhurat për ISE-në janë pjesë e të dhënave financiare të UT-së ( <i>Evidenca "Raporti financiar vjetor dhe Plani i financimit të programit të studimit"</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Nga aktet rezulton se raportet financiare janë të administruara për tri vitet e fundit akademike ( <i>Evidenca "Raporti financiar vjetor dhe Plani i financimit të programit të studimit"</i> ). Procedurat përkatëse sipas RVB (f. 62) nisin në periudhën Mars-Maj, mandej rektorati përgatit raportin financiar, bazuar në planifikimet e kryera në programin financiar. Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi i Administrimit dhe në përfundim të këtij procesi bëhet dhe analiza që planifikon ndërhyrjet e duhura në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit ( <i>Evidenca 2, neni 55, gërmat ll-n</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Pasur parasysh dokumentacionin e konsultuar, vlerësohet se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit objekt vlerësimi. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga ISE. Financimi nga buxheti i shtetit siguron qëndrueshmëri financiare dhe siguri për zhvillimin e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UT ka hartuar dhe miratuar procedurat e nevojshme për regjistrimin e studentëve, periudhën e studimeve dhe diplomimin e tyre, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion e përkatësisht akteve të brendshëm (<i>Evidenca 2, krerët VII dhe IX; Evidenca shtesë A.6, krerët IV- VIII; Evidenca 6, pjesa 3; Evidenca 7, nenet 16-25</i>).</p> <p>Aktet e brendshëm janë hartuar në respektim të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij (<i>me përjashtim të Rregullores së përgjithshme dhe Rregullores së ISE-së, të cilat bazohen në ligjin e shfuqizuar për arsimin e lartë</i>). Mbi bazën e akteve themelore të organizimit të brendshëm, institucioni ka ngritur disa zyra dhe zbaton procedura që mbulojnë momentin e regjistrimit, pranimit, transferimit, lënies së studimeve, këshillimit gjatë periudhës së studimeve, diplomimin e studentëve (<i>Evidenca 9; Evidenca 20; Evidenca "Karriera dhe studentët"; Evidenca shtesë A.11</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhdimit të studimeve, të përcaktuara qartë dhe të bëra publike, garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student (<i>Evidenca 2, neni 6; Evidenca shtesë A.6, neni 43; Evidenca 7, neni 3</i>). Këto parime përmenden dhe në strategjinë e zhvillimit të UT-së si dhe në planin e zhvillimit të ISE-së, në drejtim të ofrimit dhe dhënies së mundësive të barabarta për të gjithë studentët apo kandidatët për të qenë të tillë (<i>Evidenca 3, pika 1; Evidenca 5, f. 7-8</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat mbi pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015.</p> <p>Procedura të hollësishme janë parashikuar në rregulloren themelore, rregulloren e ISE-së dhe në atë të programit të studimit, ku është përqendruar dhe GVB, përderisa është rregullorja e vetme e nxjerrë në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015 (<i>Evidenca 6; Evidenca shtesë A.6; Evidenca 7</i>).</p> <p>Kriteret e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare elektronike të institucionit dhe të njësisë (<a href="https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/">https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/</a>; <a href="https://ise.edu.al/wp-content/uploads/kritere-te-pranimit-2023-2024.pdf">https://ise.edu.al/wp-content/uploads/kritere-te-pranimit-2023-2024.pdf</a>), të aksesueshme nga cilido i interesuar (<i>Evidenca "Vizibiliteti dhe marketingu"</i>).</p> <p>Sa u përket procedurave të tjera gjatë vazhdimit të studimeve, përfshi transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, institucioni ka krijuar mekanizmat përkatës, rregullore dhe zyrtat zbatuese të tyre. Informacione të hollësishme studentëve iu sigurohen në faqen online të</p>



UT-së si dhe të ISE-së. Informacioni është lehtësisht i kuptueshëm dhe përfshin të dhënat e nevojshme. ***GVJ sugjeron që ISE të hartojë dhe miratojë një guidë ose udhëzues për studentët, në mënyrë që të gjejnë të përmbledhur në to të gjithë rregullat, procedurat dhe strukturat që ofrojnë këto shërbime.***

Pranimi i studentëve që ndjekin programin e ciklit të dytë të studimeve në ISE është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i UT dhe Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë (*Evidenca 2; Evidenca 7*).

Pasur parasysh dhe rregullimet e VKM Nr. 259, datë 10.05.2019, të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë personat që zotërojnë diplomë të ciklit të parë, si në fakultetin në të cilin është kryer programi i ciklit të parë ose në një fakultet tjetër, në përputhje me kriteret e programit mësimor përkatës; diplomë studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të; individët që kanë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë, në përputhje me kriteret e shpallur; kandidatët që plotësojnë standardet e caktuar akademikë të kritereve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve. Gjithashtu, ndër kriteret e pranimit është dëshmia e njohjes së një prej 5 gjuhëve të huaja: angleze, frënge, gjermane, italiane dhe spanjolle, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Kandidati duhet të pranojë pagesën e tarifës së caktuar mujore ose vjetore (*Evidenca 2, neni 94; Evidenca 7, neni 17*).

Neni 40 i Rregullores së ISE-së përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur, dispozitë e cila nuk është në harmoni me kërkesat e nenit 94 të statutit të UT-së (*Evidenca shtesë A.6*). ***GVJ sugjeron parashikimin e procedurave të detajuara lidhur me regjistrimin e studentëve në rregulloren e programit të ciklit të dytë Msc "Legjislacion dhe institucionet evropiane" dhe në draft-rregulloren e Departamentit të Legjislacionit dhe Politikave të BE-së.***

Referuar kritereve dhe dokumentacionit të pranimit, të publikuar në faqen zyrtare elektronike të UT-së, dokumentacioni që duhet dorëzuar për aplikim është: diploma ose fotokopje e saj e njehsuar me origjinalin e ciklit të parë të studimeve të përfunduara brenda ose jashtë vendit; diploma e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje e tyre e njehsuar me origjinalin, konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para hyrjes në fuqi të vendimit për krijimin e maturës shtetërore, paraqesin dëftesën e pjekurisë, origjinalin ose fotokopjen e saj, të njehsuar me origjinalin dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore; dëshmi e gjuhës së huaj sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të MASR-së; formulari i aplikimit, i cili do të merret në sekretarinë e ISE-së; fotokopje e dokumentit të identifikimit; dy fotografi personale; *Curriculum Vitae*; deklaratë për verifikimin e dokumentacionit shkollor me të cilën do të njihen nga sekretaria e ISE-së (<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/04/Kriteret-e-pranimit-p%C3%ABr-vitin-akademik-2022-2023-Cikli-i-II->



	t%C3%AB.pdf). Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukurore dhe kriteret e pranimit të vendosura nga njësitë bazë e njësitë kryesore (Evidenca 2, neni 94; Evidenca shitesë A.6, neni 38; Evidenca 7, neni 17).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Neni 94 i Statutit dhe neni 39 i Rregullores së ISE-së nuk parashikojnë kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët shpallen dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (Evidenca 2; Evidenca shitesë A.6). Kriteret për këtë program studimi rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/04/Kriteret-e-pranimit-p%C3%ABr-vitin-akademik-2022-2023-Cikli-i-II-t%C3%AB.pdf">https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/04/Kriteret-e-pranimit-p%C3%ABr-vitin-akademik-2022-2023-Cikli-i-II-t%C3%AB.pdf</a> .			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, ISE realizon udhëzimin e të interesuarve lidhur me kriteret e përgjithshëm dhe të veçantë të këtij programi studimi, përpara fillimit të çdo viti akademik nëpërmjet strukturave të brendshme të tij (sekretarisë mësimore) (Evidenca shitesë "Minutat Msc") dhe publikimeve në faqen zyrtare të UT-së dhe ISE-së si dhe nëpërmjet faqes elektronike zyrtare: <a href="https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/">https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/</a> ; <a href="https://ise.edu.al/wp-content/uploads/kriteret-te-pranimit-2023-2024.pdf">https://ise.edu.al/wp-content/uploads/kriteret-te-pranimit-2023-2024.pdf</a> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, mund të konfirmohet se studentët marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit. Informacioni për këtë program studimi gjendet i qartë dhe në faqen <i>online</i> të universitetit: <a href="https://ise.edu.al/">https://ise.edu.al/</a>.</p> <p>ISE organizon që në javën e parë të vitit akademik një javë orientuese, ku marrin pjesë studentët, personeli akademik dhe ndihmës-akademik, me qëllim informimin e studentëve mbi objektivat e programit të studimit, arritjet në fund të tij dhe kriteret për kalimin në vitin pasardhës akademik (Evidenca shitesë "Minutat Msc"). Informacioni iu jepet nga departamenti dhe sekretaria mësimore me fokus kryesor kalendarin e vitit akademik, kurrikulën mësimore, orarin e semestrit të parë, stafin akademik të angazhuar në këtë semestër. Takimet vijnë dhe gjatë semestrit pasardhës (Evidenca 8; RVB, f. 65).</p> <p>Të dhëna mbi lëndën dhe syllabus-in e saj, mënyrën e kontrollit të</p>



	<p>njohurive dhe detyrimet, studentët i marrin në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga pedagogu përkatës (<i>Evidenca "Syllabuse 2021-2022"</i>)</p> <p>Vlerësimet për secilën lëndë hidhen në sistemin e informacionit të studentëve dhe administrohen nga zyra e sekretarisë. Stafi akademik plotëson dhe nënshkruan fletën e rezultateve të provimit për secilën lëndë. Fletët e rezultatit administrohen dhe arkivohen nga zyra e sekretarisë (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Vlerësimet e lëndëve të programit iu bëhen të ditur studentëve nga sekretaria mësimore nëpërmjet adresave elektronike ose drejtpërdrejt (<i>Evidenca 8</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>UT njeh mundësinë e transferimit të studentëve të cilët kanë përfunduar të paktën një vit studimor në programe të të njëjtit cikël, prej institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. ISE si njësi kryesore e UT-së, sipas kuotave të pranuar, ofron mundësi për transferime të studentëve, të cilët kanë përfunduar të paktën një vit studimor në programe të ngjashme (shkenca humane), prej institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit (<i>Evidenca 2, neni 109; Evidenca 7, neni 19/2</i>).</p> <p>Procedura e përcaktuar në këto akte është e qartë, në drejtim të njohjes së studimeve të kryer më parë nga studenti. Me qëllim njohjen e këtyre studimeve të mëparshme, drejtori i ISE-së ngre një komision të posaçëm, sipas rregullave të caktuara nga UT në aktet e tij të brendshëm. Vendimin përfundimtar për kërkesën për transferim e merr drejtori i ISE-së (<i>Evidenca 7, neni 19/3</i>).</p> <p>Informacioni mund të merret në faqen zyrtare të ISE-së: <a href="https://ise.edu.al/studenti/">https://ise.edu.al/studenti/</a>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka një strukturë të informimit dhe këshillimit për studentët (sektori i marrëdhënieve me studentët në nivel rektorati), me të cilën bashkëpunon ISE, e cila mundëson informimin në mënyrë të detajuar mbi programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit, kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve të tyre (<i>Evidenca shtesë A.11</i>).</p> <p>Njësia bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi, jep informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin dhe ndjekjen e programit, syllabus-et, praktikat, ushtrimet, laboratorët, etj. (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Ky informacion iu sigurohet në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga departamenti si dhe pedagogu përkatës (<i>Evidenca "Syllabuse 2021-2022"</i>).</p> <p>Të dhënat mund të aksesohen po ashtu dhe në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://unitir.edu.al/studentet/">https://unitir.edu.al/studentet/</a> dhe <a href="https://ise.edu.al/">https://ise.edu.al/</a>.</p> <p>Në sistemin elektronik studentët gjejnë vlerësimet për secilën lëndë (<i>Evidenca 2, neni 86; Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Orientimi i studentëve lidhur me diplomimin kryhet nga departamenti, i cili iu siguron informacionin e duhur. Atyre iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të vitit akademik rreth procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p>



	<p>Studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Legjislacion dhe institucionet evropiane” përfundojnë me punimin e diplomës, pasi studenti të ketë shlyer gjithë detyrimet akademike që përmban plani mësimor. Teza e diplomës është punë krijuese e studentit në formën e një studimi me karakter teoriko-praktik dhe analitik e që lidhet drejtpërdrejt me formimin e marrë gjatë zhvillimit të programit të studimit. Tema realizohet nën mentorimin e një pedagogu të miratuar nga departamenti i programit të studimit (<i>Evidenca 7, neni 25</i>).</p> <p>Në funksion të plotësisht të këtij kriteri, institucioni ka parashikuar procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj (<i>Evidenca 9</i>).</p> <p>Studenti asistohet nga një udhëheqës gjatë punimit të temës dhe gjithë ecuria e punës shënohet në një formular që mbahet për këtë qëllim (<i>Evidenca 9, pika 2.3</i>).</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të plotësisht të këtij kriteri, institucioni u siguron të interesuarve dhe studentëve informacionin e nevojshëm për këtë program studimi, nëpërmjet takime të ndryshme që realizohen për këtë qëllim (<i>RVB, f. 66</i>).</p> <p>Të dhënat përkatëse për programin e studimit janë të publikuara dhe <i>online</i>: <a href="https://ise.edu.al/">https://ise.edu.al/</a>, në faqen zyrtare të njesisë.</p> <p>Gjithashtu, institucioni, nëpërmjet sektorit të marrëdhënieve me studentët, organizon takime për të informuar të interesuarit dhe studentët mbi programin e studimit (<i>Evidenca A.11</i>).</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët marrin informacione të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve që do të ndjekin, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai administrativ i universitetit. Vlen të përmendet në lidhje me këtë kriter, orientimi që marrin studentët në fillim të çdo viti akademik mbi programin e studimit (<i>Evidenca shtesë “Minutat Msc”; RVB, f. 65</i>).</p> <p>Sektori i marrëdhënieve me studentët në rektoratin e UT-së është një ndër strukturat që sigurojnë informacionin e vazhdueshëm të nevojshëm sa i përket çështjeve që lidhen me infrastrukturën, organizimin e studimeve dhe orientimin pas studimeve (<i>Evidenca shtesë A.11</i>).</p> <p>Rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luajnë dhe të dhënat e</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>publikuara në faqen zyrtare elektronike të universitetit dhe ISE-së.</p> <p>Departamenti “Legjislacion dhe institucionet evropiane” dhe pedagogët e secilës lëndë, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat administrative të ISE-së, sigurojnë dhënien e informacioneve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabus-et e detajuar, praktikat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit (<i>Evidenca “Syllabuset e lëndëve”</i>). Informimi mundësohet si në fillim (kryesisht), por dhe në vijim të vitit akademik. Ky është një detyrim që buron nga aktet e brendshme rregulluese të IAL (<i>Evidenca 7</i>).</p> <p>Informimi mundësohet në periudha të ndryshme të vitit akademik (<i>RVB, f. 67</i>).</p> <p>Mandej, informacionet për planprogramet e kursit gjenden dhe të shpallura <i>online</i> në faqen: <a href="https://ise.edu.al/">https://ise.edu.al/</a>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në nenin 4/3 të Rregullores së programit të ciklit të dytë përcaktohet se programi synon që të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike në fushën e legjislacionit dhe institucioneve evropiane, të jenë të aftë të punojnë në grup si dhe të jenë të aftë të përballen me tregun e punës (<i>Evidenca 7, neni 4/3</i>).</p> <p>Në statutin e UT-së përcaktohet se pranë rektoratit funksionojnë disa struktura ndihmëse me karakter akademik, të cilat janë të përbëra nga personel ndihmës-akademik me karakter administrativ konkretisht: 1) struktura e programeve mësimore dhe e sigurimit të cilësisë; 2) struktura e marrëdhënieve me jashtë dhe studentët; 3) struktura e kërkimit shkencor dhe IT-së; 4) struktura juridike dhe e marrëdhënieve me publikun; 5) struktura e burimeve njerëzore dhe e protokoll-arkivit, të cilat organizohen dhe funksionojnë sipas përcaktimeve të bërë në rregulloren e rektoratit (<i>Evidenca 2, neni 44; Evidenca shitesë A.19</i>).</p> <p>Në përputhje me këta rregullime dhe aktet e tjerë të brendshëm, pranë rektoratit të UT është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Orientimit Studentor, nëpërmjet së cilës këtyre të fundit iu ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. ISE bashkëpunon me të për të arritur objektivat në drejtim të planifikimit të karrierës dhe këshillimit për studentët e regjistruar (<i>Evidenca shitesë A.11</i>). Nga dokumentacioni vërehet se të interesuarit marrin informacione mbi programet e studimit që ofron ISE, për të zgjedhur programin e duhur në përputhje me objektivat personale, regjistrimin në program si dhe informacione të detajuara mbi trajnimet, aktivitetet e ndryshme, <i>internship</i>-et, praktikat profesionale dhe mundësi punësimi për studentët si dhe informacione të tjerë me rëndësi për procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në UT (<i>Evidenca shitesë A.11</i>).</p> <p>Pasur parasysh këtë kriter, <i>GVJ sugjeron hartimin e një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i</p>	<p>Informacionin e plotë lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, studentët e marrin që në leksionin e parë (<i>RVB, f. 67</i>). Në</p>



<p>përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>këtë drejtim, vlen të përmendet dhe roli i sektorit për marrëdhëniet me studentët, i cili siguron udhëzime për secilin student në të gjitha çështjet akademike (<i>Evidenca shtesë A.11</i>). Informacioni i përditësuar gjendet dhe në faqen zyrtare elektronike të UT dhe ISE-së.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita e kryer në institucion dhe nga takimi me studentët, konstatohet që strukturat përgjegjëse në rang akademik dhe administrativ kanë mundësuar dhënien e informacionit në mënyrë të saktë e të kuptueshme (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>). Institucioni ka ngritur sistemin elektronik të përshtatshëm për arritjen e shkëmbimit të informacionit nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm (<i>Evidenca 2, nenet 85-86</i>). Ky informacion ka qenë lehtësisht i arritshëm edhe në distancë (sidomos gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19), duke realizuar shkëmbimin e të dhënave në rrugë elektronike (nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit: <a href="https://ise.edu.al/portali-studenteve/logohu">https://ise.edu.al/portali-studenteve/logohu</a>, postës elektronike dhe platformës së ngritur për mësimdhënien në distancë) (<i>Evidenca 24; Evidenca 26; Evidenca 27</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.</p>	<p>Në përputhje me nenin 20 të Rregullores së ISE-së, sekretaria mësimore është përgjegjëse, ndër të tjera, për të ruajtur informacionin, dokumentacionin dhe dokumentet që ilustrojnë aktivitetin mësimor të studentëve (<i>Evidenca shtesë A.6</i>). Zyra e sekretarisë mësimore administron dosjet personale të studentëve, të dhënat që lidhen me provimet përfundimtare dhe notat përfundimtare të vlerësimit të tyre, të cilat gjenden dhe në sistemin elektronik të këtij universiteti (<i>Evidenca 8</i>). Këto të dhëna të administruara u konsultuan gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ, si dosje të studentëve, ashtu dhe procesverbale të vlerësimit të tyre, dokumente të cilët u gjetën të rregullt në formë dhe përmbajtje. Nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve në sekretarinë mësimore, rishtas dhe të transferuar, për zgjedhur në mënyrë rastësore, u konstatua se në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit. Nuk u konstatuan probleme sa i përket matrikullimit të studentëve, por në regjistrin e arritjeve akademike GVJ konstatoi gjatë vizitës së kryer në institucion që nuk gjendeshin të hedhura në mënyrë të plotë notat e provimeve si dhe të dhëna të plota të studentëve të regjistruar. Gjithashtu, për vitet e kaluar, fletët e regjistrimit nuk ishin mbyllur në përputhje me rregullat e administrimit të regjistrave të të dhënave. <b><i>GVJ sugjeron që sekretaria e ISE duhet të marrë masa për të kryer përditësimin në kohë të të dhënave në regjistrat përkatës, sikundër kërkohet nga neni 101 i ligjit Nr. 80/2015, i ndryshuar dhe nga rregullat e sekretarisë mësimore (Evidenca 8; Evidenca shtesë "Minutat Msc").</i></b></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4														
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.														
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve													
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar për programin e studimit për secilin vit akademik objekt shqyrtimi. Të dhënat përfshijnë statistikat e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, aktivitetet ku janë përfshirë, studentët e diplomuar dhe të dhënat mbi punësimin e tyre ( <i>Evidenca shitesë A.5, tabela 21, tabela 22, tabela 23; Evidenca 14, pika 7</i> ).													
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni zotëron të dhënat e nevojshme statistikore për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara, për programin e studimeve të ciklit të dytë. Të dhënat administrohen nga sekretaria mësimore, në dokumentacionin e mbajtur për këtë qëllim ( <i>Evidenca 8; Evidenca shitesë A.5, tabela 21, tabela 22, tabela 23; Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i> ). Referuar <i>Evidencës shitesë Tabela Nr. 21 MSC Profile Drejtësi</i> dhe vizitës në institucion numri i studentëve për këtë program studimi sipas profileve rezulton:													
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Profili i programit</th> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">MSH "Legjislacion dhe institucione europiane"</td> <td>2019-2020</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td colspan="2"><b>Totali</b></td> <td><b>30</b></td> </tr> </tbody> </table>	Profili i programit	Viti akademik	Të regjistruar	MSH "Legjislacion dhe institucione europiane"	2019-2020	10	2020-2021	8	2021-2022	12	<b>Totali</b>		<b>30</b>
Profili i programit	Viti akademik	Të regjistruar												
MSH "Legjislacion dhe institucione europiane"	2019-2020	10												
	2020-2021	8												
	2021-2022	12												
<b>Totali</b>		<b>30</b>												
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon në mënyrë të saktë të dhënat e nevojshme që tregojnë ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve, nga regjistrimi deri në diplomim, fakt i cili vërtetohet nga dokumentacioni ( <i>Evidenca shitesë A.5, tabela 21, tabela 22, tabela 23; Evidenca 14, pika 7</i> ), ashtu dhe nga dokumentet e depozituar në sekretarinë mësimore si regjistra, procesverbale të notave (në përputhje me nenin 20 të Rregullores së ISE-së - <i>Evidenca shitesë A.6 -</i> ), etj. ( <i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i> ).													
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga aktet e konsultuar vërehet që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, si sekretaria mësimore, janë mbajtur përgjithësisht në mënyrë të saktë dhe mund të aksesohen me lehtësi. Aksesimi në to mundësohet nga baza e të dhënave elektronike, e krijuar për këtë qëllim ( <i>Evidenca 8</i> ).													



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sipas RVB, f. 69, strukturat përgjegjëse të ISE-së, janë të përfshirë në procesin e krijimit të raporteve analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe të shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre. Raportet përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore që kanë të bëjnë ndër të tjera me studentët, tregun e punës, etj.</p> <p>Të dhënat e hartuara dhe të përpunuara shërbejnë si bazë për marrjen e masave të nevojshme me qëllim përmirësimin e këtyre treguesve (Evidenca 14; Evidenca 5).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në harmoni me përcaktimet e nenit 98/1, gërma c, të ligjit Nr. 80/2015, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>Në përputhje me këtë parashikim ligjor, në nenet 125/1, pikat 1, 2 dhe 129 në lidhje me nenet 30, 40, 41, 42, 43 të statutit të UT, përcaktohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e UT dhe përfaqësohen në senat, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënies me studentët, Komisionin e përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisionin e përhershëm të kurrikulës, Këshillin e etikës, Këshillat e Studentëve (Evidenca 2).</p> <p>Të njëjtat parashikime duhet të parashikohen dhe në Rregulloren e përgjithshme të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>E drejta për pjesëmarrje në vendimmarrjen e UT është garantuar në mënyrë efektive, kjo si në pikëpamje të akteve të brendshme rregulluese, ashtu dhe nga pohimet e studentëve, gjatë takimit të zhvilluar me ta. Emrat e studentëve, anëtarë të senatit, etj., mund të konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare elektronike të institucionit (<a href="https://unitir.edu.al/senati-akademik/">https://unitir.edu.al/senati-akademik/</a>) si dhe në dokumentacion (Evidenca shtesë A.5, tabela 24; Evidenca shtesë A.20).</p> <p>Mendimet e studentëve mblidhen në mënyrë periodike dhe shqyrtohen nga institucioni me qëllim marrjen e masave për ndërmarrjen e veprimeve në të ardhmen (Evidenca 14, pika 7).</p> <p>Një prej studentëve është dhe anëtar i GVB (RVB dhe evidenca shtesë "Minutat Msc").</p> <p>Në RVB, f. 70, vihet në dukje se vlerësimi i rezultateve të mësimdhënies është pjesë e të dhënave që nxirren nga anketimet e studentëve për secilën lëndë e pedagog, anketime të cilët zhvillohen në mënyrë periodike (Evidenca 18, aneksi 3).</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit, objekt vlerësimi, është hartuar duke u mbajtur parasysh ngarkesa e detyrimeve akademike të studentëve, duke pasur në vëmendje shtrirjen e viteve akademike, numrin e lëndëve, etj. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh një ngarkesë akademike të përhapur drejt gjatë vitit. Procedurat e parashikuara janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe synojnë të pakësojnë sa më shumë qasjen burokratike (<i>Evidenca 7, nenet 6-11, 16</i>). Njohja e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme rezultojnë e rregulluar nga aktet e brendshme si dhe strukturat e ngritura për këtë qëllim (<i>Evidenca 7, neni 19</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në statutin e institucionit.</p>	<p>UT ka garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në statutin e institucionit. Nga pikëpamja e realizimit të kriterit, studentëve u jepet mundësia të shprehen mbi elementet e programit të studimit (<i>Evidenca 17; Evidenca "Model pyetësor studenti"; Evidenca shtesë B8; Evidenca shtesë B7</i>), mendime të cilët merren në shqyrtim nga strukturat përgjegjëse të institucionit, që shpesh në rishikim apo përmirësim të këtyre elementeve (<i>Evidenca 2, neni 140; Evidenca 16, neni 33</i>). Përfshirja në këtë proces garantohej po ashtu nga Këshilli Studentor (<i>Evidenca 2, nenet 130-132</i>), veprimtaria e të cilit iu bëhet e njohur studentëve dhe online: <a href="https://unitir.edu.al/keshillat-e-studenteve/">https://unitir.edu.al/keshillat-e-studenteve/</a>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nenet 30-35 të Rregullores së ISE-së dhe nenet 21-23 të Rregullores së programit të ciklit të dytë përcaktojnë në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës. Në këto akte, nuk rregullohet procedura e ankimimit të vlerësimit, me përjashtim të një parashikimi të përgjithshëm në nenin 20/1, germa dh, të Rregullores së programit, sipas të cilit studenti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimimit për çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të tij (<i>Evidenca 6; Evidenca 7</i>). Në <i>RVB, f. 70</i>, evidentohet se studenti ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe ka të drejtën e ankimimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve (<i>Evidenca 6, neni 51</i>), por ky afat nuk përmendet në rregulloren e programit. Nga dokumentacioni (<i>RVB</i>), si dhe nga vizita në institucion, nuk rezultojnë që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur me procesin e vlerësimit të dijeve, pasi çdo pretendim i studentëve që kanë pasur të tillë, është sqaruar nga pedagogu i lëndës (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc", takimet me stafin akademik, studentët dhe vizita në sekretarinë mësimore</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Naq përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi V.6**

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar në fushën e kërkimit shkencor dhe në nxitjen e personelit akademik që të përfshihet në këtë veprimtari (<i>Evidenca 2, nenet 5, 8, 114-121</i>).</p> <p>Në këtë drejtim, universiteti nxit dhe mbështet botimet e punimeve në revista të ndryshme shkencore si dhe pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore, në përputhje me fondin për kërkimin shkencor të IAL (<i>Evidenca 2, neni 120</i>). Kriteret dhe procedurat për marrjen e mbështetjes financiare janë përcaktuar në udhëzuesit që lidhen me kërkimin shkencor (<i>Evidenca 32; Evidenca 33</i>).</p> <p>Rezulton nga takimi me stafin akademik, që anëtarët e tij kanë qenë pjesëmarrës në disa veprimtari, si konferenca ndërkombëtare apo veprimtari kërkimore-shkencore (<i>Evidenca 14, pika 3; Evidenca 28</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Në përputhje me sa është përcaktuar në statut për fushën e kërkimit shkencor, rezulton që UT të ketë vendosur objektiva të qartë në këtë drejtim dhe të ketë lidhur marrëveshje konkrete ndërkombëtare, në nivel rajonal dhe më gjerë. Objektivat vlejné dhe për stafin akademik të këtij programi të studimeve (<i>Evidenca 2, neni 8; Evidenca 3, pikat 2 dhe 3; Evidenca shtesë A.6, neni 7; Evidenca 28</i>).</p> <p>Marrëveshjet e përbashkëta synojné në realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Në funksion të përmbushjes së këtyre synimeve, në këtë universitet është ngritur dhe funksionon drejtoria e marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila ndjek procesin në fjalë (<i>Evidenca 2, neni 44</i>). Kjo zyrë është pjesë e strukturës administrative të rektoratit dhe funksionon në përputhje me rregulloren e miratuar për organizimin dhe funksionimin e rektoratit (<i>Evidenca shtesë A. 19</i>).</p> <p>Universiteti ka vënë në dispozicion të dhëna konkrete sipas të cilave, në kuadër të projekteve ku është angazhuar, ka organizuar disa aktivitete me pjesëmarrje të studentëve, ku përfshihet projekti i BE “Jean Monnet”. Në kuadër të tij, në muajin Shkurt 2020, në bashkëpunim me universitetin e Dubrovnik-ut (Kroaci), është organizuar shkolla dimërore “<i>Strategjitë e demokratizimit dhe pajtimit në Evropën Juglindore: ripërcaktimi i politikave joefektive</i>”. Evidentohet shkolla verore në muajin Korrik 2019 “<i>Angazhimi për miqësinë: Ndryshimi i kulturës politike në Ballkan</i>”, po në kuadër të projektit “Jean Monnet”, në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane të Serbisë, si dhe shkolla dimërore “<i>Krijimi i bashkëpunimit territorial: Ndikimi i dialogut ndërkulturor dhe rrjedhat e migrimit në Juglindje Evropë</i>”, e zhvilluar nën të njëjtin projekt në muajin Dhjetor 2018, në bashkëpunim me universitetin e Bolonjës (Itali) (<i>Evidenca 2.8</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojné, shkruajnë dhe publikojné studime e punime shkencore.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në fushën e kërkimit shkencor është një ndër objektivat e stafit akademik të këtij programi studimi (<i>Evidenca 7, neni 4/3, germa ç; Evidenca 5, f. 9-10</i>).</p> <p>Në përputhje me këtë objektiv, studentëve u mundësohet, nëpërmjet</p>






	<p>zyrës së kërkimit shkencor në UT dhe strukturave të ISE-së, marrja dijeni për aktivitetet e ndryshme ku mund të prezantojnë studime apo punime shkencore: <a href="https://ise.edu.al/aktivitete/">https://ise.edu.al/aktivitete/</a>.</p> <p>Gjatë takimit të zhvilluar në institucion u konfirmua fakti se personeli akademik ka nxitur studentët për t'u angazhuar në veprimtari kërkimore e shkencore, fakt i përmendur dhe në faqen 71 të RVB (<i>Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Rezultoni që studentët të jenë bërë pjesë e punimeve shkencore (<i>Evidenca shitesë A.5, tabela 22; Evidenca shitesë A.1.3</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet që ka bërë në statut sa i përket fushës së kërkimit shkencor, nga aktet e administruar dhe nga vizita në institucion, konstatohet që universiteti siguron mbështetje për stafin akademik dhe për studentët, në drejtim të publikimit të punimeve të tyre në revista shkencore ndërkombëtare (<i>Evidenca 2, neni 120</i>). Për nxitjen e stafit akademik dhe studentëve në këtë drejtim është parashikuar një buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime (<i>Evidenca 2, neni 145; Evidenca 33</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u konfirmua ky fakt, zbatuar në praktikë përmes vendimmarrjes së strukturave përgjegjëse dhe dokumentacionit përkatës që vërteton mbështetjen e personelit akademik (<i>Evidenca shitesë A.18; Evidenca shitesë "Minutat Msc"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Synimi i institucionit në përgjithësi dhe i personelit akademik të këtij programi studimi në veçanti, për të nxitur dhe mbështetur studentët drejt studimeve inovative, shprehet në aktet e krijuara, që ilustrojnë këtë objektiv (<i>Evidenca 2, neni 7/2, germa a; Evidenca 7, neni 4/5; Evidenca 5, f. 7-8</i>). Nëpërmjet krijimit të mundësive për zbatim të marrëveshjeve me IAL të huaja, kërkohet të arrihet të menduarit ndryshe tek studentët e këtij programi, në përputhje me zhvillimet e reja objektive dhe për dhënien e ideve të reja në fushën e së drejtës evropiane.</p> <p>Në fakt, disa prej studentëve kanë publikuar punime në përmbledhjen "Shqipëria në rrugën e integritit evropian" (<i>Evidenca shitesë A.1.3</i>).</p> <p>Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri, studentët kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme ekstrakurrikulare, që i motivojnë në zgjerimin e dijeve sipas fushave të studimit që kanë përzgjedhur (<i>Evidenca shitesë A.1.2; Evidenca shitesë A.1.4; Evidenca shitesë A.1.5</i>).</p> <p>Aktivitetet në të cilët janë përfshirë studentët mund të aksesohen dhe online: <a href="https://ise.edu.al/aktivitete/">https://ise.edu.al/aktivitete/</a>.</p> <p>Në lidhje me angazhimin në drejtim të patentave, vlerësohet se nuk gjen zbatim për studentët e këtij programi të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.</p>	<p>Rregullat lidhur me diplomimin e studentëve janë përcaktuar në nenet 36-37 të rregullores së ISE-së dhe në nenin 25 të rregullores së programit të studimit (<i>Evidenca shitesë A.6; Evidenca 7</i>).</p> <p>Shtjellimi i rregullave për punimin e diplomës është realizuar në dokumentin specifik të udhëzuesit për punimin e saj (<i>Evidenca 9</i>).</p> <p>Sikundër raportohet në faqen 72 të RVB, gjatë këtij procesi, studentët mbajnë kontakte të rregullta me pedagogët dhe udhëheqësit e tyre, ku sipas nevojave të punimit që është duke u kryer, marrin dhe ndihmën e</p>



	duhur për secilin nga aspektet që lidhet me punimin e një diplome (Evidenca 9, pika 2.3).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
			X

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>ISE i ka mëshuar politikës së bashkëpunimit me organizmat shkencorë kombëtarë, por dhe ndërkombëtarë, duke e shprehur fillimisht këtë në statutin e institucionit dhe në dokumente të tjerë të brendshëm strategjikë (Evidenca 2, nenet 7/4, germa c dhe 8/3-6; Evidenca 3, pikat 2 dhe 3; Evidenca shtesë A.6, neni 8; Evidenca 5, f. 9-11). Në përputhje me këto përcaktime, brenda institucionit, në nivel rektorati, është ngritur dhe funksionon drejtoria e marrëdhënieve ndërkombëtare që mundëson vënien në praktikë të politikave të bashkëpunimit (Evidenca 2, neni 44). Gjithashtu, vlen të përmendet dhe hartimi i një strategjie të posaçme të bashkëpunimit në rang kombëtar me institucione të tjera si dhe në drejtim të ndërkombëtarizimit, që përfshin periudhën 2018-2023 (Evidenca 3). Vërehet nga aktet se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh për arritjen e këtij objekti, me disa universitete vendase dhe të huaja si dhe të vendeve të BE-së (Evidenca "Marrëveshjet e bashkëpunimit") si dhe është bërë pjesë e programeve Erasmus, për të siguruar mobilitetin e stafit dhe studentëve (Evidenca 28; Evidenca shtesë A.2). Mobiliteti i studentëve, i stafit akademik dhe atij administrativ mundësohet edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme kërkimore (Evidenca 14). Gjithsesi, nga të dhënat e administruara nuk rezulton që ndonjë prej studentëve të këtij programi studimi të jetë mobilizuar nga dhe drejt programit të studimit (Evidenca shtesë A.5, tabela 20). Rëndësi paraqet në këtë drejtim aplikimi dhe zbatimi në vijimi i programeve "Jean Monnet Chair" dhe "Jean Monnet Module", të cilët kontribuojnë në thellimin e njohurive në fushën e integritit evropian (Evidenca 28, f. 3; Evidenca shtesë B.1; Evidenca shtesë B.2). Gjithashtu, vlen të vihet në dukje dhe zhvillimin e trajnimit të vazhduar me temë "EU Integration-Background &amp; Perspective", me pjesëmarrjen e profesorit të huaj Hubert Petit, të organizuar nga ISE (Evidenca 28, f. 3).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Aktet e brendshme të universitetit nxitin stafin akademik në përdorimin e metodave të tilla të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët, në mënyrë që ata të jenë të pajisur me njohuri të thelluara teorike si dhe të aftë për të kryer kërkime shkencore në fushat përkatëse (Evidenca 7, neni 4/3). Programet e lëndëve nga ana tjetër, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që</p>



	<p>garantojnë po ashtu vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve (<i>Evidenca 7, neni 4/4</i>).</p> <p>Në funksion të kërkimit, në kurrikulën e programit është parashikuar dhe zhvillohet si lëndë më vete ajo e “Kërkimit shkencor” (<i>Evidenca “Metoda të kërkimit shkencor”</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Përpyekjet pozitive të universitetit në drejtim të përfshirjes së studentëve vendas dhe të huaj në projekte kërkimore gjejnë shprehje së pari në aktet e brendshme të IAL (<i>Evidenca 7, neni 4/3, germa ç; Evidenca 5, f. 7-8</i>).</p> <p>Konstatohet që nga ana e institucionit bëhen thirrje për studentët nëpërmjet faqes zyrtare të ISE-së: <a href="https://ise.edu.al/aktivitete/">https://ise.edu.al/aktivitete/</a>, por dhe nga rektorati në faqen online të UT-së, për aplikime në projekte, konferenca, botime, programe mobiliteti, nga të cilët mund të përfitojnë studentët apo kërkuesit shkencorë.</p> <p>Për të lehtësuar këto aplikime, UT zbaton që nga viti 2021 programin “UT-kërkim, ekselencë dhe inovacion”, dokument i cili siguron të dhënat e duhura për mënyrën dhe procedurat e paraqitjes së propozimeve dhe për aplikimin nga të interesuarit (<i>Evidenca 32</i>).</p> <p>Gjithashtu, vërehet se për të mundësuar përfshirjen e studiuesve të rinj në projekte kërkimore, në përputhje me përcaktimet statutoare, është vënë në dispozicion të tyre një grant për kërkimin, ku për të mundësuar përfitimin prej tij, institucioni ka miratuar udhëzuesin përkatës për programin e grantit (<i>Evidenca 33</i>).</p> <p>Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri dhe përfshirjen e studiuesve të rinj në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare, departamenti ka fituar dhe është pjesë e projekteve “Jean Monnet” (<i>Evidenca 28</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni ka krijuar bazën e nevojshme në fushën e kërkimit shkencor, ku mund të përfshihen dhe kërkuesit shkencorë të huaj (<i>Evidenca 2, neni 121</i>). Politika e ndjekur nga ISE përfshin atë fushë të kërkimit që i intereson programit të studimit, në fushën e të drejtës së BE-së, por duke mbajtur në vëmendje dhe veçoritë kombëtare specifike. Nga dokumentacioni vërehet se në këtë drejtim, janë përfshirë lektorë të ftuar në veprimtari të ndryshme të organizuara nga ISE (<i>Evidenca shtesë B.5</i>). Nuk ka të dhëna lidhur me numrin e kërkuesve shkencorë të huaj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Politika favorizuese e universitetit ndaj mobilitetit të studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare shprehet mjaft mirë në aktet e brendshme të tij (<i>Evidenca 7, neni 19; Evidenca 3, pika 2</i>). Një ndër objektivat e IAL është zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore, me qëllim që t’u ofrohet studentëve përvojë ndërkombëtare (<i>Evidenca 5, f. 10-11</i>). Është drejtorja e marrëdhënieve ndërkombëtare struktura në nivel rektorati, e cila është ngarkuar me detyrën për të mundësuar lëvizjen e studentëve dhe shkëmbimit të studentëve e personelit në përgjithësi (<i>Evidenca 2, neni 44</i>). Njoftime e bërë nga kjo zyrë gjenden dhe në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://unitir.edu.al/thirrje-e-hapur-per-student/">https://unitir.edu.al/thirrje-e-hapur-per-student/</a> dhe</p>



	<p><a href="https://ise.edu.al/bursa-erasmus/">https://ise.edu.al/bursa-erasmus/</a>. Praktikisht, ISE realizon mobilitetin përmes programit Erasmus+, nga i cili ka përfituar në vijim të aplikimit përkatës (Evidenca 28). Rezultoni nga të dhënat dhe takimet në institucion se deri më tani, nga ky program kanë përfituar 2 studentë të ISE-së, por që nuk i përkasin këtij programi studimi (Evidenca 14, f. 6; Evidenca shtesë A. 5, tabela 20; Evidenca shtesë "Minutat Msc").</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.</p>	<p>Në përputhje me qëllimin e tij strategjik, universiteti, gjatë realizimit të veprimtarive kërkimore dhe të mësimdhënies, mundëson pjesëmarrjen e personelit akademik të huaj si dhe të studentëve të huaj (Evidenca 2, neni 7/4, germa d). Edhe në këtë aspekt, rolin kryesor e luan drejtorja e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në funksion të strategjisë së ndërkombëtarizimit të ISE, institucioni inkurajon shkëmbimin e stafit për të tërhequr personel ndërkombëtar akademik të kualifikuar (Evidenca 5, f. 10-11). Nga aktet rezultoni që në programin e studimit është aktivizuar personel akademik i huaj. Staf akademik i huaj është përfshirë dhe në veprimtaritë e ndryshme të organizuara nga universiteti (Evidenca 28; Evidenca shtesë B.5; Evidenca shtesë B.4). IAL ka lidhur marrëveshje bashkëpunim me disa institucione të huaja arsimore dhe nëpërmjet organizimit të përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkët kërkimore e shkencorë, u jep mundësinë anëtarëve të stafit akademik të huaj dhe studentëve të huaj, që të marrin pjesë në to (Evidenca 28; Evidenca "Marrëveshje të bashkëpunimit"). Aktivitetet e zhvilluara mund të konsultohen dhe në faqen elektronike të institucionit: <a href="https://ise.edu.al/aktivitete/">https://ise.edu.al/aktivitete/</a>. Të dhënat lidhur me këtë kriter janë mbajtur të detajuara nga ana e institucionit, në lidhje me stafin akademik të huaj, të angazhuar në mësimdhënie (Evidenca shtesë A.5, tabela 20; Evidenca shtesë B. 5). Nga takimi në institucion u konfirmua se në këtë veprimtari nuk janë përfshirë student të huaj (Evidenca shtesë "Minutat Msc").</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.8</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura e ngritur njësi të posaçme në drejtim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve, sipas rregulimeve të bërë në statut, rregulloren e përgjithshme, në nivel qendror dhe të njësisë kryesore (Evidenca 2, neni 44; Evidenca shtesë A.6), me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e regjistrimit në programin e studimit (Evidenca 8) si dhe</p>



	<p>nëpërmjet veprimtarisë së zyrave përkatëse (<i>Evidenca shtesë A.11</i>). Informimi dhe shërbimi ndaj studentit realizohet nga sekretaria mësimore, në nivel njësie, si dhe një rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt luan dhe departamenti gjatë periudhës së studimeve (<i>RVB, f. 74</i>). Gjithashtu, informacionin e nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet përkatëse janë të publikuara dhe në faqen <i>online</i> të ISE: <a href="https://ise.edu.al/studenti/">https://ise.edu.al/studenti/</a>. Faqja zyrtare e UT-së për këtë pjesë të informacionit për studentët (<a href="https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/">https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/</a>) është në ndërtim e sipër.</p> <p><b><i>GVJ sugjeron që në aktet e brendshme të ISE-së, të ketë përcaktime të mirëfillta lidhur me njësitë e posaçme për informimin dhe shërbimin e studentëve, në mënyrë që të orientohen lehtësisht në këtë drejtim.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, konstatohet që ata marrin këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme përgjatë kohëvazhdimit të procesit mësimor të programit të studimit (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këtë qëllim, ku rol kryesor luan departamenti dhe stafi akademik, koordinatori, zyrat e administratës së IAL, Zyra e karrierës dhe orientimit studentor, të cilët udhëzojnë studentët mbi anën akademike dhe administrative të procesit, zgjedhjen e lëndëve, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (<i>Evidenca 7, nenet 13, 14; Evidenca 8; Evidenca shtesë A.11</i>).</p> <p>Platformat e komunikimit janë të larmishme dhe synojnë shkëmbimin e saktë dhe të shpejtë të informacioneve të ndryshëm, përmes faqes zyrtare të IAL <i>online</i>, rrjeteve sociale të komunikimit dhe postës elektronike (<i>Evidenca 2, nenet 85-86</i>).</p> <p>Përgjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, UT ka miratuar platformën elektronike <i>e-learning</i> dhe udhëzuesin e nevojshëm, e cila është përdorur gjatë gjithë procesit të mësimdhënies (<i>Evidenca 24; Evidenca 26; Evidenca 27</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Ndër njësitë e ngritura brenda strukturës së rektoratit të UT-së është Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, sipas nenit 14 të Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit (<i>Evidenca shtesë A. 19</i>).</p> <p>Sektori i marrëdhënieve me studentët në këtë drejtori, në rektorat, ka për detyrë të mbulojë organizimin e jetës studentore, mbikëqyrjen dhe nxitjen e eventeve kulturore, sportive, mjedisore, etj., për të krijuar gjallëri dhe aktivizim mes të rinjve. ISE bashkëpunon me këtë strukturë në lidhje me karrierën dhe orientimin e studentëve për programet e studimeve që ofrohen prej kësaj njësie. Zyra në fjalë ndihmon studentët që të kuptojnë pikat e tyre të forta akademike dhe rritjen e potencialit të të nxëniet, të nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës, të lehtësojë procesin e rritjes së dijeve duke krijuar një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues midis studentëve, personelit akademik dhe personelit mbështetës (<i>Evidenca shtesë A.11</i>). Të dhënat mbi këtë zyrë, në faqen zyrtare të IAL, janë në ndërtim e sipër:</p>



	<p><a href="https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/">https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/</a>. Pedagogët e ISE-së dhe koordinatori udhëzojnë studentët çdo fillim viti akademik dhe semestri mbi anën akademike të procesit, lëndët, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (Evidenca 7, nenet 13-14; RVB, f. 75). Institucioni siguron gjithashtu këshillimin për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Në përfundim të saj, studentët vlerësojnë mënyrën e kryerjes së praktikës, me anë të formularit që plotësohet për këtë qëllim, aktivitetet për të cilin vlerësohen dhe nga pedagogu mbikëqyrës (Evidenca 6, nenet 74-77; Evidenca 7, neni 24; Evidenca shtesë B.9). Nuk ka një rregullore për praktikën sipas gjendjes së akteve dhe konfirmimit të sjellë nga vetë institucioni (Evidenca shtesë A.4). Institucioni ka lidhur disa marrëveshje me institucione publike, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale (Evidenca "Marrëveshjet e bashkëpunimit"; Evidenca 14, f. 4). <b>GVJ, në lidhje me këtë kriter, sugjeron lidhjen e marrëveshjeve dhe me institucione e organe të tjerë të specializuar si dhe përfundimin sa më shpejt të marrëveshjeve të nisura, në përputhje me profilizimin e këtij programi studimi.</b></p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>ISE, nëpërmjet këtij programi studimi synon të aftësojë studentët që të përballen me tregun e punës si dhe të jetë i përditësuar për të qenë në koherencë me nevojat e tregut të punës për specialistë të studimeve evropiane (Evidenca 7, neni 4/3, 5). Si rregull, në çdo IAL është zyra e karrierës, ajo që siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë. Në nivel qendror, rezultojnë të ketë pranë rektoratit të UT-së një sektor për marrëdhënien me studentët që shërben si zyrë karriere dhe orientimi studentor (Evidenca shtesë A.11). Në funksion të veprimtarisë së kësaj zyre nuk rezultojnë të ketë një rregullore dhe planveprim të hartuar dhe miratuar nga institucioni. ISE nuk ka një zyrë të tillë në strukturën e tij, por si njësi ka vendosur si synim ruajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar në vite (alumni), për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin, si promovues të vlerave të tij (Evidenca 5, f. 7). ISE mban të dhënat për punësimin e studentëve të diplomuar (Evidenca shtesë A. 5, tabela 23; Evidenca 14, f. 18). Përqindja e punësimit të të diplomuarve paraqitet në masën 80%. Sikundër vërehet nga evidencat e cituara mbi statistikat e punësimeve, këto të dhëna bëhen pjesë e raportit vjetor të ISE-së. Faqja online e institucionit, e cila duhet të paraqesë të dhëna të tjera mbi veprimtarinë e kësaj zyre, mbi alumni-t, mundësitë për punësim, etj., është në ndërtim: <a href="https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/">https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/</a>.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="614 1892 774 1960">Përmbushet</td> <td data-bbox="774 1892 973 1960">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="973 1892 1189 1960">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1189 1892 1394 1960">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		



standardit			X	
------------	--	--	---	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sipas përcaktimeve ligjore të nenit 103 e vijues të ligjit Nr. 80/2015, UT ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në nenet 41 dhe 138-141 të statutit (<i>Evidenca 2</i>).</p> <p>Sipas nenit 13 të Rregullores së përgjithshme, sektori i sigurimit të cilësisë përfshihet në strukturën e administratës qendrore (<i>Evidenca 6</i>).</p> <p>Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit. Komisioni, për përmbushjen e këtij objekti, bashkërendon dhe bashkëpunon me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohet në statut dhe në rregulloren e tij (<i>Evidenca 2, neni 41</i>).</p> <p>Sipas nenit 141 të statutit, në njësitë kryesore të UT-së krijohen dhe funksionojnë njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC). Mënyra e funksionimit të NJSBC-ve në njësitë kryesore të UT-së përcaktohet në rregulloret e tyre të brendshme.</p> <p>Sipas akteve shtesë të sjellë nga ISE, konstatohet që senati akademik ka miratuar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e njërive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në Universitetin e Tiranës.</p> <p>Në përputhje me këto parashikime, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional. Detyrat e njërive lidhen me garantimin e plotësisht të standardeve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit. Institucioni ka hartuar dokumentet përkatës që mundësojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 16; Evidenca 17; Evidenca shtesë A.4.1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur</p>	<p>Lidhur me sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, në nivel</p>



<p>dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>institucional, me vendimin Nr. 43, datë 7.12.2020 të senatit akademik të UT-së është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ku tre prej anëtarëve janë përfaqësues të studentëve (<a href="https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/01/20210106_093036.pdf">https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/01/20210106_093036.pdf</a>).</p> <p>Grupi i vlerësimit të cilësisë funksionon dhe në nivel njësie kryesore, ISE (<i>Evidenca shitesë A.20</i>), ku një prej anëtarëve vjen nga radhët e studentëve.</p> <p>Rëndësia që i ka dhënë IAL strategjisë nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në statutin e institucionit, por politika të detajuara janë shprehur në rregulloren për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 16</i>).</p> <p>Në këtë proces dhe struktura, sikundër u vu në dukje në paragrafët më lart, janë përfshirë dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve.</p> <p>Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 139/1, germa dh, i statutit të UT-së (<i>Evidenca 2</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor instrumente e metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në dokumentin që parashikon instrumentet për kryerjen e këtyre vlerësimeve (<i>Evidenca 16, neni 31/2; Evidenca 17</i>).</p> <p>Në përputhje me rregulloren për sigurimin e cilësisë, UT e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në këtë dokument, institucioni ka qartësuar parime dhe standarde konkrete në shërbim të krijimit të një sistemi efikas për sigurimin e cilësisë. Parashikohet se institucioni duhet t'i nënshtrohet sigurimit të jashtëm të cilësisë në baza ciklike, në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane (<i>Evidenca 16, neni 5/5, neni 6, neni 7</i>).</p> <p>Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve (<i>Evidenca 16, nenet 30, 33</i>).</p> <p>Njësia e sigurimit të cilësisë në nivel universiteti, ndër të tjera, bashkëpunon me ASCAL për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e UT-së (<i>Evidenca 16, neni 21/2, germa k</i>).</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka zhvilluar një sërë veprimtarish në funksion të aftësisë të stafit për procesin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca shitesë B. 6</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e</p>	<p>Në nenet 138 e 139 të statutit, UT ka përcaktuar politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit (<i>Evidenca 2</i>), të shtjelluara në mënyrë të hollësishme dhe në rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe atë të organizimit dhe funksionimit të NJSBC-ve të njëjësive kryesore (<i>Evidenca 16; Evidenca shitesë A.4.1</i>).</p>



kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Njësia e Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo njësi organizon pyetësinë studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit. Të dhënat e nxjerra nga këta pyetësorë përdoren gjatë procesit të vlerësimit të performancës akademike të çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik, po ashtu dhe në raport me lëndët e programit që ndjekin si dhe të shërbimeve të ofruar nga ISE. Mbi bazën e të dhënave të marra nga pyetësinë studentor dhe informacioneve të tjerë, hartohet raporti i vlerësimit vjetor (*Evidenca 16, nenet 21, 26, 30 dhe 13/1, germa I; Evidenca shtesë A.4.1, nenet 13-14; Evidenca 18*).

Në përfundim të vitit akademik, departamenti harton raportin vjetor, ku përfshihen të dhëna përshkruese si dhe sasiore mbi programin e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e studentëve, kalueshmërinë dhe notën mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe masat për t'u ndërmarrë në të ardhmen (*Evidenca 14; Evidenca "Raporti periodik NJSBC"*).

Në këtë mënyrë, kontrolli mbi cilësinë nis nga niveli bazë e më pas kalon në rang institucional, duke përfshirë të gjithë hallkat e IAL.

Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë ndërmjetëson, harton dhe jep raporte për aktivitete dhe nisma të reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UT-së si dhe realizon koordinimin e procesit të brendshëm të cilësisë. Funkcionimi i Komisionit duhet të rregullohet nga Rregullorja përkatëse, e hartuar dhe miratuar në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, gjë e cila nuk është realizuar nga institucioni.

Përgjegjësitë kryesore të Komisionit kanë të bëjnë me:

- Hartimin e planit të zhvillimit institucional për sigurimin e cilësisë;
- Vlerësimin për herë të parë të programeve të reja që do të ofrohen;
- Vlerësimin në vazhdimësi të programeve që ofrohen nga UT nëse janë në përputhje me standardet e cilësisë si dhe koherencën e tyre;
- Bashkëpunimin me ASCAL në rast akreditimi apo vlerësimi të cilësisë;
- Vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore në njësitë kryesore/degët e UT-së, në përputhje me standardet e cilësisë dhe hartimin e raporteve përkatës të vlerësimit të brendshëm;
- Ndjekjen e politikave të hartuara nga senati akademik për sigurimin e cilësisë dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre;
- Hartimin dhe organizimin çdo fund semestri për studentët të pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies në të gjithë programet e ofruar nga UT;
- Realizimin e studimeve gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve pas formimit të tyre akademik dhe efikasitetin e



	<p>programeve të ofruar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportimin para senatit akademik për rezultatet e vlerësimit dhe propozimin e nismave për përmirësimin e standardeve të cilësisë;</li> <li>- Bashkëpunimin me agjenci të huaja të sigurimit të cilësisë, anëtare të Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (<i>Evidenca 2, neni 140</i>).</li> </ul> <p>Rregullorja e cilësisë dhe paketa e instrumenteve të cilësisë, në këtë drejtim, sigurojnë parashikimin e procedurave që do të ndiqen si dhe japin modelet për secilin prej formularëve të vlerësimit (<i>Evidenca 16; Evidenca 17</i>).</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga aktet rezultojnë që struktura përgjegjëse në nivel institucional për monitorimin e cilësisë është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, anëtarët e të cilit zgjidhen nga senati akademik, me misionin e zhvillimit dhe forcimit të sistemit të cilësisë në UT, në mënyrë që t'i shërbejë nevojave të komunitetit universitar dhe organeve të tjera të interesuara që lidhen me cilësinë e institucionit dhe programet e studimit të ofruara nga UT (<i>Evidenca 2, neni 41</i>).</p> <p>Ky komision është përgjegjës për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit. Komisioni përgjigjet senatit akademik për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të menaxhimit të cilësisë dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe paraqet mendimin e tij për çështjet e cilësisë. Gjithashtu, mbikëqyr dhe harton rregulloret, politikën, programet, proceset akademike dhe joakademike, si dhe siguron respektimin e kornizës ligjore duke siguruar cilësi në UT, në bashkëpunim me të gjithë partnerët institucionalë dhe palët e interesuara (<i>Evidenca 16, nenet 15-16</i>).</p> <p>Komisioni ka në përbërje të tij 11 anëtarë, nga të cilët tre përfaqësuesë të studentëve (<i>Evidenca 2, neni 41</i>). Nuk është parashikuar në përbërje të tij eksperti i jashtëm.</p> <p>Në nivel të njësive kryesore, vepron njësi e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC), veprimtaria e së cilës zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në statut, në rregulloren për sigurimin e cilësisë në UT si dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore (<i>Evidenca 2, neni 141; Evidenca 16, neni 26; Evidenca shtesë A.4.1</i>).</p> <p>NJSBC në nivel të ISE-së është ngritur në datë 24.1.2022, në vijim të urdhrit të drejtorit të njësive, në përbërje të së cilës është dhe një</p>



	<p>përfaqësues i studentëve (<i>Evidenca shtesë A.20</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, me përfaqësues të zyrës për sigurimin e cilësisë, u referua se është në vijim puna për ngritjen e NJSBC në nivel departamenti, sikundër kërkon neni 6 i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve në njësitë kryesore (<i>Evidenca shtesë A.4.1; Evidenca shtesw "Minutat Msc"</i>).</p> <p>Në nivel të njësisë bazë, të gjitha veprimtaritë e departamentit përfshihen në raportin vjetor të njësisë (<i>Evidenca 14</i>). Konstatohet se, programet e studimit, i nënshtrohen në mënyrë periodike monitorimit dhe vlerësimit nga sistemi i sigurimit të cilësisë, gjë e cila ndikon në përmirësimin e tyre (<i>Evidenca 16, nenet 9, standardi 10, 12</i>). Raportet e monitorimit iu komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatës (<i>Evidenca 16, neni 32/4, germa a; Evidenca "Raporti periodik NJSBC"</i>).</p> <p>Në vijim të këtij procesi, Komisioni i përhershëm i kurrikulës dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë marrin masat e duhura, që kanë të bëjnë me aspektet akademike, të programeve dhe kurrikulave në UT (<i>Evidenca 2, neni 42 në lidhje me nenin 140/1, germa c; Evidenca shtesë A. 19, neni 11 dhe lidhja 3</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UT planifikojnë dhe organizojnë vlerësimin e brendshëm të cilësisë si për programet e studimit, ashtu dhe për institucionin (<i>Evidenca shtesë A.8</i>). Kryerja e procedurave, përmes mekanizmave të përcaktuar nga këto struktura, bëhet në mënyrë periodike mbi programin e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Drejtimet e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe përfshijnë vlerësimet e studentëve, vlerësimet e personelit akademik, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë të departamentit në fund të vitit akademik (<i>Evidenca 10; Evidenca 11; Evidenca 23, f. 29-31</i>).</p> <p>Në nivel njësie dhe të programit të studimit, syllabus-et e lëndëve rishikohen kur vlerësohet e nevojshme (<i>Evidenca 7, neni 11/3</i>). Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi. Brenda programit të studimit mund të bëhen ndryshime deri në masën 20% të përmbajtjes. Propozimi i argumentuar bëhet nga departamenti i këtij programi studimi dhe përcillet në rektorat nga drejtori i ISE-së, ku merret në shqyrtim dhe vlerësohet nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, që është dhe struktura përgjegjëse për të kryer këtë vlerësim. Ndryshimet në planin mësimor realizohen me vendim të senatit akademik, duke njoftuar në vijim Ministrinë e Arsimit jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik (<i>Evidenca 7, neni 10/3, 4; Evidenca 2, neni 42/1, neni 105; Evidenca shtesë A .19, neni 11 dhe lidhja 3; Evidenca 31</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aktet e brendshëm për sigurimin e cilësisë, institucioni ka parashikuar shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit (<i>Evidenca 16</i>). Instrumentet paraqiten në mënyrë të detajuar në paketën përkatëse, të miratuar nga senati akademik i UT-së (<i>Evidenca 17</i>). Në tërësi këto mjete përdoren nga</p>



	<p>Komisioni për sigurimin e cilësisë, NJSC në nivel qendror dhe NJSBC e njësisive kryesore, me qëllim përgatitjen e raportit vjetor institucional, ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Raporti në fjalë i paraqitet senatit akademik të UT-së (<i>Evidenca A.4.1, neni 14</i>).</p> <p>Mekanizmat e përdorur janë pyetësorë dhe vlerësime të studentëve, fokus grupe me studentët, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i vetëvlerësimit të pedagogëve, raporte vjetore të ISE-së, etj. (<i>Evidenca 16, neni 31; Evidenca 17; Evidenca shitesë A.14; Evidenca shitesë A.15; Evidenca shitesë B.7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të procesit të vlerësimit, si në rang departamenti, ashtu dhe institucional, të dhënat e grumbulluara përpunohen dhe dokumentohen në aktet e mbajtur për këtë qëllim, të cilët më pas dërgohen në instancat përgjegjëse për vendimmarrje të mëtejshme (<i>Evidenca 16, neni 16/1, germa g; Evidenca shitesë A.4.1, neni 14</i>).</p> <p>Në mënyrë më të detajuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në rastin kur propozohen ndryshime në programin e studimit (kurrikulat), informacioni shkresor dërgohet pranë zyrës së kurrikulave dhe komisionit për kurrikulat dhe mësimin. Nëse vlerësohen ndryshimet e kurrikulave, akti përkatës i dërgohet për miratim senatit (<i>Evidenca 7, neni 10/3, 4; Evidenca 2, neni 42/1</i>).</li> <li>- Në nivel institucional, të dhënat e vlerësimit NJSBC e njësisë bazë i përpunon dhe i dërgon pranë NJSBC në nivel njësie kryesore, bashkë me rekomandimet përkatës. Më pas, kjo njësi, brenda afateve të caktuar ia përcjell të dhënat NJSBC së UT, e cila harton raportin e vlerësimit institucional, të cilin ia kalon për shqyrtim Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Ky i fundit, më pas e përcjell në Senat, me qëllim marrjen e vendimeve në funksion të përmirësimeve të nevojshme (<i>Evidenca shitesë A.4.1, neni 14</i>).</li> </ul> <p>Hartimi i raportit dhe procedurat për njohjen me të nga autoritetet përgjegjëse janë shtjelluar në rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve në njësitë kryesore (<i>Evidenca 16; Evidenca shitesë A.4.1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Në aktet për sigurimin e cilësisë janë përcaktuar elementet që duhet të përmbajë raporti vjetor i vlerësimit. Raporti duhet të përmbajë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik (<i>Evidenca 18</i>).</p> <p>Në nivel departamenti, në raportin vjetor të departamentit, bëhet një përshkrim i rezultateve të vlerësimeve, por nuk është hartuar një plan veprimi për masat e marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik (<i>Evidenca 14; Evidenca "Raporti periodik NJSBC"</i>).</p> <p>Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (<i>Evidenca shitesë A.4.1, nenet 5/4; 8, 9, 14; Evidenca 16, neni 33</i>).</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion vërehet që programi i studimit vlerësohet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë në nivel njësie (<i>Evidenca 2, neni 141/2; Evidenca 16, neni 12, 26; Evidenca shtesë A.4.1, neni 8-9</i>). Në përfundim të vitit akademik, mbledhen të dhënat sipas burimeve të përcaktuar në rregulloren për sigurimin e cilësisë, informacioni i cili përfshihet më pas në raportin vjetor të departamentit, që vlerëson mësimdhënien, të nxënit, transparencën e notave dhe standarde të tjerë të cilësisë (<i>Evidenca "Raporti periodik NJSBC"; Evidenca 14</i>).</p> <p>Të dhënat e vlerësimit, NJSBC në nivel ISE ia përcjell NJSBC së UT. Rezultatet e performancës, me propozimet përkatës, i dorëzohen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Raporti bëhet në vijim pjesë e raportit vjetor mbi ecurinë akademike si dhe e vetëvlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional dhe të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. Komisioni, më pas e përcjell në Senat, me qëllim marrjen e vendimeve në funksion të përmirësimeve të nevojshme (<i>Evidenca 16, neni 12/4; Evidenca shtesë A.4.1, neni 14</i>).</p> <p>Nëse shihet e nevojshme të ndryshohet kurrikula e programit apo të përmirësohet ajo, informacioni shkresor dërgohet pranë zyrës së kurrikulave dhe komisionit për kurrikulat dhe mësimin. Nëse vlerësohen ndryshimet e kurrikulave, akti përkatës i dërgohet për miratim senatit (<i>Evidenca 7, neni 10/3, 4; Evidenca 2, neni 42/1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar në aktet e brendshme instrumentet që do të përdoren për kryerjen e vlerësimit. Në të njëjtët akte janë specifikuar dhe metodat për kryerjen e vlerësimit, indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik (<i>Evidenca 16, neni 31; Evidenca 17</i>).</p> <p>Instrumentet dhe metodat shërbejnë për hartimin e raportit vlerësues të programit të studimit dhe përmirësimit të tij, nëse rezulton e nevojshme (<i>Evidenca shtesë A.4.1, neni 5</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të</p>	<p>Metoda të drejtpërdrejta, të përmendura shprehimisht në rregulloren për sigurimin e cilësisë, nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë (<i>Evidenca 16, neni 31</i>). Si metoda të tilla përmenden vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuseve, rezultatet e të nxënit, testet. Sipas <i>RVB, f. 80</i>, UT përfshin</p>



<p>studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>të dhënat e raporteve semestrale si p.sh. përqindjen e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit (<i>Evidenca 14</i>).</p> <p>Metoda të tjera në këtë drejtim janë përmendur në <i>f. 80 të RVB</i> për promovimin e mësimdhënies: informacioni nga raporti vjetor për ndryshimet e propozuara të kurrikulës, të dhënat statistikore mbi kalueshmërinë dhe mesataren e studentëve, pyetësorët me studentët (<i>Evidenca 1.16; Evidenca 2.9; Evidenca 3.3</i>). ISE shqyrton dhe vlerësimet që bëhen në përmblyllje të praktikës mësimore, nëpërmjet formularëve që plotësohen për këtë qëllim (<i>Evidenca 7, shtojca 2</i>).</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Metoda të tërthorta të përmendura shprehimisht në rregulloren për sigurimin e cilësisë nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë.</p> <p>Si metoda të tërthorta rezultojnë të përdoren: vlerësimet e drejtuesve; vlerësimet e ekspertëve, vlerësimet e studentëve; vlerësimet e të diplomuarve; vlerësimet e bashkëpunëtorëve; vlerësimet e punëdhënësve; të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, e plotësimit të formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit (<i>Evidenca 16, neni 1, germa d-j; Evidenca 17; Evidenca "Model pyetësori studentë"; Evidenca shtesë A.14; Evidenca shtesë A.15</i>).</p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="590 1019 746 1086">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="746 1019 965 1086">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="965 1019 1177 1086">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1177 1019 1388 1086">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="590 1086 746 1128"></td> <td data-bbox="746 1086 965 1128"></td> <td data-bbox="965 1086 1177 1128"></td> <td data-bbox="1177 1086 1388 1128" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				<b>X</b>
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, në aktet e tij të brendshëm dhe në politikat e procedurat e brendshme të cilësisë, ka parashikuar dhe figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve (<i>Evidenca 1, neni 41; Evidenca 16, kreu III; Evidenca shtesë A.4.1, neni 13</i>).</p> <p>Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, sipas përcaktimeve statutore (<i>Evidenca 2, neni 139/1, germa dh</i>) dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njëjësive kryesore (<i>Evidenca shtesë A.4.1, neni 6/4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të</p>	<p>Institucioni, në vijim të parashikimeve ligjore të aplikueshme, ka përcaktuar detyrat që duhet të përbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë, të nivelit bazë dhe institucional. Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenet 140 e 141 të</p>



<p>studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>statutit (<i>Evidenca 2</i>), në kreun III të Rregullores për sigurimin e cilësisë (<i>Evidenca 16</i>), si dhe në kreun II të rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore (<i>Evidenca shitesë A.4.1</i>).</p> <p>Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ, mbi bazën e dokumentacionit të administruar, nuk ka pasur në dispozicion Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, dokument që përmendet në nenin 41/4 të statutit të UT. Lidhur me këtë rekomandim, IAL ka vënë në dukje se pas vizitës së GVJ-së në ISE, me vendimin Nr. 23, datë 27.7.2022 të Senatit Akademik të UT-së, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë e këtij institucioni, e cila është publikuar në faqen zyrtare të IAL: <a href="https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/vendim-23.pdf">https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/vendim-23.pdf</a></p> <p>Ndërkohë, për sigurimin e cilësisë në nivel të njësisë, nuk ka parashikime në Rregulloren e ISE-së. Në nivel departamenti të këtij programi studimi, nuk ka njësi për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Nga shqyrtimi i rregullimeve të brendshme konstatohet që, formalisht, ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë, është i garantuar (<i>Evidenca 16, neni 16/1, germa d</i>), por <b>sugjerohet detajimi i përgjegjësive dhe detyrave në aktet e brendshme të ISE-së lidhur me njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, sikundër është parashikuar në statut dhe në rregulloret në fushën e sigurimit të cilësisë.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet e bëra nga statuti i UT-së, neni 41, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë gjithsej 11 anëtarë, të cilët duhet të jenë të paktën një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, një përfaqësues nga strukturat e sigurimit të cilësisë në rektorat, një përfaqësues nga institutet/degët, tre përfaqësues nga studentët (<i>Evidenca 2</i>).</p> <p>NJSBC e UT-së përbëhet nga 9 anëtarë, ku përfshihen personel akademik i secilit fakultet dhe ISE me kohë të plotë, 1 anëtar i jashtëm (ekspert) dhe një përfaqësues i Këshillit Studentor.</p> <p>NJSBC në nivel njësie kryesore ka në përbërje një anëtar nga stafi akademik me kohë të plotë i çdo njësie bazë, një anëtar personel ndihmës-akademik dhe një student.</p> <p>Në nivel njësie bazë, NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, që përfshijnë tri përfaqësues nga personeli akademik me kohë të plotë, një personel ndihmësakademik dhe një student (<i>Evidenca shitesë A.4.1, neni 6</i>).</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ marrin përsipër rolin kryesor në zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe NJSBC në nivel qendror dhe njësie, duke siguruar përgjegjësinë institucionale. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces janë të informuar për rëndësinë e procesit të akreditimit dhe hapat që duhen ndjekur në</p>



	rregulloret përkatëse ( <i>Evidenca 16; Evidenca shtesë B.6</i> ). Senati ka përgjegjësinë finale për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. ( <i>Evidenca 16, neni 13</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Sipas përcaktimeve statutores dhe rregullore të nxjerrë për këtë qëllim, vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale. Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore të aplikueshme dhe në organizimin e brendshëm të institucionit ( <i>Evidenca 2, neni 139; Evidenca 16, neni 7</i> ). Duke mbajtur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve ( <i>Evidenca 16, neni 8</i> ). Ky fakt nuk rezultoi as gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion ( <i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sipas nenit 6 të rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njëjësive kryesore, një nga anëtarët e NJSBC së UT-së, është ekspert i jashtëm në fushën e sigurimit të cilësisë, i caktuar me vendim të rektorit ( <i>Evidenca shtesë A.4.1</i> ). Vlerësimi i brendshëm bazohet ndër të tjera, dhe në vlerësimet e ekspertëve ( <i>Evidenca 16, neni 31/1, germa e</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit:</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të UT, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar ( <i>Evidenca 2, neni 139; Evidenca 16, neni 5</i> ). Sipas përcaktimeve të nenit 32 të rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm, i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet me një gjuhë të kuptueshme për të gjithë. Raportet e vlerësimit të brendshëm e të jashtëm bëhen publike. UT dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit ( <i>Evidenca 16</i> ). Neni 15 i rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-



	<p>ve të njëjësive kryesore përcakton se publikimi i rezultateve të raporteve të vlerësimit është i detyrueshëm. Raporti i vlerësimit institucional, pas miratimit nga senati akademik publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe njëjësive kryesore. Publikimi i rezultateve të pyetësorit studentor bëhet nga NJSBC e UT-së brenda 30 ditëve nga hartimi i raportit përfundimtar, i cili publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe njëjësive kryesore (<i>Evidenca shtesë A.4.1</i>).</p> <p>Të gjitha informacionet në lidhje me politikat dhe praktikatat për sigurimin e cilësisë në UT duhet të jenë të arritshme për të gjitha grupet dhe njësitë e interesuara përfshirë organet e studentëve, në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Raportet si dhe të dhënat lidhur me procesin e akreditimit gjenden në faqen elektronike të institucionit qendror: <a href="https://unitir.edu.al/akreditim-i-ut-se/">https://unitir.edu.al/akreditim-i-ut-se/</a>.</p> <p>Pas konsultimit me faqen zyrtare të ISE-së si dhe gjatë vizitës në institucion (<i>Evidenca shtesë "Minutat Msc"</i>), GVJ konstatoi se detyrimi për publikimin e raporteve nuk është përmbushur prej saj, në cilësinë e njëjësive kryesore. <i>GVJ sugjeron që të merren masa për publikimin e të dhënave në lidhje me sigurimin e cilësisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 5 e 32 të Rregullores për sigurimin e cilësisë në UT dhe të nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njëjësive kryesore (Evidenca 16; Evidenca shtesë A.4.1).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të UT-së. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të UT-së si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale (<i>Evidenca 17; Evidenca "Model pyetësori studentë"; Evidenca shtesë A.14; Evidenca shtesë A.15</i>). Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave të sakta mbi programet e studimit dhe përmirësimi i këtyre të fundit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni i përdor të dhënat që dalin nga vlerësimi i stafit akademik në funksion të rritjes së cilësisë së procesit akademik dhe në përgjithësi të cilësisë në rang universiteti. Të dhënat që rezultojnë nga pyetësorët, etj., shërbejnë për hartimin në vijim të planit të masave që duhen marrë në vijim nga strukturat drejtuese të universitetit në rang njëjësive kryesore (<i>Evidenca 14</i>) dhe në rang institucional. Të gjitha procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen në periudha të rregullta dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Senatit, nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikatat e miratuara. Raportet duhet të përfshijnë jo vetëm përshkrime, por dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë të përcaktuara në udhëzuesin mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë. Vlerësimet programore dhe të departamenteve planifikohen për çdo</p>



	vit akademik bazuar në rezultatet e proceseve të kryer për këtë qëllim. Aktet që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë vlerësohen në mënyrë periodike ( <i>Evidenca 16, nenet 16, 21 dhe 33; Evidenca shtesë A.4.1, neni 14</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Përfshirja e rregullimeve specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave në rrjedhim të veprimtarive që monitorojnë vlerësimin e cilësisë nga ana e institucionit, tregon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. Sipas nenit 5 të rregullores për sigurimin e cilësisë, nëpërmjet procesit vlerësues synohet: kontrolli i cilësisë, vlerësimi i gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj (<i>Evidenca 16</i>).</p> <p>Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë (<i>Evidenca 7, neni 10/3, 4; Evidenca 2, neni 42/1</i>).</p> <p>Në nivel njësie, ISE ka hartuar raportin vjetor, ku ka bërë përshkrimin e situatës dhe performancën, një analizë të pikave të forta dhe të dobëta si dhe janë nxjerrë detyra që të mundësojnë përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë (<i>Evidenca "Raporti periodik NJSBC"</i>).</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Sipas nenit 16/2 të rregullores për sigurimin e cilësisë në UT, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë mund të formojë grupe të vegjël pune për të dhënë ekspertizë, këshilla ose për të tërhequr mendime për çështje të sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 16</i>).</p> <p>Rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion se institucioni ka organizuar veprimtari në vijimësi me personelin, por dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi e më gjerë, në vazhdimësi. Kështu, sipas të dhënave të f. 83 të RVB-së, në periudhën Tetor – Nëntor 2021 janë organizuar 6 trajnime/seanca me GVB-të e njësisive të UT-së, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e këtyre grupeve të vlerësimit në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit (<i>Evidenca shtesë B.6</i>).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Legjislacion dhe institucionet evropiane” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Institucioni ka siguruar një eksperiencë të vlefshme në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të programeve të ciklit të dytë të studimeve, sic është programi në vlerësim; një përvojë e tillë është themelore për të adresuar e përballuar sfidat dhe vështirësitë eventuale.
2. Institucioni mbështet programin në vlerësim dhe në tërësi të gjithë veprimtaritë e tij akademike, shkencore e administrative mbi një strukturë të mirëorganizuar e funksionale që është një tregues i rëndësishëm në drejtim të qëndrueshmërisë institucionale dhe të aktiviteteve që realizon.
3. Personeli akademik i angazhuar në këtë program, ka përgjithësisht eksperiencë të gjatë në institucionet e arsimit të lartë apo në sektorin e drejtësisë, një faktor me rëndësi të vecantë për përmbushjen e objektivave në lidhje me cilësinë e programit të ofruar.
4. Ndërkombëtarizimi i programit të studimit, sidomos nëpërmjet programeve “Jean Monnet” të BE-së, u mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike.
5. Institucioni disponon ambiente me standardet e duhur për zhvillimin e programit të studimit, të pajisur me mjetet e përshtatshëm nga pikëpamja logjistike.
6. Biblioteka garanton një akses të bollshëm në literaturën e nevojshme të programit dhe fushës së drejtësisë në përgjithësi, si fizikisht ashtu edhe online.
7. Duke përfituar nga tre programet “Jean Monnet” dhe nga bashkëpunimi me Kolegjin e Evropës në Bruge, ISE synon rishikimin e strategjisë dhe planit të zhvillimit të saj.

**Pika të dobëta**

1. Mungesa e planeve të detajuara kërkimore dhe orientimi i stafit për kërkimin që mundet të kryejnë qoftë në grup qoftë në mënyrë individuale. (*Standardi I.6*)
2. Plani i Zhvillimit të ISE mbetet dokument formal, pa ndikim në zhvillimin dhe strukturimin e punës së njësisë kryesore dhe njësisë bazë (*Standardi II.6*)
3. Komunikimi dhe bashkëpunimi me strukturat e jashtme në tregun e punës, në funksion të rritjes së cilësisë programit mbetet jo i formalizuar dhe në nivel të ulët. Këtu përfshihen edhe Alumni (*Standardi II.6; Standardi V.8*).
4. Faqja zyrtare online e ISE nuk është e përditësuar rregullisht dhe mungojnë informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe veprimtari të ndryshme. (*Standardi VI.5, kriteri 6*).



## Rekomandime

1. ISE duhet të hartojë një plan pune dhe një buxhet shoqërues për hapat që do të ndërmerren për plotësimin e organikës së departamentit me staf me kohë të plotë sipas specifikimeve ligjore.
2. ISE duhet të shtojë përpjekjet dhe të nxisë e mbështesë stafin akademik për të publikuar punime akademike në revista prestigjioze ndërkombëtare, sidomos në përputhje me fushën e tyre të studimit.
3. Rritja e ofertës në gjuhë të huaj, sidomos atë angleze.
4. Rishikimi dhe përmirësimi i Planit të Zhvillimit të ISE.
5. ISE duhet të krijojë struktura specifike që të reflektojnë nevojat e tregut kombëtar dhe atë ndërkombëtar të punës si edhe mendimet e profesionistëve të fushës dhe institucioneve për ta përshtatur sa më mirë këtë program me kërkesat e sotme dhe vazhdimisht në ndryshim të tregut të punës.
6. Sugjerohet strukturimi i zyrës që mban kontaktet me Alumni nëpërmjet një komunikimi konstant qoftë përmes postes elektronike, mediave sociale apo vizitave të ndërsjella.
7. Rritja e programeve të shkëmbimit të personelit, në mënyrë që të përmirësohet më tej cilësia e mësimdhënies. Në këtë aspekt sugjerohet edhe bashkëpunimi me Qendrën e Trajnimeve dhe Inovacionit të UT.
8. (Ri)hapja e një njësie të tretë të ISE, në përmbushje të parashikimeve ligjore.
9. ISE dhe njësia bazë duhet të marrin masat që të dhënat dhe informacionet, të cilat kanë të bëjnë me programin e studimit, strukturën akademike, përmbajtjen e lëndëve, metodat e mësimdhënies dhe kriteret e vlerësimit, personelin akademik, shërbimet për studentët si dhe aktivitetet e ndryshme të publikohen dhe përditësohen rregullisht në faqen zyrtare *online* të ISE-së.
10. ISE dhe njësia bazë duhet të rishikojnë, me qëllim përmirësimi, aktet e brendshme në funksion të sigurimit të cilësisë dhe plotësimin e standardeve të vendosur në këtë drejtim.

## **Conclusions of the Evaluation of the Study Program of the second cycle Master of Science "European Legislation and Institutions" of the Institution of Higher Education "University of Tirana"**

### Strengths and affirmations

1. The institution has provided a valuable experience in terms of setting up and developing programs of the second cycle of studies, such as the program under evaluation; such experience is fundamental to address and cope with eventual challenges and difficulties.





2. The institution supports the evaluation program and all its academic, scientific and administrative activities on a well-organized and functional body structure that is an important indicator in terms of institutional stability and the activities it carries out.
3. The academic personnel engaged in this program generally have long experience in higher education institutions or in the justice sector, a factor of particular importance for the fulfillment of the objectives related to the quality of the offered program.
4. The internationalization of the study program, especially through the "Jean Monnet" programs of the EU, enables academic staff and students to benefit from exchange and interaction with scientific researchers from the EU, including participation in trainings and thematic conferences.
5. The institution has premises with the appropriate standards for the development of the study program, equipped with suitable tools from a logistical point of view.
6. The library guarantees ample access to the necessary literature of the program and the field of law in general, both physically and online.
7. Taking advantage of the three "Jean Monnet" programs and the cooperation with the College of Europe in Bruges, ISE aims to revise its strategy and development plan.

### Weaknesses

1. Lack of detailed research plans and orientation of staff for the research they can carry out either in groups or individually (*Standard I.6*).
2. The ISE Development Plan remains a formal document, without influence on the development and structuring of the work of the main unit and the basic unit (*Standard II.6*).
3. Communication and cooperation with external structures in the labor market, in order to increase the quality of the program, remains unformalized and at a low level. This also includes Alumni (*Standard II.6; Standard V.8*).
4. The official website of ISE is not updated regularly and there is a lack of information related to the study program, academic staff and various activities (*Standard VI.5*).

### Recommendations

1. ISE should devise a work plan and an accompanying budget for the steps to be taken to complete the department with full-time staff according to legal requirements.
2. The ISE should increase efforts and encourage and support academic staff to publish academic papers in prestigious international journals, especially in line with their field of study.
3. Increasing the offer in foreign languages, especially English.
4. Review and improvement of the ISE Development Plan.
5. ISE should create specific structures that reflect the needs of the national and international labor market as well as the opinions of professionals in the field and institutions to better adapt this program to the current and constantly changing demands of the labor market.



6. The structuring of the office that maintains contact with Alumni through a constant communication, whether through electronic mail, social media or mutual visits, is suggested.
7. Increasing personnel exchange programs, in order to further improve the quality of teaching. In this aspect, cooperation with the Training and Innovation Center of UT is also suggested.
8. (Re)opening of a third unit of ISE, in line with the legal provisions.
9. The ISE and the basic unit should take measures that data and information, which are related to the study program, academic structure, the content of modules, teaching methods and assessment criteria, academic staff, services for students and various activities are published and updated regularly on the official website of ISE.
10. ISE and the basic unit should review, with the aim of improvement, the internal acts in function of quality assurance and the fulfillment of the established standards in this direction.





### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X